

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 21. 6. 2007

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 21. 06. 2007. GODINE

QERSHOR - JUN 2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 31 majit dhe të 1 e 4 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e Ministrit Et'hem Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim.

DNEVNI RED

1. Usvajanje zapisnika sa predhodnih sednica od 31 maja. 1 i 4 juna. 2007 gogine.,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Interpelacija ministra Et'hem Çeku, po zahtevu Parlamentarne Grupe PDK,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o narkotičnim lekovima, psikotropnim supstancama i prekursorima,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o putnim ispravama,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o šemi socijalne pomoći,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stručnoj rehabilitaciji i zapošljavanju lica sa ograničenim sposobnostima,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o hrani
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona o likvidaciji i reorganizaciji
Pravnih lica u stečaju

KRYETARI KOLË BERISHA – Të nderuar deputetë, kryeministër dhe ministra të Kabinetit Qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë 71 deputetë, që do të thotë se ka mundësi të fillojmë me punë.

Që në fillim të ju njoftoj se në pajtim me rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në ndërkohë, në pajtim me rregullën 23.2 Grupi Parlamentar për Integrim i është drejtuar Kuvendit me kërkesë që të radhisë si pikë të rendit të ditës pikën e tejkalimit të kompetencave të Ekipit të Unitetit. Janë plotësuar të gjitha kushtet që të hidhet në votim. Tekstin e keni marrë secili me materialin bashkë, E hedh në votim. Kush është që si pikë e rendit të ditës të kësaj seance të hyjë kërkesa e Grupit Parlamentar për Integrim? Po e keni arsyetimin. Urdhëroni.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuari z. kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Realiteti i përfundimit definitiv të negociatave përkitazi me statusin politik të Kosovës, së paku nga perspektiva e interesave të qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës, si dhe veprimet e Ekipit Politik përkitazi me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin zgjedhor dhe shpalljen e konkursit për simbole shtetërore, imponojnë nevojën për shqyrtimin e mandatit të tij. Arsyetimi se Kuvendi do ta ketë fjalën e fundit me rastin e miratimit të këtyre dokumenteve është i paqëndrueshëm, sepse kur janë në pyetje çështjet madhore të vendit, Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë fjalën e parë dhe të fundit dhe jo grupet ad-hok politike.

Kuvendi i Kosovës nuk bën të pajtohet me rolin e dekorit juridik për zhvillimet në prapa dhe para skenat politike në momentet vendimtare për të ardhmen e vendit. Fragmentarizimi i mëtutjeshëm i pushtetit qendror politik duhet të ndërprerët, sepse hapë rrugën për veprime para institucionale dhe koalicione joparimore, që nuk janë në funksion të interesave jetike të qytetarëve.

Krijimi i organeve paralele në vendimmarrje përkujton praktika kundër të cilave jam i bindur të gjithë jemi të përcaktuar. Nevoja e pragmatizmit politik nuk mund të arsyetojë rrënimin e kredibilitetit demokratik të institucioneve të Kosovës. Fitohet përshtypja se Kuvendi i Kosovës nuk është institucion ku mund të ndërtohet konsensusi politik për çështje madhore të vendit. Prandaj, gjithnjë janë të domosdoshme grupet ad-hok politike të përbëra nga liderët e partive politike.

Shtrohet pyetja se në interes të kujt shkon ky përfundim. Çfarë implikime mund të ketë kjo për të ardhmen e Kosovës?

Të nderuar deputetë, është momenti i fundit që Kuvendi i Kosovës të marrë përgjegjësinë e tij historike, duke zbatuar në tërësi kompetencat e tij kushtetuese dhe duke dëshmuar se është i gatshëm që të vihet në ballë të proceseve shtet formuese dhe jo të zvarritet në bisht të tyre. Në këtë drejtim Grupi Parlamentar për Integrim kërkon nga Kuvendi që sot do të deklarohet që të hapet debat përkitazi me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nuk ka debat. E hedh në votim kërkesën e Grupit Parlamentar për Integrim. Kush është për?. Ju lutem numëroni votat. Rezultati është:

Për	9;
Kundër.....	29;
Abstenim..	4.

Konstatohet se nuk miratohet.

Kemi edhe dy pika të tjera që janë po ashtu propozuese. Dy komisionet parlamentare ai për Bujqësi dhe Shëndetësi kanë kërkuar të hiqet pika e tetë e rendit të ditës Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin. Kush është për? Ju lutem numëroni votat. Shumica. Kundër? Nuk ka.

Konstatohet se kjo pikë e rendit të ditës hiqet nga pika e sotme.

Dhe një kërkesë tjetër. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese është i drejtuar Kuvendit me kërkesë që ta radhisë si pikë të veçantë Propozimin për ndryshimin e Rregullores, rregulla procedurale për zgjidhjen e Avokatit të Popullit.

Kush është për? Ju faleminderit. Kundër? Nuk ka. Abstenim . Nuk ka.

Konstatohet se miratohet kërkesa e Komisionit.

Rreth rendit të ditës është përfunduar profesor. Është votuar për rendin e ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 31 maj dhe 1 e 4 qershor 2007

A ka vërejtje, Fehmi Mujota urdhëroni.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Faleminderit z. kryetar. Në procesverbalin e mbledhjes së kaluar është bërë një lëshim teknik. Çështja ka qenë e ngritur për komunën e Shtimes rreth një fatkeqësie elementare, ndërsa këtu del se është në komunën e Shtërpçës. Këtu duhet një përmirësim. Faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Dikush tjetër. Konstatohet se miratohet procesverbali i datës 31 maj dhe 1 e 4 qershor me vërejtjet që i dha deputeti Fehmi Mujota.

Pika e dytë e rendit të dytë.

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës të Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Në afatin e paraparë janë parashtruar 13 pyetje parlamentare. Pyetjet të cilat nuk arrijnë të procedohen sot do të radhiten për seancën tjetër plenare.

Shkojmë me pyetjet. Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për zëvendëskryeministrin Lutfi Haziri. Nuk është këtu.

Pyetja e dytë Debuteti Xhevat Bislimi ka pyetje për ... Urdhëroni z. Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë, ministra të pranishëm. Vlerësoj se vërtet është shkelje procedurale dhe jo parimore që nga data 21.3.2007 e këndej mos të marr përgjigje ,sepse Qeveria e Kosovës, në mungesë të kujto qoftë nga qeveritarët mund të autorizojnë dikun për t'u përgjigje në pyetjet e deputetëve dhe të gjithë këta që janë para ne këtu kanë mundësi edhe juridike edhe potencial intelektual të përgjigjen në këto pyetje . Shtyrja në këtë mënyrë vërtet është jo veçse parimore, por është shkelje procedurale dhe shumë e rëndë e Ligjit e Rregullores së punës së Kuvendit. Ju kisha lutur që vërtet le të përgjigjet kudo, sepse të gjitha këto pyetje po e humbin vlerën dhe karakterin e parashtruesit. Fundi i fundit interpelanca dhe pyetja e deputetit janë çështje që nuk mund të shtyhen.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për kryeministrin Agim Çeku. Mungon deputeti ,shtyhet. Edhe një pyetje tjetër e deputetit Xhevat Bislimi shtyhet për herën tjetër për shkak se nuk është prezent. Deputetja Gjylnaze Syla ka pyetje për ministrin Sadik Idriz. Urdhëroni Gjylnaze.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Në vitet e kaluara kemi pasur raste të sëmundjeve dhe vdekjeve nga ethet hemorragjike. Me qenë se jemi në një sezon kur mundësia nga thumbimet me rriqrat është e lartë ,sidomos në disa zona të Kosovës, ekziston rreziku për shfaqjen e sëmundjes dhe epidemisë nga ethet hemorragjike. Së muajin maj nga ethet Krime Kongo kanë vdekur edhe një qytetar nga fshati Dragobil i komunës së Malishevës.

Z. ministër. Cilat masa parandaluese dhe mbikëqyrëse i ka marrë Ministria e Shëndetësisë që në mënyrë efektive të mbrojnë popullatën nga rriqrat e infektuar dhe pasojat e mundshme nga thumbimet e tyre? Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. ministër e keni fjalën.

MINISTRI SADIK IDRIZ – Poštovana Gjylzane. Isto pitanje postavio je Jonuz Kastrati u međuvremenu, mislim da će to biti istovremeno. Hemoralgična groznica Krime Kongoj i groznica sa bubrežnim sindromom spadaju u grupu virusnih oboljenja koje se nazivaju zunož. Na Kosovu je od 2000-te godine registrovano 277 sumnjivih slučajeva od kojih je potvrđeno 75 u Institutu mikrobiologije u Ljubljani. Od 75 potvrđenih slučajeva 19 je imalo tragične posledice- smrt.

Borba protiv ove vrste bolesti je multisektorialna međuministarska počevši od lokalne vlasti pa do centralne i tu treba da budu uključeni Ministarstvo poljoprivrede, Ministarstvo zdravstva, Medicinski fakultet, Fakultet poljoprivrede, Ministarstvo za ambient, Ministarstvo obrazovanja, znači to nije oblast koja može pokriti samo Ministarstvo zdravlja.

Ministarstvo zdravlja, odnosno zdravstvene institucije Kosova bave se posledicama na vreme neelimisanih faktora rizika. Ministarstvo zdravlja je formiralo krizni štab sa borbu protiv hemoralgične groznice i prošle godine i ove godine. Nacionalni institut za javno zdravstvo redovno prati situaciju na terenu i na Infektivnoj klinici. Od 22. aprila 2007. godine, do danas je registrovano 35 sumnjivih slučajeva na hemoralgičnu groznicu od toga je umrlo dvoje, jedan je od groznice Krim Kongo a drugi sa bubrežnim sindromom.

Infektivna klinika kliničkog centra poseduje dovoljno stručno osobljeno i odgovorno osoblje za tretman ovakvih bolesnika, ima dovoljno prostora za hospitalizaciju kao i dovoljno lekova za tretman pacijenata prema predviđenom protokolu lečenja. Takođe, ima dovoljno sanitetskog i potrošnjog materijala za borbu protiv ove bolesti. U endemskom regionu, tačnije u Centru medicine u Mališevu je organizovana posebna prostorija sa stručno osposobljenim medicinskim osobljem za tretman osoba koje su ubodene krpeljom.

Zaključak naših institucija je da ima slučajeva ubod ali da nemamo epidemiju. Takođe, na zadnjoj sednici Vlade juče, Vlada je formirala međusektorijalnu grupu za izradu strategije za borbu protiv hemoragične groznice, znači to je poslednja Vladi od 19 članova, kompletna jedna grupa računamo da je to problem koji mora da se rešava duže i u gde treba da budu uključeni svi ne samo Ministarstvo zdravlja, koje se isključivo bavi posledicama. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. ministër. cilat janë masat e veçanta parandaluese, jo të shërimit, por masa të veçanta parandaluese? Ju thatë se duhet të bëhet strategjia. Çka përmban ajo strategji? Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni ministër.

MINISTRI SADIK IDRIZ - Mislim da sam kroz ovog izlaganja kazao od prilike i deo masa koje se preduzimaju kao preventivne mase. Inače na terenu su naše, znači egipe Instituta ja javnu zdravstvu iz Prizrena i ostaju znači tamo na centru gde se to javlja, međutim, potrebno je zapošljavanje, dezinfekcije i tako dalje, vodimo kampanju preko medija. Međutim, problem je što imamo i stanovništvo i moram to da kažem često puta na ono što ukazujemo ne dovoljno se ne pridržavaju se da se na vreme jave, ne pridravaju se da se dobro prikladno obuku za što imamo problema znači to je to, i jedan deo masa i taj koji pripada i organima drugim znači. Takođe, mi nemamo, Kosovo ne poseduje helikopterima, avionima za prašivanje teritorije i tako dalje znači to su neki od problema sa kojima smo suočeni i to nije samo ono što pripada Ministarstvu zdravlja.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputetja Gjylnaze Syla ka pyetje për ministrin Bujar Dugollin, po nuk është këtu. Shtyhet për mbledhjen tjetër. Deputetja Fatmire Kollçaku ka pyetje për ministrin Sadik Idriz. Urdhëroni.

DEPUTETJA FATMIRE MULLHAXHA KOLLÇAKU – Faleminderit z. kryetar. Pyetja ime është për ministrin. Pse ende nuk është formuar Këshilli i përgjithshëm profesional me propozim të cilit hartohet strategjia afatmesme për specializime? Pyetja është me arsye se ndarja e deritanishme e centralizume është tregua plotësisht e dështume dhe jo në përputhje me nevojat reale për specialistë, sidomos edhe në aspektin e shpërndarjes gjeografike të specialistëve.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI SADIK IDRIZ – Poštovana g-đa Mullhagja ja sam vam u međuvremenu poslao ono što mi imamo i nije mislim kako stoji da to nije u toj fazi nego je planiranje za specijalizacije uradio institut za javno zdravstvo i mi po tome radimo, to znate. Departament za strateško menadžiranje je uradio jedan draft administrativnog uputstva za formiranje sastava i funkcionisanje profesionalnog savjeta koji bio na diskusiju Ministarstvu zdravlja i taj draft sam dostavio. Imajući u vidu činjenicu da u mnogim zemljama profesionalni savet van Ministarstva i da deluje kao nezavisna i javna institucija koja se osniva posebnim zakonom donetim u Skupštini u diskusijama sa profesionalcima ,oni su iskazali da rezerve da ovaj savet funkcionira u sastavu Ministarstva zdravlja. Oslanjajući se na međunarodno iskustvo sastav i delovanje profesionalnog saveta je mnogo veće a u našim uslovima zahteva povećanje budžeta i osoblja u čemu smo trenutno ograničeni. Nakon svestrane analize mislimo da je predloženi draft prihvatljiv kao prezalno rešenje i pored toga što imam mjesta za izmene. U toku koje treba da se pripremi relevantno zakonodavstvo i budžet kako bi se podržali aktivnosti i savjeta kao nezavisne javne institucije. Inače bordovi u sastavu Ministarstva zdravlja na jedan način vrše imaju funkcije koje pripadaju profesionalnom savjetu.

Što se tiče plana kadrova u zdravstvu Ministarstvo zdravlja imenovalo dve grupe u saradnji sa institutom podržano od strane DIFIDA donelo strateške planove za humane resurse na svim nivoima. Prvi plan je usvojen dog drugi i treći su u završnoj fazi. Međutim, i to je vezano sa budžetskim implikacijama. Mi u Ministarstvu zdravlja od 2005. godine na ovamo imamo smanjenje broja radnika gotovo za ove tri godine preko 500 radnika na sekundarnom i tercijalnom nivou i to istovremeno je vezano sa budžetskim implikacijama. Hvala.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni Fatmire.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA- KOLLÇAKU – Z. ministër, dalja e fundit e specializimeve është rasti konkret ku ka total shpërputhje me nevojat, do të thotë nga qytetet e ndryshme ka qenë një konkurs për tërë Kosovën, pa u precizuar fare .Do të thotë u krijua mundësia që të konkurrojnë gjithë prej Prishtinës dhe të pranohet të gjithë prej Prishtinës. Mirëpo ajo që po ju pyes është- Çka ka ndodh me bordin? E dimë vendimin e juaj dhe çka keni ndërmarrë në përmirësim ,do me thanë të punës së Bordit edhe përmirësimit të situatës në këtë drejtim? Konkretisht për Bordin është fjala.

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. ministër, urdhëroni.

MINISTRI SADIK IDRIZ – Vi imate informaciju da sam ja bord raspustio da je formiran novi bord nedavno on je imao prvi sastanak u utorak zadnji. Mislim da će novi bord izaći sa novim planom verovatno će biti više mjesta. Ja vam kažem na početku 2006. godine mi smo imali 336. mjesta za specijalizaciju to je ona kategorija tako da zvanih lekara nerezidentnih. Negde iza rata 2000. godine bilo je oko 600 specijalizanta mesto za 600 tok je sada 336 i mi očekujemo samo po dinamici kada neki završavaju ondo uključujemo. Na konkursu je bilo za 50 mesta raspisan konkurs mislim da će u ovom novom konkursu koji će biti ovih dana biti više mjesta zato što je međuvremenu još kandidata završilo specijalizaciju očekujemo 80 novih bord će uraditi plan zato što će prethodni bord misiosam da ne radi najbolje mi smo ga raspustili anulirali konkurs i mislim da će novi konkurs ovih dana biti i objavljen. Hvala.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. E njëjta deputete ka pyetje për ministrin Ibrahim Selmanaj. Nuk është ministri këtu. Pyetja përcillet për mbledhjen e ardhshme.

Deputetja Sala Berisha – Shala ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti. Urdhëroni.

DEPUTETJA SALA BERISHA – SHALA – Faleminderit z. kryetar. Çështja është se projekti strategjik për shqiptarët në rajon, siç është korridori rrugor, respektivisht Autostrada Morinë – Merdar, kohëve të fundit me të drejtë i është dhënë hapësirë mediave, e që është përcjell me një kureshtje. Nga ajo që është shkruar dhe dëgjuar ka shumë paqartësi rreth projektit në shumë aspekte. Pyetja është -A është kryer studimi i fizibilitetit duke përfshirë të gjitha fazat sipas kriterëve shkencore për korridoret rrugore, d.m.th. konform standardeve ndërkombëtare për studimet e kësaj natyre?

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, ministra, të nderuar deputetë. E vërteta është që në media është bërë një paqartësi, duke mos dalluar çka është projekti zbatues i Autostradës dhe studimi i fizibilitetit të një rruge. Prandaj për pyetjen konkrete është bërë studimi i fizibilitetit. Këtë e ka bërë një kompani ndërkombëtare me të gjitha kriteret që përputhen me kriteret ndërkombëtare evropiane. Kompani quhet “KOVI”, është prej Danimarkës ka qenë një konzorcium dhe është bërë studimi si është më së miri. Përpos kësaj rruge për Autostradë kemi bërë njëkohësisht edhe studimin e rrugës gjashtë. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni.

DEPUTETJA SALA BERISHA – SHALA – Faleminderit z. ministër. Unë bëj dallimin mes studimit fizibilitetit dhe projektit detal apo projektit zbatues. Mirëpo, sipas praktikave shkencore studimet e fizibilitetit definojnë saktë çmimin, konston e tërë projektit, duke përfshirë shpronësimet, mandej materialet e ndërtimit, projektimin si dhe ndikimet tjera. Nuk dihet se a janë kryer studimet gjeologjike inxhinjeringe të domosdoshme përcaktues stabilitetin e trolit. Së paku asnjë kompani e tillë nuk është parë në terren duke kryer këto punë sipas të gjitha gjasave është bërë përshkrim i strukturave gjeologjike nga literatura ekzistuese shumë e vjetër. Dhe a është e vërtetë se për të njëjtën studim janë shpall dhe janë dhënë dy apo më shumë tendere? Sa ka kushtuar i tërë projekti dhe a ka mbet pa u kompletua i tërë procesi për projektin detal? Shkenctarisht është e palogjikshme të pretendohet të kryehet një studim fizibiliteti pa ligje bazë të mirëfillta, siç është në rastin tonë kur nuk kemi as ligje të shpronësimit as të pronës..mandje nuk është përcaktuar as studjuar vendburimet e materialeve ndërtimore për çka lënë hapësirë a të vazhdojë, d.m.th. nuk është bërë ndonjë studim i vendburimeve për materiale ndërtimore që duhet të ndërtohet kjo autostradë. Kjo lë të kuptojë që ajo rrugë mund të ndërtohet jashtë standardeve duke përdorë rërë dhe zhavorret që të njëjtën kohë është një degradim i lumenjve, por edhe nuk është ndërtimi i rrugës sipas materialeve që duhet të ndërtohen autostradat. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. ministër, urdhëroni.

MINISTRIA QEMAJL AHMETI – Faleminderit. Unë nuk pata qëllim t'ju them z. deputete se ju nuk bëni dallimin. Po meqë në pyetjen e juaj thirrni në media, unë pata obligim të tregoj që në media është bërë një konfuzion. Nuk dihet çka është studimi i fizibilitetit ose mediat nuk e kanë qartësuar çka është studim i fizibilitetit dhe çka është tatimi i projektit. Unë jam me përgjithësi t'ju them se studimi i fizibilitetit është bërë dhe vetëm një herë është bërë prej një kompanie të quajtur "KOVI" nga Danimarka dhe në secilën pjesë ose në secilin sektor të kësaj vije që njihet si rrugë rruga e shtatë dihet sa kushton dhe propozohet çfarë rruge duhet të jetë. Pra nëse më lejohet unë do të zgjeroj përgjigjen time.

Në studimin e fizibilitetit janë marrë sektorët. Është marrë kalueshmëria ose kapaciteti i trafikut në të dhe është propozuar në secilën pjesë të Kosovës, pra nga Moradar deri në Vërmnicë çfarë rruge duhet të jetë. Me studimin e fizibilitetit nuk është propozuar që tërë trasa të jetë autostradë. Diku është propozuar me dy shirita diku me katër shirita, diku ka thënë që s'ka fare, sepse numri apo kapaciteti i automjeteve sipas këtij studimi sillet prej 2100 automjete brenda 24 orë në sektorin që përfshinë prej Vërmnice deri në regjionin e Prizrenit, deri në 27 mijë e 200 automjete që i përket regjionit të Prishtinës. Dhe ky regjion, sipas studimit të fizibilitetit është vizibël, është i arsyeshëm dhe është pranuar edhe nga studimi i fizibilitetit se kjo mund të jetë një autostradë me katër shirita, me katër korësi si quhet, me gjithë ato përcjellëse, me gjithë standardet evropiane. Po ky është studim i fizibilitetit. Ky studim ka kushtuar diku rreth 600 milion, saktësisht mund të ju them se si kam marrë shifrat me veti. Hartimi i projektit, përsëri po them ka koston e vetë dhe hartimi është ndërtuar. Po ashtu edhe hartimi i projektit zbatues të autostradës. Më falni, atëherë një llapsus e kam bërë. Studimi ka kushtuar rreth 600 mijë euro, se 659 milion euro do të kushtojë autostrada sipas studimit dhe hartimi i projektit që është bërë. Për këtë llapsus kërkoj falje, edhe juve edhe opinionit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për ministrin Adrian Gjini.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit kryetar. Falënderoj edhe ministrin që përmbush obligimin.

Çka është duke ndërmarrë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor për mënjanimin e deponive të shumta të automjeteve të prishura, të vjedhura, të grumbulluara përgjatë gjitha rrugëve magjistrale të Kosovës? Këto deponi përveç që e shëmtojnë ambientin jetësor dhe natyror, ato janë të dëmshme edhe për shëndetin si dhe krijojnë një pasqyrë dhe imazh shumë të keq për Kosovën, qytetarët e saj dhe vizitorët e shumtë dhe në veçanti tek ndërkombëtarët. Ju falënderim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI ADRIAN GJINI- Ju faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit z. Kelmendi për pyetjen që e keni parashtruar. Në bazë të prioriteteve, të cilat i ka dhënë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe obligimeve të cilat dalin nga Ligji për mbeturinat, ne e kemi nxjerr Udhëzimin administrativ i cili është udhëzimi nr. 0407 për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinat e tyre dhe ai është shfuqizuar

më 13 mars të këtij viti ,do të thotë atë ditë kur është nënshkruar nga ministri. Ky udhëzim administrativ e parasheh reduktimin fillimisht dhe më vonë edhe parandalimin e ndotjes që vjen nga automjetet mbeturina.

Elementet të cilat i ka kjo rregullore administrative mund t'u jap unë ndërkohë, po ajo që duhet të cekur këtu fillimisht është që për momentin i kemi evidentuara 86 kompani të cilat merren me këtë aktivitet. Prej tyre janë vizituar një numër shumë i madh nga inspektorët e Ministrisë së Mjedisit, në mënyrë që të informohen me provizionet të cilat i përmban udhëzimi administrativ. Deri më tani i kemi tri aplikime për vlerësim të ndikimit në mjedis për këtë aktivitet, për shkak se parashihet edhe një vlerësim i tillë.

Ne mendojmë se në ditët që do të vijnë do të kemi më tepër raste të cilat do të paraqiten për shkak se është obligim që të paraqiten dhe meqenëse i kemi tre ose katër muaj prej momentit kur udhëzimi ka hyrë në fuqi, presim që do të kemi d.m.th. aplikacione. Do të thotë që ka filluar një punë e tillë. Në anën tjetër ajo që ka ndodhur menjëherë pas luftës është se për shkak pikave grumbulluese dhe për shkak të shitjes dhe mundësisë së riciklimit ka ndodhur një fenomen, i cili ndoshta nuk është fenomen i cili mund të quhet largimi i automjeteve me mbeturinë kryesisht nga lumenjtë, për shkak se e dini gjithë ju se para disa viteve në shumë pika të lumenjve në Kosovë ka pas grumbuj të mëdha të automjeteve mbeturin. Tanimë janë në deponi.

Një element tjetër i cili duhet të përmendet këtu është pjesa e përgjegjësisë të komunave ,e cila parashihet edhe në Ligjin për mbeturinat, mirëpo edhe me këtë udhëzim administrativ.

Dy elemente janë të cilat dua t'i përmendi këtu: Është lejimi i lokacionit për qendër grumbulluese dhe definimit e numrit të tyre në territorin e komunës dhe e dyta është organizimi dhe grumbullimi, transportimi, dhe deponimi në qendrat grumbulluese të cilat i përmenda.

Do të thotë pjesa estetike në bazë të kësaj rregulloreje dhe në bazë të ligjit i takon komunës. Do të thotë nuk e përcakton Ministria se ku do të jenë ato lokacione, mirëpo i takon komunës e cila në aspektin estetik mund të rregullojë në atë mënyrë që të mos duken automjetet- mbeturin të mos duken në rrugët kryesore.

Ndoshta një të ardhme të afërt nëse e shohim që nuk funksionon në këtë drejtim do të tentojnë që të nxjerrim edhe ndonjë udhëzim administrativ, në mënyrë që komuna t'i udhëzojmë që t'i largojë nga rrugët ku shihet për shkak se keni të drejtë. Një element tjetër është se Udhëzimi administrativ ndalon edhe trajtimin.

P.sh. ndalimin e trajtimit të elementeve që janë: merkuri, plumbi, kadmiumi, kromi, gjashtë valent, elemente e tjera të cilat përfshihen në listë të cila u është bashkangjitur këtij udhëzim administrativ.

Do të thotë i përmban gjitha elementet të cilat ne mendojmë që në këtë fazë mund të ndihmojnë në parandalimin e ndotjes së automjeteve - mbeturin. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë?. Nuk ka. Ju faleminderit. Deputeti Jonuz Kastrati ka pyetje për ministrin Sadik Idriz. Jonuz Kastrati me kartelën e Ramadan Musliut.

DEPUTETI JONUZ KASTRATI – Ju faleminderit. I nderuar kryetar, kryeministër, ministra, kolegë deputetë. Mjaft nga ajo pyetje që e kemi parashtrua, ministri veç i qartësoj disa çështje, Vetëm dua të them që nga data 8 kur e kemi bërë pyetjen kanë qenë mbi 700 raste thumbimi të rriqrave, ndërsa që pardje kjo shifër ka kaluar mbi 1300.

Një pyetje plotësuese, tash për ministrin: Cilat institucione janë të angazhuara në spërkatjen që sot sa kuptova në Shtëpinë e Shëndetit, fillon në disa fshatra të Malishevës dhe cili është roli i Ministrisë, por më tepër që kohë më herët që qeveria komunale ka kërkuar ndihmë nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë, pasi që vetë nuk ka mund ta përballojë gjendjen? Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI SADIK IDRIZ – Šifre koje imate su, šifre one koji su imali ubod. Mi govorimo znači onima koji su hospitalizovani kod koji je potvrđena, ja sam dao šifre kod kojih su hemoragična groznica i koje su bili, mi nemamo ovde na Kosovu laboratoriju za analizu pa šaljemo za Sloveniju za Ljubljanu. To je ono što smo imali ove zadnje godine.

Ja sam primio delegaciju iz Mališeva i razgovarali smo od prilike koje su njihove potrebe. Problem je kako zaustaviti da dođe do uboda, inače od faze uboda do hospitalizacije je problem koji je, koji pripada znači dalje ministarstvo odnosno glavnom centru medicine u Mališevu i onda u infektivnoj klinici koja ima kapacitete.

Najveći je problem rekao sam još na početku. Ne želim sad da ispadne da je stanovništvo krivo ali imamo i slučajeva gde se oni koji su imali ubod javljaju nekoliko dana kasnije u fazi koja je ponekada i teška da se radi imali smo kampanju i na radio stanicu Mališevo svakodnevno pratite da to ide. Imamo problema i sa zaprašivanjem odnosno dezinfekcijom terena koje je takav kakav jeste i to rekao sam zbog toga je Vlada formirala multisektoralnu grupu koja će uraditi strategiju, jer do sad takva strategija nije takva strategija nije postojala institut za javnost zdravstvo je napravio projekat, formiran je krizni štab u institutu koja je na terenu. To je ono što smo mi uradili. Moguće da izgleda da nije dovoljno i zbog toga je Vlada izašla sa novim predlogom da se formira radna grupa koja će uraditi dugoročnu strategiju jer to nije samo ove godine. To se ponavlja već sedam godina osam godina nakon rata na Kosovu i mislim da je to izvršena jaka senzibilizacija svih imislim da ćemo rezultate ćemo imati u period koji je pred nama. Hvala.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Jo. Deputeti HydaJet Hyseni ka pyetje për ministrin Jonuz Salihaj.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar. Në të vërtetë pyetja ime i është drejtuar Qeverisë dhe ministrive përkatëse, asaj të Rendit dhe Ministrisë së Drejtësisë, sepse edhe çështja që është, është e tillë. Ka ankesa të disa burgosurve aktual

politikë, të familjeve të tyre dhe asociacioneve humanitare për keqtrajtimin e aktivistëve të burgosur të lëvizjes “Vetëvendosja”, përkatësisht rrahjes së tyre brutale në stacioniet e policisë dhe në burgje, lidhjen, pos duarve- vini re edhe të këmbëve, madje edhe gjatë dërgimit të tyre në vizita në takime me bashkë familjarët. Ndalimin e marrjes së ushqimit, pakos higjienike dhe librave nga familja. Ndalimin e posedimit, ndalimin e letrës për të shkruar e të tjera.

Pyesim: Sa janë të vërteta këto ankesa? Nëse janë të vërteta, si shpjegohen këto? Për më tepër pyetja kryesore është çka ka bërë Qeveria dhe ministrinë përkatëse për të parandaluar shkelje të tilla të drejta elementare të njeriut dhe shkelje të konventave ndërkombëtare, të cilat ne jemi të obliguar t’i respektojmë?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Për të dy ministrinë përgjigjet ministri Salihaj.

MINISTRI JONUZ SALIHAI- I nderuari kryetar i Kuvendit,z. kryeministër, ministra ,të nderuar deputetë, i nderuar z. Hyseni.

Bazuar në mandatin si edhe emisionin e Shërbimit Korrektues të Kosovës të gjithë të burgosurve pa dallim iu mundësohet trajtim adekuat sipas ligjit brenda burgut , duke ikur çdo formë diskriminuese dhe poshtëruese. Çdo i burgosur që nga pranimi, pa dallim, i nënshtrohet programit risocializues dhe përgatitës për lirim. Në këtë program hyjnë edhe të burgosurit të lëvizjes “ Vetëvendosje”,të cilët në asnjë moment nuk trajtohen ndryshe nga të tjerët.

Mënyra e paraqitjes së ankesave nga të burgosurit bazohet në kërkesat e ligjit, kurse shqyrtimi bëhet në dy nivele. Askujt nuk i mohohet e drejta për të parashtruar ankesë çfarëdo çështje që i mundon. Tek secili vend kur të burgosurit kanë qasje ekzistojnë kutitë e ankesave për dy nivelet, mirëpo ekziston edhe kutia e ankesave të vendosur nga institucioni i Avokatit të Popullit,e cila hapet vetëm nga zyrtarët e këtij institucioni. Të burgosurit, pa dallim dhe pa pengesa kanë të drejtë t’i dërgojnë parashtrësit organeve kompetente të Kosovës apo Zyrës Ndërlidhëse , misionit diplomatik të shtetit shtetas i cili është ai. Përdorimi i zinxhirëve apo i mjeteve të tjera për këmbë është plotësisht i ndaluar dhe nuk guxon të përdoret. Bile mjete të tilla që posedojnë në buxhetin tonë. Nga mjetet shtrënguese përdoren vetëm prangat e duarve dhe atë vetëm gjatë shoqërimit jashtë burgut apo kur ndonjë i burgosur demonstroi sjellje të dhunshme dhe që vendosja e prangave bëhet e domosdoshme për sigurinë e tij dhe të tjerëve.

Secili burg ka orarin e vizitave familjare, të paraburgosurit paraprakisht pajisen me leje nga gjykata kompetente. Çdo send që futet brenda nga familjarët do të përputhet me rendin shtëpiak dhe gjësendet e lejuara aty. Çdo vizitë e të dënuarve është e hapur, përveç nëse gjatë vizitës i dënuari bëhet i dhunshëm ,kurse për të paraburgosurit vizitat janë të mbikëqyrura, pasi çdo herë një gjë e tillë kërkohet nga gjykatësit përkatës.

Secili burg ju mundëson secilit të burgosur tri shujta të begatshme me 2900 deri në 3500 kalori. Secili i burgosur pajiset me pakon higjienike dhe ka të drejtë sipas dëshirës së tij të marrë libra në bibliotekën e burgut ,por edhe nga familjarët, kurse përmes kantinës-

blerjes në burg ,ekziston mundësia të pajiset me gjëra ushqimore apo gjëra higjienike shtesë.

Momentalisht janë katër të paraburgosur anëtarë të lëvizjes “Vetëvendosja”.Asnjë nivel në Shërbimin Korrektues të Kosovës nuk ka marrë asnjë ankesë për çfarë do sjellje të papërgjegjshme të ndonjë oficeri korrektues gjatë trajtimit të aktivistëve të “Vetëvendosjes.” Çdo sjellje ndëshkuese, diskriminuese, apo poshtëruese ndaj cilitdo të burgosur trajtohet si vepër penale ndaj personave që e bëjnë një sjellje të tillë. Si Ministri e Drejtësisë jemi shumë të përkushtuar t’i përmbahemi mandatit të përcaktuar me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, misionit tonë ,si edhe të gjitha konventave ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e të burgosurve. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Urdhëroni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – E falënderoj ministrin, ai na u përgjigj si do të duhej të ishte. Megjithatë na mbetet borxh që të përgjigjet si është. Për këtë unë i inkurajoj edhe bashkë familjarët, të burgosurit,mediat edhe OJQ-të humanitare që ta zbulojnë dhe ta ndjekin të vërtetën. Shkelje ka z. ministër dhe ato duhen të parandalohen dhe kur ndodhin duhet të ndëshkohen. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! z. ministër keni fjalën. Urdhëroni

MINISTRI JONUZ SALIHAI – I kam lexuar raportet e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar që ka vizituar anëtarët e “Vetëvendosjes”. Kam lexuar raportin e Këshillit për të Drejtat e Njeriut E kam marrë kërkesën z. Albin Kurtit vetë dhe menynë e ushqimit dhe asnjë shkelje absolute nuk ka pasur në burg. Gjitha ato që janë, janë shpifje. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Për pyetjen e fundit deputetja Sala Berisha -Shala, ka pyetje për ministrin Blerim Kuqi ,i cili ka kërkuar që të shtyhet për seancën tjetër, sepse nuk është përgatit. I duhet kohë shtesë që të përgatitet për këtë pyetje. Ju faleminderit.

Mund t’ju njoftoj se pyetjet të cilat nuk kanë marrë përgjigje tash ,nëse brenda dy seancave nuk marrin përgjigje do të botohen në Buletinin e Kuvendit.

Pika e 3 e rendit të ditës.

3. Interpelanca e Ministrit Et’hem Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së

Në pajtim me rregullën 25 pika 1 të Rregullores së punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i PDK i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave z. Et’hem Çekun.

Ministri Çeku i është përgjigjur kërkesës për t’u paraqitur para deputetëve lidhur me dhënien e licencës për hulumtimin e kompanisë “ Kosovo Rekors” nga Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Minerare. Ju njoftoj që në pajtim me rregullën 25. pika 2 të Rregullores së Punës interpelanca zgjat maksimalisht 2 orë.

Në pajtim me rregullën 25 pika 7 të Rregullores së Punës përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit një kohëzgjatje prej 10 minutash dhe në përmbyllje të debatit vlen në 5 minuta, ndërsa koha e ndarë për grupet parlamentare do të reduktojë përfaqësimin e tyre në Kuvend.

Ftoj përfaqësuesin e parashtresës-interpelancës të marrë fjalën.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së z. Krasniqi.

KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, ministra, të nderuar deputetë. Grupi Parlamentar i PDK-së deri më tani shumë herë ka tërhequr vërejtjen se resurset natyrore të Kosovës dhe prona publike janë duke u keqmenaxhuar, duke u degraduar dhe duke u tjetërsuar në dëm të ekonomisë së Kosovës dhe natyrisht edhe të qytetarëve të saj. Shembulli më tipik i veprimeve të tilla është edhe dhënia e licencës Kompanisë” Kosova Resurs ELL C” nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Për hulumtimin e mineraleve në Qukën e Batllavës, Drazhnjës, kjo licencë hulumtimi është dhënë në mënyrë të padrejtë për shumë arsye:

1. KPMM-ja në fakt i ka dhënë një licencë hulumtimi një kompanie të huaj për të hulumtuar në pasurinë e një kompanie tjetër, në këtë rast të “Trepçës” pa e pyetur atë fare.
2. I është dhënë licenca për t’u hulumtuar kompanisë angleze edhe pse po në atë pronë “Trepça” ka hulumtuar mëse dy dekada dhe e ka përgatitur minierën për shfrytëzim, pasi hulumtimi ka treguar se xehja është e pasur me metale dhe shumë rentabile.
3. KPMM-ja nuk është konsultuar fare as me Ministrinë e Energjetikës dhe të Minierave.
4. Këtë licencë KPMM-ja e ka lëshuar pa procedurë tenderi edhe pse neni 17. 1 b i Rregullores 2005/3 thotë se: „licencat për kërkime në xehetari iu nënshtrohen tenderit konkurrues, nëse kjo është paraparë nga autoriteti kompetent”, që në këtë rast është Ministria për Energjetikë e Miniera.
5. Aleksandër Valenta në kohën kur kjo licencë iu dha kompanisë “Kosova Resurs ELL C” ishte anëtar i KPMM-së ku pastaj u punësua po në këtë kompani, që do të thotë se ka pasur konflikt të hapur të interesit.
6. KPMM-ja ka punuar në mënyrë plotësisht jotransparente ashtu që “Trepça” dhe Ministria për Energjetikë dhe Miniera i ka qitur para aktit të kryer.
7. Në krejt këtë licencim janë involvuar negativisht shumë faktorë, siç është Zyra Ligjore e PSSP-së e cila nuk ka nënshkruar Ligjin për miniera dhe minerale për 19 muaj, në mënyrë që të punojë pa ligj, por me rregullore e cila parasheh t’i jepet licenca ai që aplikon i pari pa tender e tjera . Duke pasur parasysh atë që u tha më lart dhe duke pasur parasysh se KPMM-ja pjesërisht i jep llogari këtij Kuvendi, pasi dy anëtarë janë të zgjedhur nga ky Kuvend, atëherë Grupi Parlamentar i PDK-së kërkon që ky Kuvend të nxjerrë një rekomandim të atillë që kjo licencë të pezullohet derisa të definohet qartë kontesti pronësor që ka të bëjë me këtë hulumtim minierar dhe deri

sa pasuria minerare e hulumtuar nga “Trepça” t’i kthehet si pronë legjitime. Ju faleminderit!

KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ftoj ministrin Çeku ta marrë fjalën.

MINISTRI ETHEM ÇEKU – I nderuari z. kryetar, i nderuari kryeministër, kolegë deputetë. Më lejoni në radhë të parë të falënderoj Grupin Parlamentar të PDK-së për ngritjen e kësaj çështje edhe pse them si Ministri, bashkë me Komisionin Parlamentar kemi diskutuar shumë kohë për këtë çështje. Ju e dini që para këtij Kuvendi kemi sjellë edhe Projektligjin për Miniera, i cili i ka kaluar dy leximet dhe është dërguar për nënshkrim, atë që e tha edhe z. Krasniqi, tek PSSP-ja. Po ashtu, në bazë të shumë diskutimeve me Zyrën Ligjore të PSSP-së, ai ligj ende nuk ka shkuar dhe nuk është nënshkruar. Nuk ka hy në fuqi që hyrja e tij në fuqi nënkuptonte rregullimin e plotë të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me çështjen e dhënies së licencës, me çështjen e shfrytëzimeve të burimeve minerale edhe po ashtu edhe me çështjen e përgjegjësisë të Komisionit Rregullativ për Miniera dhe Minerale. Do të thotë ligji i zgjidhte të gjitha këto probleme të cilat sot janë të ngritura para nesh.. Tani jemi në një situatë kur Komisioni ka dhënë një licencë për hulumtim. Është plotësisht e saktë që ne si Ministri nuk kemi pasur informacion zyrtar dhe nuk kemi mundur të pengojmë, përkundrazi shumë letrave dhe kërkesave që ia kemi adresuar PSSP-së, zëvendësit të PSSP-së, Shtyllës së Katërt, AKM-së që eventualisht duhet të diskutohet se dhënia e licencës asaj kompanie a u krye konform Rregullores, e cila është në fuqi 2005/3. Do të thotë ,ne gjatë analizave që i kemi bërë, gjejmë se ka pas shkelje të kësaj rregulloreje.Pra, shkelja vjen sipas nenit 61 paragrafëve 1 dhe 2 në bazë të të cilit Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve është obliguar që ta hartojë planin për menaxhimin e resurseve minerale dhe një plan të tillë duhet t’ia dorëzojë MEMI-t për shqyrtim, miratim dhe shpallje. Një obligim i tillë nuk është kryer nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve. Do të thotë ata nuk na kanë sjellë një plan për menaxhimin e resurseve minerare. Kjo është shkelja të cilën e ka bërë Komisioni me rastin e dhënies së licencës për hulumtim, do të thotë atje është dhënë një licencë për hulumtime . Ne kemi informacionet se tani menaxhmenti i Trepçës përmes AKM-së dhe ajo kompani janë duke bërë negociata për një partneritet në investime të përbashkëta mes këtyre dy kompanive, në mes Trepçës dhe kompanisë, e cila e ka fituar të drejtën për hulumtim në minierën e Batllavës apo ,siç njihet me emrin Quka e Drazhnjës. Do të thotë dy kompanitë janë duke diskutuar se si ta arrijnë ta zgjedhin problemin që është krijuar me rastin e dhënies së licencës së Drazhnjës.

Ne po ashtu kemi kërkuar në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar, në këtë rast, që të ndërpritet dhënia e çfarë do licence për resurse minerale të rëndësishme apo vitale për zhvillimin ekonomik të vendit, posaçërisht të plumbit ,zinkut, arit, argjendit dhe mineraleve të tjera. Do të thotë është kërkuar që të ndërpritet derisa ligji nuk hyn në fuqi dhe derisa nuk miratohet strategjia e minierave në Parlamentin e Kosovës. Ne tani kemi marrë një konfirmim nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve ,që e pezullon dhënien e çdo licence me resurse të interesit jetik për zhvillimin ekonomik të Kosovës, siç e ceka më lart, për 6 muajt e ardhshëm. Do të thotë nuk do të ketë dhënie të licencave për 6 muajt të ardhshëm ,derisa nuk miratohet ligji, derisa nuk hartohet strategjia e minierave të Kosovës dhe derisa nuk krijohen të gjitha parakushtet që ne të kemi një veprim ligjor edhe në fushën e minierave. Po ashtu unë duhet të shtojë se

problemi nuk është vetëm në minierën e Drazhnjës, por janë edhe problemet e tjera të mëdha, posaçërisht në fushën që ka të bëjë me kompleksin e Trepçës. Ju e dini se gjatë gjithë periudhës në “Trepçë” janë bërë investime nga buxheti i konsoliduar i Kosovës mbi 77 milion euro në çështjet e investimeve kapitale në bursat apo ndihmat sociale për minatorët dhe të gjitha ato janë investime të cilat ne i kërkojmë që ato të rikthehen si asete me vlerë të Qeverisë apo të shtetit të Kosovës, që është bërë në kompleksin e” Trepçës”

Prandaj, këtu e kemi edhe një lloj moratoriumi të cilën e ka nënshkruar PSSP-ja në mbrojtjen e “Trepçës”, sepse kemi të ashtuquajtur kreditor pretendues, të cilët pretendojnë se investimet që janë bërë në “Trepçë “ janë valide, janë të bëra në periudhë të caktuar. Ne si Qeveri dhe si Ministri nuk posedojmë dokumentacione relevante mbi investimet që i kanë bërë .Në radhë të parë, nuk kemi asnjë dokument, i cili na vërteton që janë bërë investime. Mirëpo, është një ndihmesë këtu e them e PSSP-së, i cili e ka mbrojtur” Trepçën” nga gjykatat e ndryshme ndërkombëtare dhe “Trepça tani ka një licencë për hulumtim, që nënkupton se ajo atë licencë “Trepça” e ka shfrytëzuar edhe për zhvillimin ekonomik apo për t’i kryer edhe disa punë të tjera që ka rezultuar se kemi mbi 600 të punësuar dhe njëkohësisht është liruar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe ata kryejnë tani një afarizëm deri diku të qëndrueshëm ekonomik, por jo një afarizëm, i cili është me kushtet e ekonomisë së tregut që janë relativisht të jashtëzakonshëm. Do të thotë përpos problemi të Drazhnjës, kemi edhe probleme që kanë të bëjnë me “Trepçën.” Prandaj , ne tani jemi në përfundim, kemi draftin e parë të strategjisë që është miratuar. Kërkojmë që të miratohet Ligji për miniera dhe ta bëjmë një platformë të përbashkët mes Qeverisë dhe Kuvendit për gjetjen e një konsensusi se si do të ecim në fushën e minierave metalike, posaçërisht minierave që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Prandaj, në këtë drejtim si Ministri kemi bërë çmos që të bëjmë çka është e mundur në menaxhimin, në ruajtjen dhe në përdorimin e ligjit edhe pse nuk është i miratuar , të thirrmi në ligjin i cili na mundëson që Qeveria dhe Parlamenti të kenë fjalën kryesore për procesin e zhvillimit të sektorit të minierave. Po ashtu e mbështesim plotësisht, që dhënia e licencave në çfarëdo niveli , qoftë e hulumtimit dhe qoftë licencës për shfrytëzim të kryhet përmes procedurave tenderuese, me Rregulloren në fuqi nuk është. Ne e kemi sjell shembullin e përdorimit të resurseve të linjtit, i cili duhet të bëhet përmes një tenderi. Prandaj, të gjitha këto janë edhe shqetësimet tona të përbashkëta dhe miratimi i ligjit dhe i strategjisë, mendoj se do ta definojë tërësisht strukturën e zhvillimit të minierave. Po ashtu ndërprerja e dhënies së licencës për gjashtë muaj do të na mundësojë t’i sqarojmë të gjitha këto probleme, që janë ngritur nga ana e dhënies së asaj licence. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së, Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuari kryeministër, ministra të nderuar, të respektuar deputetë. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar çështjen e dhënies së licencës për hulumtime kompanisë anglo-amerikane “Kosovaresurs” kompani nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, licencë e lëshuar në vitin 2006. Ndoshta nuk ka qenë dashur që për rastin në fjalë të ftohet në interpelancë ministri

Çeku, sepse çështja e licencave bëhet nga organi i pavarur e që është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Megjithatë ne si Grup parlamentar, por edhe Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar me kujdes dhe përkushtim këtë çështje, prandaj do të përpiqem ta paraqes opinionin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Ju lutem për mirëkuptim. Do të përpiqem të jap një njoftim për rastin në fjalë. Më 5 mars unë e kam marrë një shkresë nga “Trepça” në emër të Komisionit Parlamentar Funkcional për çështjen e licencës në lokacionin Drazhnje. Më 6 mars një shkresë nga ministri Çeku, respektivisht nga Ministria e Energjetikës dhe Minierave. Prandaj, siç thashë nuk ka qenë nevoja për interpelancë, sepse vetë ministri ka reaguar për rastin në fjalë. Më 7 mars i kam shkruar Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për ta njoftuar për të dy shkresat, do të thotë të “Trepçës” dhe të Ministrisë. Më 27 mars Komisioni Parlamentar i ka ftuar në mbledhje për të shqyrtuar kërkesat e Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave dhe të “Trepçës.” Në mbledhje kanë marrë pjesë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, MEM-i dhe “Trepça.” Në këtë takim është marrë qëndrim që të formohet një grup punues nga përfaqësuesi i Komisionit Parlamentar, Ministria e Energjetikës dhe e Minierave,” Trepça “dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për ta shqyrtuar rastin në fjalë.

Grupi punues ka punuar dhe nuk ka identifikuar se janë bërë shkelje të Rregullores 2005/3. Pas kësaj Komisioni ka propozuar që të ftohet edhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, pasi prona publike është në menaxhim, respektivisht në kompetencë të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, kështu që për të njëjtën çështje është biseduar në AKM, në mes të tri subjekteve: “Trepçës,” AKM-së dhe KPMM-së në muajin shkurt të këtij viti. Kjo me qëllim që të gjendet ndonjë kompromis në mes Trepçës dhe “Kosovaresurs kompanisë, ajo që tha edhe në fjalën e vet ministri Çeku. Në bazë të asaj që dëgjuam është sigurisht afër të gjetjes së një kompromisi në mes të “Trepçës” dhe kompanisë në fjalë. Më 15 maj 2007, Komisioni ka ftuar Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për të debatuar për çështjen e licencës të lëshuar për lokacionin Drazhnje, ku përfaqësuesi i AKM-së ka pohuar se licenca është lëshuar në përputhje me Ligjin, në këtë rast me Rregulloren 2005/3. Nga kjo mbledhje ka dalë që sa më parë të nënshkruhet Ligji për Miniera dhe Minerale ose të bëhet plotësimi i Rregullores 2005/3, sepse aty është edhe defekti i krejt kësaj pune.

Neni 17 i Rregullores 2005/3, pika (b) në formën siç është jep të drejtë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhënien e licencës. Nuk është gabim që bënë hulumtime, ato duhet të bëhen. Po e ilustruj me dy shembuj në “Trepçë,” respektivisht në Stan Tërg. Hulumtimet e më hershme kanë dhënë rezultate të verifikuara se me shkuarjen në thellësi trupat xeherorë bie përqindja metalit në xehe, kurse tani me hulumtimet e mëvonshme është dëshmuar fatbardhësisht e kundërta se me shkuarjen në thellësi përqindja e metalit në xehe po rritet. Pastaj, në minierën e Sibovcit hulumtimet e tanishme kanë dhënë rezultate shumë më të mira se hulumtimet e dikurshme, do të thotë se trashësia e thengjillit nuk është ajo që është menduar, por është dukshëm më e madhe. Kështu, nga këta dy shembuj, që ka edhe shumë të tjerë, provohet se nëntoka të ne është pa hulumtuar sa duhet. Prandaj, duhet të gjenden forma dhe mënyra të qëlluara që të punohet tutje pa ra ndesh me ligjin, pa e dëmtuar pasurinë, shoqërinë tonë dhe pa i humbur investitorët e jashtëm me interes për Kosovën.

Për fund, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon:

1. Zbatueshmëri të plotë të ligjeve.

2. Që në kohë sa më të shkurtër Kuvendi ta ketë për diskutim strategjinë për miniera dhe minerale, me anën e së cilës do të plotësohen këto zbrazëtira, si dhe politikat operacionale për resurset minerale dhe shfrytëzimin e tyre.
3. Të nënshkruhet Projektligji për miniera dhe minerale ose në të kundërtën plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores 2005/3, se u tha edhe më lart këtu qëndron edhe defekti i krejt çështjes dhe
4. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet vendimin e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për moratorium rreth kërkesave për licenca hulumtuese dhe licenca për shfrytëzimin e mineraleve metalike deri në miratimin e strategjisë si dhe politikat operacionale.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Sala Berisha- Shala

DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA - Ju faleminderit z. kryetar. Unë nuk flas në emër të Grupit, se shefi i Grupit Parlamentar foli në emër të Grupit, por do të flas si deputete, duke qenë edhe anëtare e Komisionit Funkcional për këtë problematikë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju lutem, së pari e ka fjalën shefi i Grupit, në emër të Grupit, atëherë e ka fjalën përfaqësuesi i Aleancës.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit. I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar.

Së pari dëshiroj të theksoj dhe të sqaroj se kërkesa e Partisë Demokratike për interpelancën e ministrit nuk ishte e adresuar drejt për arsye se ministri i Energjetikës dhe Minierave nuk është kompetent dhe nuk ka bazë ligjore për dhënien e licencës kompanisë minerare “Kosovorisursis L.C”. Megjithatë unë dëshiroj ta falënderoj Ministrin për gatishmërinë e tij, që të bashkëpunojë edhe me Kuvendin, por njëkohësisht ne si Grup Parlamentar e shohim si mundësi të mirë për bashkëveprimin edhe të Qeverisë, por edhe të Kuvendit për zhvillimin e Sektorit të minierave.

Lidhur me dhënien e licencës për hulumtimin na hapësirën e quajtur Çuka e Batllavës përgjegjës është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, i cili është organ i pavarur rregullatorin në Sektorin e minierave. Megjithatë, MEM-i, siç e thashë nuk e ka mandatin ligjor, por çka është me rëndësi, është se sipas Rregullores me të cilën është formuar Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është dashur së pari ta hartojë pra planin për menaxhimin e resurseve minerale siç e theksoi edhe ministri. Pse është dashur të hartohet ky plan? Miniera paraqet një rezervë të madhe të xeheve dhe si e tillë është rezervë me rëndësi strategjike për Kosovën. Projektplanin është paraparë me qëllim të identifikimit të projekteve strategjike për Kosovën. Prandaj, në mungesë të planit të tillë KPMM-ja është detyrë të konsultojë MEM-in, gjë që nuk ka ndodhur. Lidhur edhe me pjesën tjetër të Rregullores, e cila ka pas të bëjë me tenderime, sipas rregullores 2003/5, neni 22.3 ka qenë se kompania e parë, e cila do të aplikojë ka përparësi për t’u regjistruar nga Komisioni. Çka do të thotë kjo? Do të thotë se dhënia e licencës për hulumtime krijon të drejta prioritare për të licencuarin me rastin e aplikimit të tij për eksploatimin e minierës.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto, Grupi Parlamentar i Aleancës rekomandon që Ligji për miniera dhe mineralet të nënshkruhet nga PSSP-ja për shkak të krijimit të bazës së

nevojshme ligjore. Kjo është e para. E dyta është bashkëpunimi ndërinstitucional duhet të intensifikohet. Edhe pse Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është organ i pavarur, duhet të bashkëpunojë me MEM-in, kurse Komisioni Funkcional i Kuvendit duhet të mbikëqyrë politikat dhe planin për shfrytëzimin e mineraleve në Kosovë. E treta, dhënia e licencave për hulumtim duhet të bëhet me tender të hapur konkurrues, sepse për ndryshme dëmton interesin e Kosovës dhe imazhin e saj. Katër, MEM duhet të punojë në përfundimin e strategjisë së xehetarisë së Kosovës si dokument bazë të politikave për zhvillimin e Sektorit të minierave dhe të kalojë në Kuvend. Ju faleminderit

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit deputete Sylja, në radhë Grupi Parlamentar ORA.

DEPUTETI NAZIM JASHARI - I nderuar z. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë

Është mirë që Grupi parlamentar i PDK-së sot e ka iniciuar këtë interpelancë, pavarësisht asaj që u tha këtu, që nuk është ministri ai që është dashur të ftohet në interpelancë për një arsye themelore, sepse qytetarët e Kosovës kanë mundësi ta shohin në vepër se si funksionon sistemi politik në Kosovë, si funksionon Qeveria në Kosovë dhe si funksionojnë agjencitë të cilat janë të parapara që t'i shërbejnë kësaj Qeverie. Fatkeqësia e Kosovës, e gjithë qytetarëve të saj është se Qeveria jonë fatkeqësisht nuk merret me problemet e qytetarëve, kështu që, në qoftë se nuk do ta kishte ngritur këtë çështje Grupi i PDK-së, ne sigurisht se nuk do të kishim pasur mundësi as ta kemi një prononcim të Ministrit lidhur me këtë problematikë, që është problematikë esenciale për të gjithë qytetarët e Kosovës. Pasura e Kosovës është pasuria e të gjithëve, nuk është pasuri as e vetëm e një regjioni as e vetëm të një grupi të caktuar shoqëror. Mendoj se, ne duhet urgjentisht si shoqëri të bëjmë diçka që ky sistem të fillojë të funksionojë, që këto licenca të cilat jepen, të jepen në mënyrë, vetëm në atë mënyrë në të cilin do të valorizohet interesi i qytetarit dhe nuk do të mbroheshin interesat e grupeve apo interesat personale të individëve të caktuar, kushdo qofshin ata, sepse përndryshe edhe ky besim i qytetarëve i cili realisht është shumë i mangët, është duke u var për një fije peri, në një moment do të tretet dhe do të gjendemi para qytetarëve pa asnjë autoritet. Mendoj se ministri duhet të përpiqet që shumë më fuqishëm ta ushtrojë ndikimin e vet, po qe se është i interesuar ta ushtroj ndikimin e vet në të mirë të qytetarit të Kosovës e jo vetëm në interes të subjektit të cilit i takon apo grupeve të interesit që mund të kenë afinitet me të. Pra, duhet që të përpiqet, që në të gjitha rastet kur shkelen procedurat, kur shkelet e drejta e qytetarëve të Kosovës për ta gëzuar dhe për ta shumëfishuar pasurinë e vet të reagojë dhe që ta bëjë publike atë shkelje, edhe pafuqinë e vet ta bëjë publike, në qoftë se është i pafuqishëm, sepse përndryshe është vështirë ta meritojë emrin ministër. Nuk mund të fshihemi dhe të themi se është dikush tjetër i cili po i merr vendimet pa na pyetur ne, në ndërkohë që bëhet fjalë për pasurinë e Kosovës. Qytetarët e Kosovës e kanë ministrin dhe pushtetin e vet dhe pushteti i vet duhet të komunikojë me qytetarët e Kosovës dhe t'ua sqarojë edhe atëherë kur nuk ka kompetencë, por edhe atëherë kur dikush ua merr me pa të drejtë kompetencat, thotë se neve po na merren kompetencat. Thjeshtë ta hetojë qytetari i Kosovës, që pushteti ynë nuk është duke e ushtruar kompetencën e vet për shkaqe objektive. Në qoftë se kjo nuk bëhet, atëherë mbetet gjithmonë një dyshim, i cili është i pashmangshëm në gjitha rrethanat kur kemi kësò

mungesë të transparencës e kur kemi këso shkeljesh të procedurave që dikush me dike ka mund të merret vesh dhe që heshtja është pjesë e marrëveshjes. Mendoj se kjo praktikë e punës Kosovën e ka prua deri në këtë nivel ku e ka prur dhe kjo praktikë e punës Kosovën nuk mundet me qua përpara. Ne duhet si shoqëri urgjentisht ta gjejmë mënyrën e punës më të mirën të mundshme që, edhe ta mbrojmë pasurinë, por edhe atë pasur ta gëzojmë. Ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit z. Jashari. Grupi Parlamentar 6+, a dëshiron dikush ta merr fjalën? Jo.

Në emër të Grupit për Integritim. Urdhëroni Vezira

DEPUTETJA VEZIRA - Pozdruvlljam ovo pedsedavajuće zamenika, ministre i sve kolege parlamentarce

Ja radim u ovoj Funksionalnoj komisiji za ekonomiku, energetiku, privredu i trgovinu i imeli smo dva razmatranja na Komisiji oko davanja licence ove kompanije „Kosovorersurs“ za istraživanje rudnika i rudnog bogatstva. Ovo, na toj Komisiji čuli smo da je prvo istraživanje radila Trepša i da je ova Vlada, vidite ja sam ovde kao parlamentarka i sve kolege svoje molim da budemo mnogo konkretniji kada dajemo ovo, nešto za javnost. Ja sam na toj Komisiji čula pitanje da je bilo dato od strane Vlade 10 miliona € Trepči za istraživanje minerala i rudnog bogatstva. Eh sada, ako smo jednom dali pare za to istraživanje, zašto se ponavlja ponovo da dajemo pare za istraživanje nekoj drugoj kompaniji. U pitanju je ovo rudno bogatstvo, u pitanju je blago Kosova i prvo najveću primedbu imam kada nešto istražujemo u bilo kojoj grani, bilo kojoj sferi, mi smo spremni da dva tri puta plaćamo kompanijama za istraživanje i dva tri puta da plaćemo na izradi nekog zakona. Prvo znamo da nije donet zakon, da nije potpisan o rudnicima i mineralima i onda smo požurili i davali pare za istraživanje. Ja mislim da je osnovno kršenje zakona u tom postupku kada je dato da se nešto istražuje a nemamo zakon za to, znači nešto nije dozvoljeno a nešto se na terenu priprema da se radi. Ovo dajem do znanja da mnogo moramo da pazimo, kada je u pitanju, kada su ostala pitanja socijalna, penzioneri, i ovo uvek kažemo da Vlada nema para i moramo mnogo da budemo ekonomičniji i štedljivi kada su u pitanju projekti koji su od vrlo velikog značaja za razvoj Kosova. Mislim da je pravo ovo pitanje za ministra, i mislim da je ovo dobro od strane Grupe PDK, da je postavljeno ovo pitanje i mislim da je ministar, Vlada i ministarstva svih ovih polja da su glavni i odgovorni za celokupnu situaciju ovde na Kosovu da nam bude svima bolje. Hvala!

KRYESUESI BISLIM HOTI –Ju faleminderit deputete. Fillojmë sipas radhës të paraqiturve. Po në emër të. LDD-së, deputeti Ramadan Kelmendi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit kryesues. Të nderuar ministra, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë vlerëson dhe mendon si çështje mjaft parimore ngritjen e licencave në tërësi dhe në veçanti kësaj që sot u theksua këtu. Ne mendoj se çështja e licencave në përgjithësi duhet vlerësuar nga të gjitha aspektet, sepse është edhe çështje e karakterit politik, ekonomik dhe mbi të gjitha atij ligjor. Andaj kjo e fundit na preokupon të gjithëve neve.Pra, duhet shikuar se këto licenca a kanë kaluar nëpër procedurën ligjore dhe kriteret e parapara. Këtë e mbështesim në faktin, bëhet fjalë çdo herë mbi pronën publike, pronë e cila është në interes të përgjithshëm dhe të gjithë qytetarët dhe ne si deputetë jemi të obliguar t'i dimë të gjitha

procedurat e zbatuara rreth dhënies së këtyre licencave. Natyrisht se, hulumtimet nuk janë çështje parciale të pasurive natyrore dhe këto hulumtime nuk duhet të bëhen pa u dhënë një licencë. Në tërësi ne vlerësojmë se lëthurja e licencave duhet bërë në pajtueshmëri tash edhe me kriteret të përcaktuara paraprakisht me tenderët publike, sepse kërkojmë transparencë në punën që është bërë dhe se e tërë kjo punë e licencave duhet pezulluar deri në miratimin e ligjeve dhe rregullave dhe rregulloreve që u cekën paraprakisht, për ndryshe këto shkojnë në dëm të përgjithshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI - Ju faleminderit z. deputet. Ftojme deputetin Ilmi Ahmetin.

DEPUTETI ILMI AHMETI – Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar ministra, deputetë të nderuar,

Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport, Telekomunikacion, është njoftuar nga Bordi qeverisës i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për dhënien e licencës për hulumtime e kompanisë „Kosovaresurs“ dhe si Komision e ka pasur edhe në rend dite në disa takime këtë çështje, e cila është e një rëndësie të veçantë. Mendimi im është se këtu do duhej të kishim për të informuar Kuvendin përfaqësuesit e Bordit qeverisës të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve, të zgjedhur nga ky Kuvend dhe përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Po e them këtë, sepse Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk i përgjigjet Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave. Prandaj, Ministria e Energjetikës dhe e Minierave nuk mund ta kontrollojë punën e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Neve na janë të njohura përpjekjet e Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave dhe shqetësimet e saja rreth lëshuarjes së kësaj licence. Këtu do të duhej, pra para këtij Kuvendi të ishin edhe përfaqësuesit e AKM-së për faktin se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, i cili menaxhon me ndërmarrjet shoqërore dhe se, si kujdestare Axfhencioni Kosovare i Mirëbesimit ka për detyrë që të ruajë dhe të rrisë vlerën e ndërmarrjeve shoqërore. Në këtë rast Agjencia Kosovare e Mirëbesimit nuk e ruajti vlerën e “Trepçës.” Po e them këtë, sepse Bordi qeverisës i Komisionit të Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve thotë se e ka informuar zëvendës drejtorin menaxhues të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për ndërmarrje shoqërore dhe ka kërkuar nga ai që t’i dorëzojë të gjitha dëshmitë në dispozicion për të drejtat minerare dhe titujt për ndërmarrjen shoqërore “Trepça”.

Bordi qeverisës i Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve ka qenë në dijeni të plotë për punët hulumtuese që i ka bërë Trepça në lokalitetin e Çukës së Drazhnjes. Komisioni i Pavarur ka pasur dhe ka në dispozicion gjithë elaboratin e e punimeve të kryera në këtë vendburim të mineraleve të dobishme, duke filluar nga matjet gjeodezike, studimet gjeologjike, gjeofizike, gjeoelektrike në sipërfaqe prej 115 kilometra katrorë. Shpuarjet e thella në gjatësi në gjatësi të përgjithshme 6144 metra. Hapjen e 5000 metrave korridore hulumtuese, verifikim të rezervave prej 4.734 milion tonë, deri te prodhimet testuese të 40.000 tonë xehe të plumbit e zinkut. Shtrohet pyetja: Pse licencë për hulumtime në këtë zonë kur dihen rezervat të verifikuara në bazë të hulumtimeve të kryera nga “Trepça”. Për mua licenca e lëshuar nga Bordi qeverisës i Komisionit të Pavarur të minierave dhe Mineraleve, Kompanisë “Kosovaresurs” për hulumtime në Çukë të Drazhnjes do ta kishte kuptimin sikur t’i jepet për një zonë më të gjerë hulumtuese e jo për atë të hulumtuar.

Komisioni i Pavarur i Minierave dhe i Mineraleve do të duhet të shqyrtonte mundësinë që “Trepça” të licencohet me licencë për shfrytëzim, sepse kjo tash po ballafaqohet me shumë probleme, si pasojë e ndërprerjeve të shpeshta të prodhimit testues. Rritja e prodhimit do të stabilizonte jo vetëm “Trepçën”, por edhe ekonominë kosovare në përgjithësi. Edhe mungesa e Ligjit për miniera dhe minerale po e vështirëson në masë të madhe punën në lëmin e xehetarisë. Nënshkrimi i Ligjit, i cili është miratuar nga ky Kuvend, do t’u jepte zgjidhje shumë problemeve në këtë sferë. Besoj se po të kishim këtë ligj, kjo çështje nuk do të ishte në rend dite sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI BILIM HOTI - Ju faleminderit deputeti Ahmeti. Për fjalë është paraqitur deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA - Z. kryesues, kolegë deputetë. Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti dhe Industri, Telekomunikacion ka mbajtur një dëgjim publik me përfaqësuesit e Ministrisë së Energjetikës dhe Miniera, si dhe me Komisionin e Pavarur të Minierave dhe Mineraleve lidhur me licencimin e Kompanisë “Kosovaresors” për hulumtimin e minierës së Çukës së Batllavës së Drazhnjes, si dhe me përfaqësuesit e Kompanisë publike “Trepça” dhe përfaqësuesit e AKM-së dhe mbi bazën e këtyre takimeve dhe materialeve, shihet se:

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ia ka lëshuar licencën e Kompanisë “Kosovaresors” për hulumtimin e minierës së Çukës së Batllavës të Drazhnjes. Në anën tjetër “Trepça” ka paraqitur dokumentacionin valid ku dëshmohet se kjo kompani me vite ka kryer tërësisht hulumtimin në këtë minierë dhe rezultatet e hulumtimit janë afruar edhe KPMM-ës. Shpenzimet për hulumtimin në këtë vendburim i ka bërë kompania “Trepça.” Nuk vihet në dyshim nga asnjë palë se ekzistojnë këto rezultate. Megjithatë, KPMM-ja ka vlerësuar se këto hulumtime nuk janë bërë sipas standardeve të nevojshme po që se rezultatet e hulumtimit të ndërmarrjes “Trepça” nuk kërkojnë me zhvillimet më të reja teknologjike dhe kërkimore, megjithatë një vlerësim i tillë duhet të jetë i bazuar në një studim të thelluar të ekspertëve. Hulumtimet janë bërë gjatë periudhës 1950, 1989 nga ana e “Trepçës”. Në bazë të materialit që na është afruar nga “Trepça” del se “Trepça” ka kryer këto punë, Nën 1. Matje gjeodezike, 2. Studimet gjeologjike, 3. Studimet gjeofizike dhe gjoelektrike, blerja e pronës prej 21 hektarë, dëshmi është fleta poseduese. 5. Ka bërë shpurrje të thella në gjatësi 6144 metra, përgatitjen e projektit për hapjen e minierës nga Boliden dhe Instituti i “Trepçës.” Është bërë prodhimi testues i 40 mijë tonë xehe, Nën 8. verifikimi i rezervave prej gati 5 milion tonë.

Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve i ka dhënë licencën për hulumtim Kompanisë “Kosovaresors” pa e qartësuar çështjen pronësore juridike të objektit që duhet të hulumtohet. Bordi i qeverisë së AKPM-ës, ka miratuar dhe ka lëshuar licencën për hulumtime galeria nëntokësore ekzistuese në zonën e licencës është konsideruar si një minierë e braktisur pa pronarë.” Trepça” e ka pronën fizike me kadastrë që është blerë prej komunës së Besianës, në të cilën është bërë hulumtimi. “Trepça” posedon fletën poseduese. Këtu nuk bëhet fjalë për dhënie të licencës, por për transformim të pronës. Është bërë transformimi i pronës nga prona shoqërore publike e “Trepçës” në pronë private.

Ky vendburim i përket territorit të kompanisë” Trepça” dhe është pronë e saj, ndërsa veprimet dhënia e licencës ,pra nga KPMM-ja është ndërhyrje në pronë të huaj.

3. Komisioni i Pavarur i Minierave dhe i Mineraleve i ka lëshuar Kompanisë “Kosovaresurs” licencë pa procedurë të tenderimit , që u tha edhe më herët në bazë të nenit 22 të Rregullores për Miniera dhe Minerale 2005/3 , pa tender të hapur tenderues, si dhe neni 17.1. (b) do të duhej të respektohej në këtë rregullore.

Duke pasur parasysh faktin se kjo minierë në bazë të dokumenteve ka pasuri me vlerë, në bazë të hulumtimeve të mëparshme të dokumentuara paraqet një rezervë me rëndësi strategjike për Kosovën. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë të madhe ekonomike të kësaj miniere, si dhe interesimin e investitorëve të tjerë, ne vlerësojmë se kjo licencë do të duhej të ishte dhënë në një procedurë të hapur konkurruese, sepse tenderi i hapur konkurrues do të mundësonte përzgjedhjen e kompanisë më të mirë dhe do të ndikonte në zhvillimin e sektorit ekonomik në Kosovë.

Praktika e dhënies së licencave e për çfarëdo aktiviteti në minierat e Kosovës me vlerë strategjike për zhvillimin ekonomik të Kosovës, pa tender të hapur është praktikë e dëmshme për minierat e Kosovës.

Punësimi i z. Aleksander Valenta, në ndërmarrjen “Kosovaresurs” për faktin se ai ka qenë anëtar i Bordit të KPMM-së, kur kompanisë në fjalë i është ndarë licenca, nëse është kështu, atëherë kjo mënyrë hap mundësinë për spekulime të ndryshme dhe ka natyrisht konflikt interesi.

5. Përfaqësuesit e Trepçës dhe Ministria e Energjetikës dhe Minierave nuk janë konsultuar fare në lidhje me këtë licencë. Nuk kanë qenë në dijeni me kohë për dhënien e sajë. Për shkak të këtyre zbrazëtirave ligjore, kërkojmë të nënshkruhet sa më shpejt Projektligji për miniera dhe minerale dhe të fillojë sa më parë zbatimi i tij. Në anën tjetër duke i pasur parasysh gjithë këto fakte që i përmendëm, ne kërkojmë menjëherë pezullimin e licencës së dhënë.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit deputete! Për fjalë është paraqitur deputeti Xhevdet Neziraj, kërkojmë nga regjia që, të flas në emër të Ymer Halimit.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ- Ju faleminderit. Unë po paraqitem këtu në emër jo të Komisionit, por si anëtar i Komisionit, ku bashkërisht kemi vepruar që të parandalohet kjo dhënie e kësaj licence, duke e shfrytëzuar mangësinë e Rregullores , të cilën e kemi kundërshtua si komision. Mirëpo, në bazë të mangësisë që ka pasur Rregullorja ata e kanë shfrytëzua këtë situatë dhe kanë dhënë licencën, Ne kemi qenë të pafuqishëm. Të pafuqishëm ka qenë edhe vetë Ministria dhe ministri, i cili na u ka drejtua me një letër, më 5 ose 6 mars dhe ne si Komision e kemi bërë punën tonë. Bile nga AKM-a, jemi akuzuar se gjëja po i ndalim edhe investimet në ekonomi, do të thotë Komisioni ynë parlamentar, i ka qit në shesh të gjitha të metat.

Unë e mora fjalën duke ardhur këtu e lexova një thënie një aforizëm politik se, UNMIK-u po na këndon këngën, por mundësisht të këndojë këngë me tekstet tona. Unë t’ju them që UNMIK-u le të veprojë, por mundësisht le ta nënshkruajë ligjin që e ka lexua në leximin e parë dhe të dytë, në këtë Kuvend, që Qeveria të bie strategjinë për miniera dhe të veprohet në bazë të asaj strategji. Është shumë me rëndësi moratoriumi që ka ndodhur mosdhënia tjetër e licencave, sepse ne këtë kohë do të kemi kërkesa të shumta, për

marrjen e këtyre licencave në lëmin e minierave, për arsye se në tregun botëror kemi ngritje të çmimeve të metaleve marramendëse, që nuk është paraparë ndonjëherë ose nuk është paraparë edhe nga ekonomia. Prandaj, një resor shumë me rëndësi, që e ka Kosova e që është minierat, duhet që urgjentisht Qeveria, Kuvendi dhe të gjithë ne bashkërisht të ndalohet privatizimi në këtë lëmi për arsye se është një resor që do të ndikojë në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës.

Prandaj ,ne duhet të kryejmë sa më shpejtë punën tonë dhe po them edhe një herë që, edhe nëse UNMIK-u këndon, bile të këndojë me tekstet tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit deputet, Në radhë është paraqitur Bajrush Xhemajli i cili është njëkohësisht x edhe i fundit.

(Polemikë)-

Por vazhdojmë pra me deputeten Sala Berisha – Shala.

DEPUTETJA SALA BERISHA – SHALA – Ju faleminderit zoti kryesues.

Unë këtu dua të tërheq vëmendjen pak të kolegëve deputetë se nuk e di sa kanë arritur të kuptojnë, ose sa kemi arritur ne të debatuar gjer më tani, problematikën e kësaj çështje që e kemi ngritur këtu sot. Me fjalë të tjera,kishte mendime pro e kontra. Dikush doli si avokat i Qeverisë, përkatësisht ministrit, dikush tjetër mbeti pa anime, mirëpo këtu , për këtë fushë e kam fjalën, vërehet një shkapërderdhje e përgjegjësive për të mbetur faji jetim.

Të gjitha qeveritë e vendeve që kanë vizion me traditë zhvillimore ekonomike, rëndësi esenciale, në programet e tyre qeveritare u kushtojnë edhe resurseve minerale dhe gjeoshkencave. Jo rastësisht, historikisht këto resurse janë cilësuar si pasuri kombëtare. Resurset minerale kanë qenë dhe mbeten shtylla vertebrale e zhvillimit të një vendi ose shoqërie. Andaj dua t'ia përkujtoj Qeverisë dhe Ministrisë së Energjisë, se do të ishte mirë dhe me interes për të gjithë ne, që problematikën dhe strategjinë e fushës së mineraleve ta bazonte në praktikën e mira të vendeve në zhvillim po edhe vendeve të zhvilluara. Mirëpo jo që nuk kanë marrë model nga këto praktika, por janë duke u trajtuar këto çështje si të ishte pasuri e huaj. Që ne ekspozenë e parë të kësaj Qeverie, unë personalisht, po edhe Grupi Parlamentar i PDK-së nuk e kemi mbështetur programin qeveritar pikërisht edhe për këtë çështje ,sepse me asnjë fjalë në program nuk parashihi minierat dhe mineralet.

Arsyetimi atë kohë ishte se nuk kemi kompetencë në këtë fushë, se më vonë do të plotësohet kjo fushë edhe pse as kaq kohë Ministria e Energjisë dhe Minierave nuk ka bërë asnjë hap konkret ose ndonjë strategji për miniera. Asnjëherë gjer më sot nuk kemi asnjë iniciativë së paku të paraqitur në Parlament për fushën që po diskutojmë. Iniciativa dhe interesime Ministria e Energjisë dhe Minierat ka vetëm atëherë kur në pika të caktuara aty ku përputhen interesat personale të individëve për zona dhe vendburime të caktuara dhe për minerale të caktuara, që janë interes i klanit apo i grupit të caktuar. Nuk ka si të kuptohet ndryshe kjo punë kur nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dy mekanizma institucionalë financohen për të njëjtën veprimtari, ani pse jemi të vetëdijshëm që një pjesë e këtyre kompetencave kanë qenë fuqi të rezervuara.

Ministri dhe Qeveria as edhe një hap nuk kanë bërë që të ndryshojnë gjendjen në fushën e minierave. Rasti tash më skandaloz mendoj është se kur para syve të Qeverisë dhe Ministrisë mbi bazën e rregulloreve të UNMIK-ut privatizohen, licencohen, eksploatohen pasuri kombëtare, siç është rasti me këtë licencë pa përmendë privatizimet e pasurive tjera. do me thënë dhënia e licencës të kompanisë “Kosova resurs”. Vetë lëshimi i kësaj licence, në vete përmban shkelje të natyrave mendoj më të rënda juridike, ekonomike e pronësore për të cilat shkelje në çdo vend ku sundon ligji do të përgjigjeshin të gjithë ata që kanë përgjegjësi, apo janë të involvuar në këtë fushë. Më lejoni të numëroj disa nga shkeljet dhe parregullsitë, edhe pse ka mundësi që dikush nga parafolësit ti ketë përmend.

Në këtë licencë ka konflikt interesi. Një anëtar i kësaj kompanie të licencuar ka qenë anëtar bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Në të njëjtën kohë ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për licencim, duke qenë edhe anëtar bordi për të shqyrtuar këtë aplikacion. Kjo licencë është dhënë në pronën e “Trepçës” edhe pse këtu ishte një arsyetim nga kryetari i Komisionit Parlamentar se është dhënë konform Rregullores së UNMIK-ut 2005/3, mirëpo unë dua t’ia përkujtoj edhe kryetarit të Komisionit, po edhe të gjithë atyre që mendojnë që nuk ka pasur shkelje, në dhënien e kësaj licence se, në fajlin e kësaj licence ekziston një pëlqim komunal nga komuna e Besianës ku decidivisht thuhet se Quka e Batllavës, përkatësisht Drazhnja, është pronë e Kishnicës, e Hajvalisë, rrjedhimisht është pronë e “Trepçës. Nga ana tjetër AKM-ja, na është paraqitur në Komision me një arsyetim se nuk është aset i “Trepçës”.

Këtu jemi para një dileme dhe para një fakti, i kemi argumentet de fakto që ajo pjesë është pronë e “Trepçës” dhe argumentin de jure që sipas Rregullores së UNMIK-ut i takon licenca kompanisë në fjalë që është dhënë. Le të gjykojmë vetë për këtë rast.

Për këtë licencë mandej nuk ka pasur as marrëveshje d.m.th. në mes të pronarit të “Trepçës” dhe licencuesit. Anomali tjetër është se ky vendburim është i njohur dhe i hulumtuar në të gjitha fazat e hulumtimeve gjeologjike, që “Trepça” ka kryer më herët. Andaj çfarë logjike e arsyeton këtë licencë hulumtuese? Çfarë do të hulumtohet në atë zonë? Qeveria mund të justifikohet se nuk ka kompetencë në dhënien e kësaj licence, por mendoj që, e vërteta qëndron ndryshe. Më lejoni t’ua përkujtoj se në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale janë edhe anëtarët të cilët i ka dërgua vetë Qeveria, kështu që indirekt Qeveria dhe Ministria e Energjisë dhe Minierave janë të involvuara në këtë rast dhe me asgjë nuk mund të ikin nga përgjegjësia.

Unë pyes -A është e involvuar vetë Qeveria kur dihet se në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është edhe një zëvendësministër? Andaj nuk na arsyeton shfajësimi se nuk kemi kompetenca. Indirekt kemi kompetenca si Qeveri. Ne si Grup Parlamentar edhe atëherë nuk e kemi mbështet as programin e Qeveritar ta përsëris edhe një herë, nuk e kemi mbështet as Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe kemi pasur arsyet tona. Tani veç po vërtetohen këto dilema. Shihni transkriptet ku janë diskutuar në parlament këto çështje. Andaj rekomandoj që Ministria e Energjisë bashkë me Qeverinë, të marrë hapa konkret dhe institucional në parandalimin e dukurive të tilla, të merren hapa institucional që të krijohet bazë ligjore në këtë fushë dhe bartje urgjente e kompetencave. Të ketë, për momentin koordinim dhe transparencë, në mes të Ministrisë të Energjisë dhe Komisionit të pa varur për miniera dhe minerale. Mendoj që urgjentisht të riorganizohet Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, konform bazës ligjore, respektivisht të vijë në shprehje profesionalizmi i kësaj

fushe, sepse dihet se ai bord ka qenë edhe nga ndërkombëtarët, të cilëve u ka kalua mandati dhe tash duhet të riorganizohet dhe të sillet në Parlament që të votohen anëtarët e atij bordi.

Tërheq vërejtjen se, pasuritë kombëtare siç janë minierat dhe mineralet, nuk i përkasin vetëm kohës dhe mandatit të kësaj Qeverie, por duhet menduar racionalisht dhe moralisht para kohës në të cilën ndodhemi dhe asaj që na pret. Fundja çështja e resurseve natyrore është dhe duhet të jetë kategori kushtetuese. Do me thënë, resurset natyrore janë pasuri dhe për këto pasuri lindin konfliktet dhe bëhen edhe luftërat. Resurset minerale janë bazë e rëndësishme e shtetësisë, prandaj nuk mund të shfrytëzohen përmes politikës ditore.

Unë këtu desha ta pyes shefen e Grupit Parlamentar të Aleancës, nëse Ministria nuk ka pasur mandat ligjor, të lëshojë licenca për pasuri minerale, a ka pasur mandat ligjor ta sjell në Parlament, strategjinë për miniera dhe minerale, apo po pritet që strategjia të bëhet pos festum . kur të mbetet asgjë të mos futet në strategji. Shpresoj që në këtë drejtim të kthjellët Qeveria dhe njerëzit përkatës dhe të sillen të mendojnë edhe për brezat e ardhshëm. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit deputete, dhe si diskutues i fundit deputeti Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Përshëndetje zoti kryesues, zotërinj ministra, kolegë deputetë dhe ju të pranishëm në sallë,

Unë njëkohësisht jam edhe anëtar, në vërtet nënkryetar i Komisionit Funkcional, ku bëjnë pjesë edhe minierat . Dua të them që në fillim gjithçka të sqaroj, se Komisioni ka bërë shumë përpjekje që ta ndriçojë këtë çështje, dhënien e kësaj licence hulumtuese, por Komisioni nuk ka marrë kurrfarë konkluzioni, kurrfarë qëndrimi dhe pavarësisht pse është punua në Komision, konsideroj që Kuvendi duhet ta japë fjalën meritore për këtë dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, sigurisht që ka bërë mirë që ka thirrur këtë interpelancë dhe besoj prej krejt këtyre diskutimeve që u thanë këtu, e ka arsyetua vërtet të jetë një interpelancë e llojit të tillë. Problemi lidhur me hulumtimin e mineraleve në Qukën e Batllavës duhet shtruar thjeshtë dhe qartë, Si është e mundur që, pronën intelektuale, rezervat e verifikuara, përndryshe, të kopanisë” Trepça” që sipas sajë llogaritet një vlerë prej 1 miliard dollarë, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale arrit t’ ia tjetërsojë duke ia dhënë licencën për hulumtim, një kompanie tjetër, pa e ditur askush dhe pa e pyetur askënd, as Qeverinë, as “Trepçën” si pronar.

Pra, një punë e kryer pothuajse në mënyrë ilegale, apo po pyes edhe më thjeshtë- Si, pse dhe kush e dha licencën për hulumtim në një vend ku “Trepça” jo vetëm që ka kryer hulumtimet, për dy dekada, por edhe ka hapur korridore e shumë punë tjera dhe ka bërë punë provuese të suksesshme, pra kjo i bie sikur ta zbulosh rrotën për së dyti dhe të japësh para për te, ani pse rrota është zbulua me shekuj përpara dhe prapë po pyes-Pse rrotën duhet zbuluar për së dyti?. Përgjigja mund të jetë edhe e shkurtër, por edhe e gjatë. Nëse themi si përgjigje e shkurtër e kisha dhënë këtë:

Po japin para për të hulumtuar atë që veç është hulumtuar pasi këtu para se gjithash duket se ka interesa personale të njerëzve të caktuar. Nëse duam një përgjigje më të gjatë, çështjen duhet shtruar në mënyrë më komplekse dhe po mundohem ta shtroj.

“Trepça” më se dy dekada ka kryer punë hulumtuese, si rezultat i të cilave në vitin 1989, është bërë verifikimi i rezervave minerare, mbështetur në Ligjin e atëhershëm për miniera dhe pastaj ka fillua prodhimi provues. Deri më tani në këtë lokalitet nga ana e “Trepçës” janë kryer këto punë: matjet gjeodezike, studimi gjeologjik, studimi gjeofizike dhe gjeoelektrike në sipërfaqe prej 115 km², ndërtimi i rrugës për komunikacion me gjatësi 11 km, blerja e pronës prej 21 ha. dëshmi është fleta poseduse, shpuemjet e thella me gjatësi të përgjithshme prej 6144 metra hapja e 5000 m.koridor 5 km. Verifikimi i rezervave prej 4 milion e 734 mijë tonë. Përgatitja e projektit për hapjen e minierës, termonizimi i plotë i korridoreve me hekurudhë, kanali i ujit, ajri i komprimuar, hapja e oxhakut kryesor, i cili lidhë dy nivele të lartë prej 50 m. Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës mbi sipërfaqe, prodhimi testues i 40 mijë ton xehe, e cila me sukses është flutuar në Flatacionin e Kishnicës.

Punët në hapjen e minierës janë ndërpre në vitin 90 pas përjashtimit të punëtorëve dhe ekspertëve shqiptarë nga puna. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në vend se të komunikojë dhe të konsultojë faktorët relevantë siç janë: Trepça, AKM-ja dhe MEM, si palë me përgjegjësi dhe të sqarojë çështjen e pronës dhe mënyrën e dhënies së këtyre lloj licencave konsultën e bënë pasi e ka dhënë licencën dhe pasi i ka qitur para aktit të kryer këto palë me përgjegjësi. Në fakt 5-6 ditë para se të vendosë për licencën e ka kërkuar t’ia dëshmojë pronësinë, por ajo kohë ishte tejet e shkurtër dhe tregon se KPMM, nuk kishte qëllim të sqarojë problemin, por vetëm sa për ta bërë një kërkesë formale. Përndryshe ka qenë dashur të pret dy muaj ditë, sipas normave. Në fakt e dhe si kërkesë ka qenë e tepër nëse shikohet realisht pasi që edhe KPMM-ja ashtu si “Trepça” dhe AKM-ja e ka pasur tërë elaboratin e punëve të kryera nga ana e “Trepçës”. Këtë elaborat e dinë të gjithë kush ka dashtë me ditë por nuk e ka ditë veç KPMM-ja. Para se gjithash, rrethanat për të bërë punë të tilla tejet të dëmshme për ekonominë e Kosovës janë krijuar me vetë faktin se janë në fuqi dy rregullore, 2005/2 dhe 2005/3, për miniera dhe minerale, të cilat i mundësojnë KPMM-së, që të bëjë ç’të dojë, me minierat e Kosovës, pa i dhënë llogari askujt. Është një rregullore që besoj se askush në botë, nuk do ta zbatonte as nuk do ta aprovonte. Nuk besoj që as në Afrikë që ka të tillë.

KPMM-ja, duke u thirrur në këtë rregullore dhe duke interpretuar keq atë, sipas nevojave të veta e jep vetes të drejtë, që ta japë licencën pa tender dhe t’ia japë atij që emërohet i pari. Nuk është e kontestuar se KPMM, ka të drejtë që të lëshojë disa licenca pa tender të hapur, kur kjo nuk konsiderohet të jetë e nevojshme sipas nenit 22. Por sipas nenit 17.1 nën b) në të njëjtën rregullore, licenca për kërkimin në xehetari iu nënshtrohen tenderit konkurs, nëse kjo është e paraparë nga autoriteti komentet, që në këtë rast është MEM-i që e tha edhe ministri, të cilin as që e ka konsultuar KPMM. Pra, këtu nuk ka pasur kurrfarë konkurrence edhe pse kemi të bëjmë me një pasuri nacionale, me karakter strategjik. Këtë duhet pasur parasysh se dhënia e licencës, përveç se krijon të drejtën pronësore intelektuale, siç e thamë prej 1 miliard në këtë rast, krijon edhe të drejta prioritare për të licencuarit, me rastin e dhënies së licencës për shfrytëzim të minierës së Qukës së Batllavës. Kur ta japin për shfrytëzim sigurisht unë e kam hulumtua këtë dhe natyrisht mua duhet të ma dhashë dhe ka prioritet.

Për këtë arsye një tender i hapur konkurrues do të ishte një procedurë adekuate me qëllim të përzgjedhjes së kompanisë më të mirë dhe të përcaktimit të kushteve më të volitshme për zhvillimin sektorial dhe ekonomik të Kosovës, të në të cilin po thirremi të

gjithë me radhë, kush po mundet dhe ku po mundet. Për ta zëvendësuar këtë rregullore diskriminuese, për ekonominë e Kosovës, ky Kuvend i ka miratuar dy ligje, Ligjin për miniera dhe minerale dhe Ligjin për hulumtime gjeologjike, por kemi pritur që 19 muaj për t'u nënshkruar nga Zyra Ligjore e PSSP-së për kot. Kjo zyrë lere që nuk i nënshkruan këto ligje, por as nuk na sqaron se përse nuk e bënë këtë, e në fakt nuk ka se çka të sqarojë, pasi ajo nuk do të që çështje të rregullohen me ligj, por do që të punohet me këto rregullore me të cilat mund të keqpërdoret pasuria e Kosovës, në mënyrën më të paskrupull.

Pra, do të duhej që të punohej me ligj e jo me Rregullore, për derisa të thirremi të gjithë në të mirën e Kosovës dhe në zhvillimin ekonomik të saj. Se është fjala për përfitime të personave të caktuar jo për të mirën e Kosovës, flet edhe fakti se, në kohën kur është dhënë licenca, në KPMM u tha edhe këtu, ka punuar si anëtar komisioni zoti Aleksandar Valenta, i cili menjëherë pas skadimit të kontratës në KPMM, është punësuar në afat prej 2 muajsh, do me thënë, e ka bërë vendin përpara, se e ka dhënë këtë licencë, në kompaninë të cilën të cilës vet ia ka dhënë licencën, që do të thotë se ka konflikt të hapët interesit. Në fakt, ai ia ka dhënë licencën vetvetës, qoftë edhe vetëm për këtë konflikt interesi kjo licencë duhet rishqyrtuar madje unë do të thosha realisht do të duhej anuluar menjëherë.

Për me keq, "Trepça" kërcënohet nga KPMM, që askush nuk e ceku, e ne në Komision i kemi materialet për këtë, me shkresën nr. 236, vërtet kërcënohet se nuk do ti jepet vlerësim pozitiv për minierën e Kishnicës dhe nuk do të jepet licenca "Trepçës" nëse kundërshton dhënien e kësaj licence, apo të themi më drejtë. Nëse kundërshton marrjen e pasurisë së sajë, atëherë "Trepça" do të ndëshkohet edhe më rëndë dhe institucionet e Kosovës për këtë kërcënim heshtin, ashtu siç po heshtin edhe për faktin se "Trepçës" ende nuk po i jepet licenca për punë, por vetëm për punë provuese. Këtë ministri e din shumë mirë. Në këtë kontekst të këtij kërcënimi, shtrohet çështja se KPMM, a është një mekanizëm për të përparuar minierat e Kosovës, apo për t'i disiplinuar ato dhe manipuluar e keqpërdorur sipas interesave të ngushta të anëtarëve të saj.

Dhe diçka krejt në fund. Shumë na është thënë në Komision, e dinë anëtarët e Komisionit, se ndoshta edhe kemi ne të drejtë, por mos ta ngucim këtë punë se dekurajomë investitorët. Kjo mendoj tregon shumëçka te na, po unë them kështu. Dekurajimi i investimeve nuk bëhet nëse respektohet drejtësia, por atëherë kur veprohet pa pyetur askënd dhe pa u konsultuar me faktorët relevant vendorë dhe mbi të gjitha dekurajon atëherë kur ka manipulime të konfliktit të interesit dhe aty ku në vend të ligjeve të miratuara punohet me Rregullore ku nuk zbatohet asnjë procedurë tenderimi dhe pse krejt në fund, Grupi Parlamentar e ka thirr këtë interpelancë dhe i është drejtuar ministrit.

I është drejtuar ministrit se ministri ,në fakt zëvendësministri në Komision ,

KRYESUESEI BISLIM HOTI – Ju lutem vazhdoje.

Zëvendësministri thotë 5 minuta përpara kur hyra këtu më lajmëruan se kjo licencë është dhënë. Në qoftë se është kështu, thjeshtë unë natyrisht, Grupi Parlamentar i PDK-së, kemi dashur që dihet publikisht se janë nja 5 veta aty, nja tre të huaj e dy vendorë, që na i

kemi zgjedhur prej këtu, edhe unë këtë send nuk e kuptoj LDK-në, pse nuk është me e pezullua këtë për shkak se vetë i ka zgjedhë ata dhe i ka njerëzit e vetë atje . Në këtë sens unë mendoj që interpelanca ka qenë tepër e nevojshme, për të thënë se ministri, AKM-ja, Shtylla e IV, krejt i çojnë duart përpjetë, se vetëm këta 5 veta kanë ditur për këtë licencë dhe kush nuk ka ditur. Tash shtohet dhe një çështje- Si komunikohet këtu në Kosovë, cilat institucione komunikojnë ndërmjet veti? Meqë jepet një licencë ku 1 miliard është pronë intelektuale, pa pyetur askënd . Mendoj që e ka argumentua dhe arsyetua dhe në qoftë se ne nuk e pezullojmë këtë licencë, ne nuk jemi për drejtësi. Ju faleminderit.

KRYESUESI BILIM HOTI – Faleminderit deputetit Xhemajli . Për fjalë janë paraqitur edhe dy diskutues, tashmë veç po shtohet numri i diskutuesve. Në radhë deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Ju faleminderit zoti kryesues. Unë e përcolla me vëmendje këtë debat dhe mund t’ju them të nderuar deputetë përshtypjen time personale se është një prej debateve më të qëlluara që është organizuar dhe po mbahet në Kuvend të Kosovës, që i ka tejkaluar edhe kornizat e interpelancës për një çështje të caktuar. Ishte debat ku të gjithë deputetët, pavarësisht përkatësisë partiake dhe grupeve parlamentare ndanë shqetësimet e njëjta për një çështje shumë të rëndësishme me të cilën Kuvendi nuk është marr sa duhet deri më sot. Unë mendoj se nga ky debat në këtë Kuvend duhet të miratohen dhe të votohen rekomandimet dhe propozoj që Komisioni Funkcional në bazë të transkriptit t’i përgatit Kuvendit dhe nga debati që është zhvillua këtu, rekomandime dhe të na i sjellë për miratim në një seancë tjetër. Unë mendoj se pavarësisht faktit se AKM-ja është kompetencë e rezervuar dhe edhe KPMM, pra Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale punon në bazë të rregulloreve që i ka sjellë UNMIK-u, Kuvendi i Kosovës mund të sjellë dhe të miratojë qëndrime të qarta.

Neve na mungon Ligji për pasuritë nëntokësore, të gjitha, në të gjitha shtetet edhe të BE-së, edhe bujku që e punon tokën të nderuar deputet, pasuri të vetën e ka 50 deri në 75 cm, varet prej shteteve dhe kuvendeve dhe ligjeve që i përcaktojnë është pasuri dhe pronë e tij, Ndërsa pasuria nëntokësore shpallet e tërë pasuria nëntokësore që është e një shteti nën atë trashësi të sipërfaqes. Ne duhet ta sjellim në Kuvend dhe ta miratojmë Ligjin për pasuritë nëntokësore dhe duhet të nxjerrim qëndrim të qartë që Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës nuk do të pranojnë asnjë tjetërsim të pasurisë nëntokësore, nuk bëhet fjalë vetëm për Trepçën këtu por asnjë pasuri nëntokësore pa miratimin e Kuvendit, pa miratimin e institucioneve të Kosovës dhe pa u përmbajt në ligj, këtu hyjnë edhe licenca.

Të nderuar deputetë, pajtohem me parafolësin, që tha se nuk duhet të merremi vetëm me atë se po të dekurajohen investitorët. Duhet qasje ndaj pasurisë nëntokësore, pasurisë tonë, pra qasje e drejtë dhe kjo duhet të rregullohet me ligj.

Edhe ministri Çeku, na prezantoi këtu të gjithë hapat që i ka ndërmarrë dhe shqetësimet që i ka ngritur Ministria, duhet ne të merremi. Këtu i kemi edhe përfaqësuesit e AK-së , pra edhe për dhënien ose privatizimin e “Ferriklit”, a është privatizua vetëm objekti i “Ferriklit” , apo është shitë edhe komplet pasuria minerale e “Ferriklit”? Pra ,a është shitë edhe miniera? Mendoj se këtu ka dallime të mëdha, pra a është shitur komplet “Ferrikli” me gjithë minierat apo miniera ka mbetur pronë e shtetit që duhet kështu dhe

ishte dashtë kështu të vendoset edhe dhënia e licencës për termocentralin “Kosova C”. Ne kemi marrë sqarime nga Ministria, që miniera e Sibovcit do të mbetet pasuri, asete të Qeverisë së Kosovës, ndërsa bëhet vetëm kontrata me investitorin për furnizim dhe garantim të furnizimit me thëngjill për një periudhë të caktuar.

E mora fjalën për këto vërejtjet e mija. Pra, mendoj se Komisioni Parlamentar FunkSIONAL duhet të shqyrtojë debatin dhe t’ia sjell Kuvendit rekomandimet që duhet të miratohen. Propozoj të miratohen në këtë Kuvend. Ju faleminderit,

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit zoti kryetar,

Ne si Grup Parlamentar që nga dita e parë, e kemi mbështetur këtë kërkesë që të jetë një interpelancë ku Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dëshiron që të ketë më shumë të dhëna lidhur me këtë licencë, Në paraqitjen e kërkesës për interpelancë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në kërkesë jep arsyetim ,por nuk propozon rekomandime në fund të seancës, prandaj në përgatitje të kësaj seance, në Kryesinë e Kuvendit me shefat e grupeve parlamentare, është paraparë që ky debat të mbyllet pa votim. Debat apo interesimi i deputetëve dhe i grupeve parlamentare sot, tregoi se kjo çështje është me interes të posaçëm . Ne si Grup Parlamentar i ofrojmë sugjerimin .të cilin e dha të njëjtin edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, të kësaj seance plenare që të fuqizojmë Komisionin FunkSIONAL që ta analizojë këtë debat dhe së bashku me propozuesin për interpelancë në një prej seancave të ardhshme , mundësisht në seancën e parë të ardhshme, të dalë para seancës plenare me rekomandime. të cilat do të fuqizoheshin dhe të ngritën në nivel të një vendimi lidhur me këtë çështje.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI – Faleminderit z. kryetar i Kuvendit. Çdo dëgjues i kujdesshëm e ka parë që interpelanca është thirrur për një temë shumë precize dhe ka kaluar në diskutime shumë, shumë larg saj, nuk do të thosha që nuk janë substanciale, përkundrazi sa më shumë që po zgjerohet rrethi, substanca po rritet. Ka dalë problemi themelor. Në fund po shtrohet çka të bëhet me pasuritë nacionale të Kosovës? A të bëhet moratorium sa të jemi në gjendje që t’i sundojmë këto pasuri, të mos lejojmë të privatizohen. Pak a shumë diskutimi po shkon kah kjo, për çka unë pajtohem në princip. Por ne me gjithë atë e kemi një temë krejt precize. Ka ndodhur dhënia e një licence për hulumtim të një vendi mineral që është “Çuka e Drazhnjës” i thonë ajo krahinë ku është ky vend dhe këtu kishim dy interpretime, ju lutem shumë, me gjithë atë jo vetëm të nuancuara, por shumë të ndryshme. Kemi ekspertë të njëjtit komision parlamentar që thonë: Janë bërë të gjitha hulumtimet dhe “Trepça” e ka të drejtën pronësore autoriale që themi ne të hulumtimit dhe aty nuk ka pasur nevojë të bëhet kurrfarë hulumtimi dhe kemi tezën e dytë ku thuhet: Që të gjitha hulumtimet në Kosovë janë “litut” janë më të lehta dhe po të bëhen hulumtimet me teknologji moderne del që të gjitha pasuritë janë dyfish më të mëdha. Këtu tash kemi dy pozicionime, unë nuk di sa janë profesionale, por që japin nevojën që të jepet e drejta për një licencë hulumtimi ,si në këtë rast dhe tash jemi te problemi pse është dhënë kjo licencë dhe a është dhënë në mënyrë të drejtë? Kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së është pretendimi që licenca është dhënë duke shkelur rregullat

edhe të asaj Rregulloreje ekzistuese dhe duke thënë që ka konflikt interesi. Unë sa di këto janë dy kërkesat themelore fillestare të Grupit. D.m.th është shkelë thuhet dhe Rregullorja që edhe ashtu është e keqe në fuqi dhe ka konflikt interesi. Nëse vërtetohet që është shkelur Rregullorja dhe ka konflikt interesi, ka argumente që të kërkohej ajo që u tha konkretisht nga një deputete këtu që duhet të pezullohet, por unë shtroj pyetje këtu tash. Kush është ai që e ka fuqinë, të jemi konkret që ta pezullojë një licencë, e cila është verifikuar edhe nga AKM-ja? Unë jam, pajtohem që të pezullohet një licencë që është dhënë në mënyrë jo të drejtë. Po kush është organi që e ka fuqinë sot që ta pezullojë këtë licencë? Kjo duhet të jetë përgjigja që duhet ta kërkojë Kuvendi, meqë e ka shpallur këtë diskutim të hapët dhe plus u tha këtu, nuk është dhënë vetëm licenca, por licenca, por është tjetërsuar pasuria. Ky është problem shumë më i madh se për ta dhënë licencën për hulumtim është problem tjetër. Licenca për shfrytëzim është krejt tjetër, tjetërsimi i pasurisë, varianti i tretë më i keq i mundshëm. Ju lutem shumë, unë tash këtu nuk do të shkoj tutje, por mbetet pyetja ime e madhe- Kush prej organeve që ne i popullojmë dhe kemi fuqinë e ndikimit mund ta bëjë juridikisht të pavlefshme një licencë e cila i ka kalua të gjitha fazat e përfaqësuesve të huaj ose vendor në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori.

BEHXHET BRAJSHORI – Faleminderit z. kryetar. Të nderuar ministra, kolegë deputetë. Unë ndaj shqetësimet me kolegët që shprehen lidhur me dhënien e kësaj licence dhe mendoj se ka nevojë për një qasje më të thellë për t'i parë të gjitha kriteret se si është dhënë kjo licencë. Bazuar në Rregulloren 2005/3, nenin 17.n, shihet se Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve ka shfrytëzuar një mundësi, duket se e ka shfrytëzuar, e cila ndoshta deri në fund nuk është qartësuar. Nuk është qartësuar, sepse nuk e kemi ligjin për minierat dhe mineralet i cili në mënyrë specifike përcakton se për çfarë llojesh të mineraleve jepet licenca. Në këtë rast kemi të bëjmë me licencën për hulumtimet . Mendoj se validiteti i licencës për hulumtime mbaron në momentin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me hulumtimet dhe në asnjë moment nuk dua të prejjudikoj licencën për shfrytëzim ose shfrytëzuesin e ardhshëm të mineraleve. Ky është një gabim i madh nëse mendohet në këtë drejtim. Licenca për hulumtime nuk paragjykon shfrytëzuesin e minierave dhe mineraleve në cilindo lokalitet qoftë ai . Në këtë drejtim duhet pasur të qartë edhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe kompania që e ka tash licencën për hulumtim.

Ajo që duhet thënë qartë është se ne duhet patjetër të nxjerrim ose të nënshkruhet Ligji për minierat dhe mineralet, me të cilin do të punonim më tutje dhe ndërprerja e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me dhënien e licencave të reja. Një çështje po ashtu tjetër që ne duhet të kemi sqarim nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik- A është dashur që Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të marrë ose të bëjë tender konkurrues apo jo? Unë mendoj se Kuvendi duhet t'i adresohet Komisionit dhe të marrë sqarim ose komisioni i Kuvendit përkatës që të marrë sqarim nga Komisioni se a është dashur që të merret apo të bëhet tenderi konkurrues në këtë rast. Nëse po është shkelje e rregullave dhe procedurave për çka arsyeton pezullimin e licencës. Nuk dua të komentoj konfliktin e interesave tash, sepse nuk kam të dhëna, por një kriter i atillë pa dyshim se pezullon licencën. Dhe krejt në fund miratimi i strategjisë së zhvillimit të minierave në Kosovë, e cila do të mundësonte po ashtu pikëpamjet tona edhe me infrastrukturën ligjore se çfarë në këtë drejtim mund të bëhet në të ardhmen me rastin e dhënies së licencave të reja për hulumtime gjeologjike dhe hulumtime e tjera ,qoftë edhe të shfrytëzimeve të

minierave dhe mineraleve në territorin e Kosovës. Unë mbështes qëndrimin që një grup i caktuar brenda Kuvendit të marrë diskutimet e bëra në Kuvend, të bëj rekomandime të caktuara për një mbledhje të ardhshme të Kuvendit dhe natyrisht të dalin rekomandimet, të cilat obligojnë do të thosha edhe Komisionin e Pavarur ose Ministrinë me qëllim të veprimeve tjera që do të ishin konform ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

IBUSH JONUZI – Faleminderit. I nderuari kryetar, më vjen keq që në fund pas diskutimeve mjaft të mira dhe me qëllim mjaft përmbajtësor e në veçanti këtë në fund që e tha profesor Sabriu se kush është ai. Dua të bëj vetëm një sqarim se nuk është financuar ose nuk financohet kompania nga buxheti i konsoliduar i Kosovës ,që është gabim kjo të thuhet dhe të dëgjohet prej këtuhit.

Nën dy, nuk është tjetërsuar që e përsëriti edhe deputeti Brajshori, nuk është tjetërsuar prona, pasuria e Kosovës. Është licencë vetëm për hulumtim dhe asgjë tjetër. Licenca për shfrytëzim apo eksploatim është licencë tjetër. Po e përmbylli me këtë që e tha profesor Sabriu. Rregullorja 2005/2 neni 2 pika 2.3 thotë: Komisioni i dorëzon raporte të rregullta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm përmes zëvendësit të Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për rindërtim ekonomik lidhur me të gjitha aktivitetet e Komisionit, duke përfshirë edhe çështjet e personelit të tij, organizimin dhe çështjet administrative. Por, për fund e mbështes plotësisht dhe mendoj se është me interes shumë të madh që ne t'i hartojmë rekomandimet dhe ato rekomandime, siç u tha prej grupit parlamentar në një seancë të radhës t'i miratojmë nga Kuvendi ,se është çështje kapitale për neve. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI – Më duhet të dal për ballë, sepse Ibushi më dëgjon ma mirë kur jam për ballë. I dashuri deputet Ibush. Ti nuk më ke dëgjuar mirë çka thash unë. Unë nuk thashë kush paguan për atë licencë, as që më intereson ajo. Unë thashë krejt diçka tjetër: Diskutimi ynë është bërë shumë substancial në Kuvend që është nisur me një element dhe ka shkuar duke u rritur .Unë mendoj që në kuptimin e asaj që do të quhej parandalesë institucionale e shitjeve ose licencave jo të dobishme, këtë vlerë e ka të jashtëzakonshme kjo seancë sot . Unë e përkrah me të gjitha mundësitë që i kemi, fuqitë vendose që të parandalojmë tjetërsime pasurisë dhe licencat të padrejta. Kjo është nën një Por ne edhe e kemi edhe një diçka që ka ndodhur. Keni kujdes, biseda ka filluar për një akt që ka ndodhur, një licencë të cilën një grup parlamentar- thotë që është e padrejtë dhe sa po duket tash po thonë edhe tjerët. Pra, një problem e kemi përpara. Unë po them dhe edhe një herë po e shtroj problemin. Cila është fuqia e Kuvendit, cilat janë mekanizmat edhe e Komisionit edhe të Kuvendit, që mund ta pezullojë këtë licencë nëse është e padrejtë. Unë sa i njoh ligjet në fuqi, nuk e ka këtë fuqi Kuvendi. Ju nëse e gjeni që e ka, unë votoj që të pezullohet, por unë e di që ekziston një PSSP që e ka emrin e cila në variantin e fundit, prapë është arbitri final. Pajtohem që Kuvendi të organizojë fuqitë e veta që të çmontojë, qoftë licencat e dhëna pa të drejtë. Kaq. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka Ibush Jonuzi.

IBUSH JONUZI – Një sqarim, nuk mendova dhe as nuk thash që profesor Sabriu tha se nuk paguhet apo paguhet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, por e tha deputetja Vezira Emrush. Sa kam mujt me kuptu ajo tha se buxheti i Kosovës ka nda 10 milion euro dhe atëherë pse? Kjo është nën një dhe nën dy. Edhe unë e fuqizova mendimin e Sabri Hamitit se kush është ai që e lexova pasusin e Rregullores 2005/2 pika 3. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka ministri Çeku.

MINISTRI ETHEM ÇEKU – Realisht unë dua të ndihmoj në disa sqarime. Unë dua të lexoj një letër të cilën ne ia kemi adresuar PSSP-së më 2 mars të këtij viti, me të cilën kemi kërkuar, për shkak të zhvillimeve që janë bërë në dhënien e licencave të bëhet edhe një herë një analizë dhe PSSP-ja ta tërheq dhënien e licencës për hulumtim. D.m.th iu ka adresuar dokumentacioni kur është kërkuar që të bëhet pezullimi i licencës për hulumtim. Njëkohësisht është diskutuar dhe unë besoj se Komisioni Parlamentar duhet t'i informojë drejt deputetët se ka pasur debate të vazhdueshme në mes AKM-së dhe menaxhmentit të” Trepçës “për çështjen e dhënies së kësaj licence. D.m.th absolut nuk ka tjetërsim të pronës, nuk ka bartje, këto janë ato të cilat ne sot mund t'i flasim para Parlamentit dhe para opinionit se është bërë edhe tjetërsimi i pronës që nuk është e saktë se është bërë një tjetërsim i pronës. Po ashtu është një dokument, i cili ka ardhur po ashtu nga Komisioni, i cili atë që e tha profesor Sabriu pezullon të gjitha licencat e rëndësishme metalike për 6 muajt e ardhshëm deri sa të aprovohet ligji dhe strategjia e minierave në Kosovë. Pezullohet, është një dokument i nënshkruar, i sjell në bazë të kërkesës që ne si Ministri e kemi bërë dhe e pezullon këtë çështje. Dhe e fundit se kush mund ta pezullojë dhënien e kësaj licence, unë besoj që Komisioni Parlamentar, në bashkëpunim me AKM-në dhe në bazë të rekomandimeve që janë bërë të shtrohet edhe një herë se a është konform Rregullores që ka qenë në fuqi, Rregullores të nënshkruar për menaxhimin e resurseve minerale. A është dhënë, ku janë bërë shkeljet dhe ato shkelje a e kanë cenuar integritetin e dhënies së një licence? Prandaj, unë besoj se Komisioni Parlamentar, Ministria dhe AKM-ja edhe një herë duhet ta rishqyrtojnë në bazë të vërejtjeve që ju sot i bëtë që ne të diskutojmë së bashku me ata.

Dhe në përfundim, të vijmë aty se ku ka pasur shkelje dhe në qoftë se shkeljet janë evidente PSSP-ja apo Gjykata Supreme, Oda Speciale për çështjen e privatizimit e ndërprejnë më tutje dhe e kthen licencën prapa. Edhe një herë dua të them, është licencë për hulumtim. Ka përparësi, por nuk do të thotë që e ka edhe licencën për shfrytëzimin e asaj hapësire që është caktuar. Kjo është e tëra që unë desha ta shpjegoj para jush.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Më vjen mirë vërtet që debati që u zhvillua për këtë interpelancë u zhvillua në mënyrën më të mirë të mundshme dhe tregoi që kërkesa jonë vërtet ka qenë e bazuar dhe në interes të proceseve që po i kalon Kosova. Ju e dini që edhe kohë më parë dhe e kemi përsërit disa herë që Qeveria e Kosovës duhet ta ketë strategjinë që definon se çka është interes nacional. Mendoj që mungesa e kësaj strategjie, e cila do ta definonte se çka është interesi nacional, do t'i pengonte edhe këto paligjësi që po ndodhin në Kosovë. Këtu dëgjuam disa fjalë se mos duke debatuar për pezullimin e kësaj licence i dekurajojmë investitorët. Unë mendoj që mbrojtja e interesit nacional nuk është dekurajim për investitorët. Përkundrazi, nëse diçka i dekurajon investitorët është mosrespektimi i ligjeve dhe mosveprimi mbi bazën e tyre. Prandaj

investitorët do të duhej të dekurajoheshin nëse Parlamenti i Kosovës i mbron ligjet dhe respekton ato. Një çështje tjetër që mendoj se duhet ta kemi parasysh, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nuk e ka bërë kërkesën e tij për t'iu kundërvënë hulumtimeve gjeologjike që do të bëhen në Kosovë, a që duhet të bëhen në Kosovë. Fjala është për një hulumtim që është i kryer, që është bërë, d.m.th në botën demokratike të gjithë angazhohen dhe e mbrojnë të drejtën e autorit edhe të një libri. Në Kosovë janë bërë hulumtime në Çukën e Drazhës, që është afër Batllavës dhe janë shfrytëzuar diku rreth 40.000 ton xehe se miniera do të thotë është e pasur, pse diçka e hulumtuar e zbuluar e shfrytëzuar të hulumtohet përsëri. Nëse duamë të hulumtojmë Kosova ka plot hapësirë që është e pa hulumtuar dhe le të hulumtohet ajo që nuk është e hulumtuar e jo ta bëjmë të bërën, siç thuhet me një fjalë. Mendoj që kjo është arsyeja pse ne kemi kërkuar. Pastaj edhe vetë mungesa e ligjit për 19 muaj e panënshkruar tregon që dikush ka pasur një qëllim për me bërë diçka të jashtëligjshme. Debatimi tregoi se ai “hulumtim” është i pa ligjshëm dhe është në obligimin e këtij Parlamenti që të kërkojë. Edhe unë po pajtohem me diskutimin e Sabriut se ne ndoshta nuk jemi organi që e pezullon licencën, por ne jemi institucion që kemi të drejtë me i rekomandu institucionit përkatës që e ka të drejtën dhe e ka mundësinë me pezullu licencën. Kërkesa jonë duhet të jetë dhe ne duhet të votojmë sot. Ky Parlament duhet të votojë për pezullimin e licencës që organi përkatës ta pezullojë. Ky duhet të jetë obligimi ynë.

Obligim tjetër duhet të jetë edhe miratimi i ligjit dhe pastaj propozuesi mund të hartojë edhe rekomandime të tjera që të miratohen në seancën e ardhshme. Unë mendoj i gjithë debati që është zhvilluar sot tregon se duhet ky Parlament të votojë që organi përkatës ta pezullojë këtë licencë që dihet se është e padrejtë. Në fund të fundit ne si deputet kemi obligim të pyesim Pse e gjithë kjo nguti për privatizimin e interesit më vital të Kosovës? Pse, në kohën kur ende nuk e kemi të definuar statusin politik, kur ai po shtyhet dikush tenton Mendoj që kërkesa që Parlamenti të votojë për pezullimin e kësaj licence dhe këtë e kërkon nga organi që e ka fuqinë, që këtë fuqi do të duhej ta kishte Parlamenti, por te ne nuk e ka Parlamenti, Parlamenti e ka të drejtën për të votuar që organi përkatës ta pezullojë këtë licencë. Ju faleminderit! Z. kryetar unë kërkoj që kërkesa jonë të qitet në votim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në fakt kemi dy kërkesa, dy propozime. Propozimi i deputetit Naim Maloku, Alush Gashit që të autorizohet Komisioni Funkcional të përgatit rekomandimet, të cilat kanë të bëjnë me licencën për një seancë të ardhshme dhe propozimi i përfaqësuesit të PDK-së të interpelancës që Kuvendi të propozojë rekomandime organit kompetent që mund të pezullojë licencën e dhënë nga AKM-ja.

Fjalën e ka profesor Hamiti.

SABRI HAMITI – Jo pse mu përmend emri për ta dhënë edhe një sqarim, por edhe pse po përpiqem që të ndihmoj që të përmbyllet ky diskutim. Funkcionalisht për kah vlerat e dy propozimeve z. kryetar, në të vërtetë janë një propozim, veç se është dallimi që dy grupet parlamentare, meqë nuk ka tekst të shkruar paraprakisht. Mendojnë që mund të shkruhet dhe të votohet në seancë tjetër, ndërsa grupi parqitës i temës për diskutim në të vërtetë kërkon që tash të votohet sot, përndryshe substancialisht, realisht të dy propozimet janë 99% një. Meqë në dorë nuk kemi një formulim asnjëri prej deputetëve, unë mendoj që t'u jepet shans grupeve ose vetë Grupit Parlamentar të PDK-së ose të gjitha grupeve së bashku ose një komisioni funksional që ta ndërtojë atë që në fund të

fundit u pajtuam më në fund dhe z. Krasniqi edhe të gjithë që ne nuk kemi fuqi të pezullimeve të vendimeve, por kemi fuqi ta bëjmë rekomandim të Kuvendit për organin vendosës që kjo të ndodhë. Kaq. Por ne meqë tekst nuk kemi në dorë megjithatë unë mendoj që të gjendet modusi si të ndërtohet ai tekst dhe javën e ardhshme. Ne e kemi të caktuar për sot një javë mbledhjen e Kuvendit, që nuk është larg Unë mendoj, javën e ardhshme, ose fundi i fundit nëse mendojnë paraqitësit e kërkesës që kjo mund të bëhet në fund të kësaj seance le të merren vesh dhe le ta krijojnë për fundin e seancës dhe ta mbarojmë këtë diskutim. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Pajtohem që në të vërtetë nuk ekzistojnë të shkruara rekomandimet tona edhe pse në fjalën time të parën i kamë thënë. Pajtohem që në fund të seancës së sotme t’i përgatisin me shkrim rekomandimet dhe të votohen në Parlament.

KRYETARI KOLË BERISHA – T’i përgatit Komisioni apo grupet parlamentare.

JAKUP KRASNIQI – Ne si propozues fillimisht do t’i bëjmë rekomandimet dhe do t’i konsultojmë të gjitha grupet parlamentare dhe Komisionin, nuk na prish punë ajo.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ - Unë desha diçka të sqaroj se ne e kemi formuar një nën komision . Ne në Rregulloren e UNMIK-ut për dhënien e kësaj licence nuk kemi gjetur që ka bërë shkelje, por është gjetur që ka mangësi. A kemi detyrë ne që ta rregullojmë atë rregullore, a ka ky Parlament, Qeveria, ministri që ta ndryshojnë Rregulloren e UNMIK-ut, urdhëroni kush është ai le të del këtu në foltore dhe të thotë- Unë do ta shfuqizoj atë rregullore të UNMIK-ut dhe të Përfaqësuesit Special. Prandaj po them edhe këtu tash Komisioni të mos të vjen në një pozitë shumë të pavoritshme se ne kemi tentuar ta ndërrojmë Rregulloren, por nuk kemi mund, s’kemi pasur forcë.

KRYETARI KOLË BERISHA - Fjalën e kërkon z. Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Unë i respektoj të gjitha mendimet, por askush nga ne nuk kërkoi me e ndryshuar Rregulloren, Ne e bëmë kërkesën që ligji është vonuar që 19 muaj. Nëse dikush ka vesh me dëgjuar duhet ta di, 19 muaj është vonuar një ligj që është miratuar në Parlament. Pse është bërë kjo? Secili deputet le ta japë përgjigjen e vet.

Tjetër,unë po kërkoj dhe i gjithë debati sot kërkoi pezullimin e kësaj licence ,pse edhe në fund të fundit ka bërë diçka që ka qenë e zbuluar. Gjë të re kjo kompani nuk ka zbuluar në Çukën e Drazhës, ka zbuluar të zbuluarën dhe të diturën. Prandaj, ju lutem edhe kjo është një shkelje edhe e ligjeve ndërkombëtare se jo vetëm ligjeve të ne. Kërkesa jonë është shumë e qartë. Kush nuk do me krye obligimin e vet për ta mbrojtur pasurinë e Kosovës është çështje tjetër. Ne si deputet jemi ardhur këtu për ta mbrojtur interesin nacional të qytetarëve të Kosovës dhe ne po kërkojmë me e mbrojt interesin nacional të qytetarëve të Kosovës. Prandaj , mendoj që është e tepër tash, komisioni nuk e ka kryer punën e vet. Komisioni është dashur të dalë këtu me gjithë punën që e ka bërë ,më gjithë debatet që janë zhvilluar, me gjithë rekomandimet që i ka. Ju lutem, megjithatë debati ka nxjerr diçka shumë të rëndësishme dhe ne këtë debat duhet ta

mbyllim me kërkesën minimale,. Nuk ka kërkesë më të vogël se sa ky Parlament kërkon nga organi përgjegjës ta pezullojë këtë licencë. Çka më pak mund të kërkojë Parlamenti i Kosovës?

KRYEETARI KOLË BERISHA – Shkojmë me rekomandim që brenda ditës së sotme të përgatiten rekomandimet nga ana e Grupit Parlamentar të PDK-së në marrëveshje me grupet parlamentare tjera.

BAJRUSH XHEMAJL - Jam nënkryetar i Komisionit. E thashë dhe po e përsëris edhe një herë. Të mos manipulohet me Komision. Komisioni ka punuar 3-4 muaj 5 muaj sa doni thoni. Nuk ka dhënë asnjë rekomandim , e ka qenë dashur të vijë me rekomandime.S'ka rekomandime edhe sa doni t'i jepni afat edhe 5-6 muaj, deri sa të kryej hulumtimi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka Alush Gashi.

ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Me dashamirësinë më të madhe ju qasëm propozimit që të jemi korrekt sa i përket trajtimit të një pike të rendit të ditës, siç ishte kjo. Ne kemi mbështetur kërkesën e PDK-së për interpelancë. Sipas Rregullores me të cilën ne punojmë, në kërkesën e tyre nuk ka rekomandime, prandaj, rekomandimet për sot janë shumë të ngutshme. Duke e vlerësuar lart substancën e debatit ne sugjeruam, ndërsa tash kërkojmë që të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit. Ne jemi gati si në seancë të vazhdueshme ,sepse sot një javë apo me 28 qershor kemi seancë përsëri. Duke parë përkushtimin e Komisionit FunkSIONAL dhe të Ministrisë lidhur me këtë çështje, mendojmë se është shumë korrekte t'ju jepet kohë në hartimin e rekomandimeve, të cilat duhet të jenë të mbështetura në fakte dhe në eufori. Prandaj, ne z. kryetar ne si grup parlamentar kërkojmë që respektohet Rregullorja, të përgatiten rekomandimet, t'i marrim në shqyrtim në grupet parlamentare dhe në seancën e ardhshme të dalin në votim. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Unë e kam një propozim që të kërkohej nga PSSP-j që të pezullohet licenca përkohësisht dhe nën dy, të përshpejtohet procedura për shpalljen e Ligjit për minierat dhe mineralet. Kjo do të përgatitet deri më datën 28. Fjalën e kërkon z. Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – I nderuari kryetar, të nderuar deputetë. Ne si grup parlamentar dhe unë si shef i tij u përpoqa që të jem sa më racional, por si duket vërtet ose nuk po duam të kuptohemi ose të mirëkuptohemi. Komisioni këtë çështje e ka pasur shumë herë në shqyrtim dhe nuk ka arritur me rekomandime, Ndoshta edhe këtu ka konflikte interesi. Ne nuk deshëm të merremi me vetveten, por kërkesa jonë edhe që doli nga ky debat dhe nuk është më jona, është e këtij Kuvendi dhe kërkesë më minimale se me votuar, duke i rekomanduar organit përgjegjës, në këtë rast UNMIK-ut ,për ta pezulluar licencën nuk ka. Ne thamë po i bëjmë disa rekomandime në fund të kësaj seance. Kjo është kërkesa më minimale që mund të jetë në këtë rast, mund të bëhen rekomandime tjera, por Komisioni duhet të bëjë rekomandime tjera dhe jo vetëm për minierën -Çukën e Drazhnjës, por edhe për shumë çështje tjera që është në përgjegjësi të tij. Ky Parlament mendoj sot në fund të seancës duhet të votojë për këtë rekomandim. Megjithatë ne

respektojmë vendimin e shumicës, por e drejta jonë është që në fund të seancës të kërkojmë për të votuar për këtë rekomandim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Nekibe Kelmendi e ka fjalën.,

NEKIBE KELMENDI - Faleminderit z. kryetar. Jemi futur në një gjendje, në një labirinth nga i cili nuk po mund të dalim. Këtë po e dëshmojnë edhe propozimet e ndryshme. Një propozim tash doli nga ju, tjetri propozim doli nga grupet parlamentare. Nëse e kuptoj kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për interpelancë këtu asgjë konkrete nuk thuhet vetëm se ftohet ministri i minierave për interpelancë.

Sa i përket licencës konkrete për të cilën u diskutua tani, ne si Parlament nuk kemi instrumente as mekanizma, as mandat që të merremi me anulimin, rishqyrtimin e asaj licence etj. Ne kemi mundësi si Parlament që t'i drejtohem Përfaqësuesit Special ta rishqyrtojë edhe një herë licencën konkrete, sidomos nga aspekti i konfliktit të interesave. Nëse gjen se ka konflikt të interesave, atëherë kërkojmë që: do t'i sugjerojmë ose do t'i propozojmë atij që ai ta përdor mandatin e vet apo përgjegjësinë që e ka dhe ta anuloj licencën dhe atë anulimin ta bëj prej kohë kur ajo është nënshkruar, në mënyrë që të mos prodhojë efekte juridike prej asaj kohe, sepse kjo licencë mbetet kështu siç është, pastaj nëse prolongohet edhe nënshkrimi i ligjit për të cilin e u bë fjalë për minierat, pra, atëherë kemi shqetësime jashtëzakonisht të mëdha se ky që e ka fituar këtë licencë do të ketë edhe përfitime të mëtutjeshme. Kjo është çështja të cilën unë desha ta diskutoj këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ibush Jonuzi dhe Gjylnaze Sylja.

IBUSH JONUZI – Faleminderit i nderuari kryetar. Nuk kam ndërmend të zgjas më tepër vetëm një sqarim. Komisioni Parlamentar më 15 maj të vitit 2007 i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit për çështjen në fjalë. Pra rekomandimet ne i kemi bërë. Ju faleminderit.

GJYLNAZE SYLA – Faleminderit. Z. kryetar janë dy çështje që dëshiroj të theksoj në përmbyllje. Një është se rregulla 25.9 thotë se Grupi Parlamentar i cili ka kërkuar interpelancën mund të kërkojë që të votohet një mocion në fund të debatit për interpelancë, me kusht që mocioni të ketë qenë i përfshirë me kërkesën fillestare për interpelancë, Me qenë se ne nuk kemi pasur në interpelancë ose në fillim të kësaj ndonjë kërkesë ose ndonjë rekomandim nga PD, atëherë kemi konsideruar që është mirë që Komisioni ta bëjë një rekomandim ,por të bazuar nga debati i sotëm. Pra ,Komisioni të angazhohet që deri në javën e ardhshme nga debati i sotëm që ka dalë këtu në interpelancë ta bëjë një propozim që votohet me 28 qershor. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A pranohet një propozim i tillë? Ju faleminderit. Kundër 5. Abstenim, nuk ka.

Shkojmë në pauzë deri në orën 14.00

KRYETARI KOLË BERISHA – Vazhdojmë me pikën e 4 të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barërat narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorë.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 7 maj 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Sadik Idriz që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvndit të Kosovës ta prezantoj Projektligjin.

MINISTRI SADIK IDRIZ- Poštovani predsedniče, poštovani poslanici, pozdravljam otvaranje procedure u Skupštini Kosova za usvajanje zakona o narkotičnim lekovima, psikotropskim substancama i prokursovima. Veoma značajnom zakonskom dokumentu za zdravlje građana i zdravstveni sistem Kosova. Sfrha ovog zakona. Gajanje biljaka od koje se proizvodi narkotici i narkotični lekovi i njihova zloupotreba je veliki problem koji uznemiravo gotovo sve zemlje sveta. Problem koji pogađa gotovo sve katorije stanovništva a naročitu mladu populaciju. U posleratnom periodu na Kosovu, postoje više razloga koje doprinose porast ove negativne pojave koja nažalost pogađa najosetljivije i najvitalnije deo našega društva omladinu, najvažniji razlozi su: ekonomski socijalni uslovi, geografski položaj Kosova koja je tranzitna zona i veoma važna raskrsnica puteva, nedovoljna zakonska regulativa i slično. I ako zakon o medicinskim proizvodima i medicinskoj opremi kao i nekoliko administrativnih uputstava kao i uedbi delimično regulisao ovu oblast, nedovoljna zakonska regulativa o kontroli nad narkotičnim lekovima omogućava porast broja korisnika kao i zloupotreba o narkotičnoj substanci. Zavisnost od drogi je jedan veliki zdravstveni problem u svetu i na Kosovu takođe, za to što su narkotične substance imaju direktan uticaj na centralni nervni sistem i zazivaju oštećenje istog, a s druge strane uticaj droge vrlo brzo postiže fiziološku zavisnost koja pretvara korisnike u veoma ladimu ličnost opasno ne samo po sebe i po društvo u celini. Cilj ovog N/Z je sprečavanje zloupotrebe biljaka od koji se proizvode narkotični lekovi kao i sama narkotika, omogućavanje međunarodne saradnje u borbi protiv ove pojave kao i donošenje jednog zakonskog dokumenta koji će staviti pod kontrolu delatnosti oko gajanja biljaka od kojih se proizvodi narkotici i narkotične substance i njihovi prekursori. Poštovani poslanici, tokom izrade ovog N/Z radna grupa se oslanjala na veliki broj međunarodnih konvencija, na zakone koji su već doneseni u zemljama u regionu usaglašavajući sa postojećim oslovima na Kosovu. Kao neophodno stavljanja pod kontrolu biljaka narkotika i prekurseva kao i razvoj međunarodne saradnje za suzbijanje trgovine i zloupotrebe istih prioritet je usvajanje i sprovođenje u što kraćem vremenskom roku zakona o narkotičnim lekovima, psikotropskimi substancama i prokursovima. Finansijska deklaracija. Iz jednog približnog proračuna koji je predstavljen i obrazcu za procenu i finansijski uticaj vidi da samo sprovođenje zakona ne predstavlja ne dostižno vreme za konsolidovani budžet Kosova.

Treba imati na umu da će sprovođenje ovog zakona doprinjeti o punjenju budžeta Kosova o licenciranja pravnih lica za razvoj delatnosti sa narkoticima od izdavanja licencija za uvoz i izvoz kao i tranzit kao i ostale kazne predviđene odredbama ovog N/Z.

Na kraju očekujem da diskusije i ipredlozi doprinjeti da ovaj N/Z još više se obogati kako bi dobili jedan kvalitetan zakon za dobrobit građana Kosova. Hvala!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit ministër. Në emër të grupit parlamentar të LDK-së deputeti Naim Jerliu.

NAIM JERLIU – Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të theksoj që në fillim që grupi ynë e mbështet miratimin në shqyrtimin e parë të Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursor duke konsideruar këtë ligj si shumë të rëndësishëm dhe që ka për qëllim rregullimin e fushës që ka të bëjë me parandalimin e keqpërdorimit të bimëve narkotike dhe të vënies nën kontroll të veprimtarisë me këto substanca. Ky ligj implementimi i të cilit do të përfshijë një varg të ministrive të Qeverisë së Kosovës më se 10 prej tyre dhe po ashtu dy sektor të rëndësishëm, doganat dhe shërbimin policor të Kosovës rregullon fushën e përdorimit të bimëve narkotike, substancave psikotrope keqpërdorimi i të cilave është problem shqetësues me përmasa globale, por që fatkeqësisht është edhe një fenomen që e ka përfshirë në një mënyrë edhe Kosovën, e posaçërisht atë që ne e quajmë kategori më vitale të shoqërisë që në Kosovë nënkupton shumicën e popullatës pra gjeneratën më të re.

Z. ministër i përmendi disa faktor që kanë ndikuar në një mënyrë në këtë aspekt. Ligji përfshin dy dimensionë, rregullimin e fushëveprimtarisë që do të kontrollojë përdorimin e këtyre barërave dhe po ashtu adreson edhe çështjen e ballafaqimit me pasojat që vijnë nga keqpërdorimi i këtyre barërave, respektivisht narkomanin dhe narkomanët, trajtimin e tyre nga ana e Qeverisë dhe mbështetjen për rehabilitimin e tyre psiko-social dhe riintegrimin në shoqëri.

Deri më tani në Kosovë ka pasur një rregullim të pjesërishtëm legjislativ të veprimtarisë me barna narkotike dhe substancat psikotrope është miratuar nga ky vend Ligji për shëndetësi që e ka adresuar shkurt këtë çështje, por më saktësisht kjo çështje është trajtuar me ligjin për produktet medicinale, ndërkaq pjesa tjetër e kontrollit të barnave deri më tani ka qenë e rregulluar përmes rregulloreve të miratuara nga UNMIK-u.

Elementi kryesor që e shquan këtë Projektligj është themelimi i komisionit për narkotikë i cili ashtu siç është përcaktuar në ligj do të ketë kompetenca mjaft të gjëra dhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe vlerësimin e akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj, pastaj edhe monitorimin dhe respektimin e dispozitave ligjore që do të nxirren duke buruar nga kjo rregullativ, duke përfshirë edhe vlerësimin e gjendjes aktuale dhe hartimin e një strategjie për luftimin dhe parandalimin e keqpërdorimit të narkotikëve. Siç e thash implementimi i këtij ligji do të përfshirë punën e më se 10 ministrive dhe kjo do të thotë se me miratimin e këtij ligji ministrinë e Qeverisë së Kosovës do të kenë nevojë që shumë shpejt të procedojnë me nxjerrjen e akteve nënligjore, një nga mangësit e këtij ligji që bie në sy gjatë leximit është se në një mënyrë kërkohet apo precizohet vetëm miratimi i akteve nënligjore dhe miratohen aktet nënligjore vetëm nga ministria e shëndetësisë, Qeveria brenda 6 muajsh detyrohet të themelojë komisionin për narkotikë dhe po ashtu Ministria e Shëndetësisë ngarkohet që të përcaktohen dispozitat që do të detyronin apo afatizonin kohën kur ministrinë e tjera do të duhet të nxjerrin aktet e tyre nënligjore, po ashtu tejet të rëndësishme që kanë të bëjnë me licencimin e operatorëve dhe të gjitha tentimet që duhet të kontrollojnë keqpërdorimin e mundshëm të substancave psikotrope dhe të bimëve narkotike.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet miratimin në parim të këtij Projektligji dhe do të kontribuojë gjatë shqyrtimit në leximin e dytë në komisionet parlamentare gjegjëse.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në sallë aktualisht janë 64 deputet, fjalën e ka z. Bajram Rexhepi në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

BAJRAM REXHEPI – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra të nderuar deputet.

Në kohën kur narkomania ka marrë përmasa brengosësh e sidomos të gjeneratave të reja. Në kohën kur disa rrugë të kontrabandës së drogës kalojnë nëpër Kosovë që e dëmtojnë politikisht imazhin e Kosovës, në kohën kur ka filluar kultivimi i bimëve narkotike, siç është kanabisativa që më parë është përdorur për punimin e litarëve, pra është një përvojë në kultivimin e kësaj bime dhe në kohën kur importimi, distribuimi dhe kontrollimi i substancave narkotike është kaotik ky projektligj paraqitet si domosdoshmëri prandaj edhe i rritet rëndësia këtij projektligji. Implementimi i ligjit për substancat narkotike, për substanca psikotrope dhe prekursor është kompleks dhe multidisiplinar, prandaj jo rastësisht janë kyqur ministrinë, si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Punës dhe çështjeve sociale si dhe Ministria e Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtjes së Ambientit dhe po ashtu Dogana, Shërbimi Policor dhe etj.

Edhe pse Ministria e Shëndetësisë ka të bëjë me këtë lami me gjithë atë unë mendoj se puna më e madhe do t'i bjerë Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Policor dhe Doganave në mënyrë që të parandalohet kontrabanda e drogës, ndërsa Ministria e Shëndetësisë do t'i kryej obligimet e veta konform mundësive dhe me aktet e tjera nënligjore. Me gjithë atë diçka më bie në sy gjatë leximit të këtij Projektligji që i jepet një hapësirë pak më e madhe Ministrisë për Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Ambientit edhe sa i përket kontrollimit, kultivimit të bimëve, asgjësimit të bimëve që për mua është pak paradoksale ajo ma tepër duhet t'i takoj Ministrisë së Bujqësisë, me gjithë atë është ashtu është parapa. Është një fatbardhësi që klima në të cilën ne gjendemi si Kosovë nuk lejon prodhimin e bimës eliktrosilënkoke prej së cilës nxirret kokaina se ndoshta edhe ajo do të kishte gjetë vend të kultivohet në Kosovë. Me qenë se implementimi ka karakter multidisiplinar është i arsyeshëm edhe formim i Komisionit Qeveritar për mbikëqyrjen e substancave narkotike dhe menagjimi, licencimi, distribuimi dhe depozitimi të substancave narkotike. Duhet të përgatiten edhe aktet nënligjore të cilat sipas konventës për barërat narkotike i caktojnë grupet e substancave narkotike dhe ndarjen e karakterit të tyre për aplikim medicinal siç është anestezioni ose shërimi, hulumtim shkencor, konsumim për qëllime narkomanie etj, emrat gjenerik të këtyre substancave janë paraqitur në anekset prej 1 deri në 4 që janë sipas nomenklaturës së vitit 1961 me modifikim në vitin 1972. Mendoj se regjistri i këtyre substancave narkotike duhet të reduktohet sepse një numër i madh i këtyre substancave narkotike kanë dalur nga përdorimi shumë herët, prandaj ma as që përdoren, prandaj nuk është e thënë të kopjohet komplet si ka qenë në vitin 61 dhe 72. Ka gabime edhe në formulim dhe përzierje të kompetencave siq e përmenda në mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Planifikimit hapësinor të cilat me amendamente përmes komisioneve funksionale do të korrigjohen.

Ne si grup parlamentar përmes përfaqësuesve tonë nëpër komisione funksionale do ta japim kontributin tonë në mënyrë që të përgatitet një ligj i qartë i implementueshëm dhe që dukuritë e narkomanisë, kontrabandimi dhe prodhimi i substancave narkotike të minimizohet.

Rehabilitimi i narkomanëve duhet të bëhet në institucionet e specializuara e jo si deri tani në mënyrë të shpërndar, një pjesë e tyre janë rehabilituar nëpër klinika psikiatrike ku ndoshta edhe më së shumti ju takon, disa në ordianca private e disa në mjekësi familjare e disa të tjerë nëpër organizata joqeveritare, me gjithë atë Qeveria duhet të ketë kujdes që të ketë një institucion të specializuar për rehabilitimin e narkomanëve sepse janë pjesë

vitale e shoqërisë që me rehabilitimin e tyre fiton edhe shoqëria dhe nuk duhet të anashkalohen.

Trajtimi i rasteve sociale të kësaj kategorie duhet të rregullohet me akte nënligjore, aty është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por ndoshta nuk i takon asaj që ajo ta bëjë komplet regjistrin e këtyre rasteve të narkomanisë, pra nganjëherë ka interferim të kompetencave në mes ministrive, por mendoj se ky grup qeveritar që do të mbikëqyr përdorimin e substancave narkotike do të ketë edhe funksione të tjera dhe do të jetë më operativ.

Dhe krejt në fund PDK-ja e përkrah këtë projektligj në parim në leximin e parë dhe do ta japim kontributin në leximin e dytë. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-së deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJIE HUNDOZI – Z. kryetar, z. ministra, deputet të nderuar.

Në vitin 1982 në Klinikën Neoropsikiatrike ka vdekur rasti i parë nga predozimi me substanca narkotike dhe me këtë rast jemi bërë të vetëdijshëm se narkomania nuk po ndodh vetëm në vendet fqinje, por është bërë realitet edhe në Kosovë. Numri i personave të cilët e keqpërdorin narkotikët dhe psikotropët është gjithnjë e më i madh dhe është më se e nevojshme një strategji gjithëpërfshirëse për parandalimin e përhapjes së narkomanisë, një e keqe e madhe e shoqërisë e cila nuk ka shërim, prandaj ky Projektligj është më se i domosdoshëm. Me këtë Projektligj parashihet që të formohet komisioni për narkotikët i cili do ta koordinojë aktivitetin në mes të ministrive dhe subjekteve të tjera të kyqura në zbatimin e strategjisë së vendit për kontroll të narkotikëve. Ky komision do ta jap pëlqimin për veprimtarinë e bimëve narkotik dhe një sërë veprimtarishë të tjera shumë të rëndësishme e me këtë ligj është parapa që anëtarët e komisionit të paguajnë vetëm 15 € për një mbledhje, ndërsa asistenti administrativ do ta ketë pagën mujore 162 € në muaj. Nëse anëtarët e këtij komisioni kaq të rëndësishëm paguhet aq pak a nuk do të ngjall idenë për kompensime anësore, gjegjësisht për korrupsion. Nëse dojmë që këta njerëz ta kryejnë punën ashtu si duhet duhet edhe të paguhet mirë. Një kontradit tjetër, në pjesën e paraqitur të kostos buxhetore të këtij Projektligji është te zbatimi i nenit 34 me të cilin përfshihet rehabilitimi dhe asistencë sociale e personave që vuajnë nga narkomania dhe që parashihet të bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kësaj të fundit do t'i kushtoj së paku 150.000 € në vit dhe nëse kalkulimet nuk janë bërë si duhet në fund të të konkludojmë se ky Projektligj ka implikime buxhetore dhe frikohem se edhe ky Projektligj do ta përfshijë fatin e disa ligjeve të cilat janë përpunuar nga komisioni parlamentar i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të cilat kanë pasur koston buxhetore dhe nuk e kanë kaluar leximin e dytë në Parlament ose nuk janë nënshkruar nga PSSP-ja, prandaj propozuesi i Ligjit është dashur që ta bëjë llogaritjen e saktë dhe ndikimin e kostos të këtij ligji në buxhetin e konsoliduar të Kosovës e pastaj ta sjell në Parlament. Deri sa në vendet të botës, edhe një vërejtje kam në këtë Projektligj. Deri sa në vendet e tjera të botës dënimet për keqpërdorimin e substancave narkotike janë të ashpra dhe shpesh janë me burgim të personave që kanë bërë keqpërdorime në këtë Projektligj në kapitullin për dispozitat ndëshkimore për çfarëdo shkelje të dispozitave të këtij ligji parashihet xhoba vetëm në të holla. Nëse me të vërtetë dëshirojmë ta luftojmë dhe ta parandalojmë këtë dukuri e cila në të shumtën e rasteve e përfshinë pjesën më të

ndjeshme të popullatës, gjegjësisht rininë tonë, atëherë duhet të rishikohen edhe masat ndëshkimore dhe të bëhen më të rrepta.

Pos këtyre vërejtjeve ligji është gjithëpërfshirës dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim miratimin e tij.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Orës, deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollqaku.

FATMIRE MULHAXHA – KOLLQAKU – Faleminderit z. kryetar, ministra dhe ju koleg deputet të nderuar. Edhe në Projektligj theksohet që për shkak të pozitës gjeografike Kosova është shndërruar në një regjion tranzitor për shpërndarjen e bimeve dhe narkotikëve ndërmjet vendeve të ndryshme të Evropës. Aftësia e grupeve të organizuara për të eksploatuar kufijt..... dhe ashtu dobët të zhvilluar janë rrezik potencial për stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendit edhe nëse e kemi parasysh gjyqësorin dhe korrupsionin endemik, atëherë është mjaft vështirë të luftohet kontrabanda me këto substanca. Se a kemi nevojë për një ligj? Besoj që edhe kolegët tjerë deputet që e morën fjalën para meje dhanë mjaft argumente për faktin se jo vetëm që kemi nevojë, por është domosdoshmëri e kohës.

Ligji sa do të jetë i implementueshëm dhe cilat do të jenë vështirësitë qëndrojnë në faktin se edhe këtu, për kundër faktit se edhe Ministria e Shëndetësisë është sponsorues i këtij Projektligji, me gjithë atë shumë ministri duhet ta japin kontributin në vetë që ky ligj të jetë i implementueshëm, me siguri edhe Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë njëra ndër ministritë që duhet shumë të kontribuoj duke i përfshirë edhe doganat, se po dihet se si po shkon kanali i qarkullimit dhe kah kalojnë që jemi bërë vend transit.

Në anën tjetër këtu është problemi i të brinjëve kosovarë dhe ne mund t'i mshelim sytë, por një fakt evident është edhe në bazë të të gjitha hulumtimeve që janë duke i bërë edhe organizatat joqeveritare, por edhe institucionet, si Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, për kundër faktit që nuk e kemi një datavez me gjithë atë kemi fakte që flasin në favor të asaj që numri i vartësve nga droga janë në rritje e sipër dhe popullata më e prekur janë të rinjtë, d.m.th e ardhmja e jonë.

Brengosja ime qëndron në faktin se kryesisht ligjet lidhen me aktet nënligjore të cilat tek duhet të nxirren dhe e bëjnë prolongimin e implementimit të ligjeve. Mendoj se duhet të filloj praktika edhe në Qeverinë e Kosovës që krahas hartimit të Projektligjeve të bëhet edhe hartimi i akteve nënligjore apo së paku 3 muaj pas nxjerrjes së ligjit të jenë në fuqi, sepse jemi dëshmitarë që shumica e ligjeve jo vetëm që këtu theksohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të nxirren akte nënligjore, por shpesh kjo prolongohet më gjatë dhe në pjesën më të madhe e bën ligjin e paimplementueshëm, vetë fakti që duhet të hartohet programi për parandalimin e përdorimit ilegal të barnave narkotike dhe substancave psikotrope dhe zvogëlimit të përhapjes së narkomanisë, pastaj duhet të formohet komisioni që thamë që duhet të jetë një komision ndërministror, atëherë kushtet e dhënies së licencave dhe procedura e operimit tek do të përcaktohen me akte nënligjore, tregon që shumë çështje do të rregullohen me akte nënligjore, prandaj ne edhe njëherë i apelojmë Ministrisë dhe ministrive të tjera që të jenë shumë të kujdesshme që ta përshpejtojnë hartimin e akteve nënligjore se është në interes të veçantë të Kosovës që ta kemi një Projektligj i cili do të jetë i implementueshëm.

Gjithashtu edhe unë do të kthehem te neni 34 ku flitet për implikime buxhetore, të vetmet implikim që përmenden janë 150.000€ që kanë të bëjnë me rehabilitimin për personat që janë vartës të drogave, mirëpo mendoj që kostoja është shumë më e madhe realisht edhe

pse mendohet që shumica e Ministrive me buxhetet aktuale do t'i mbulojnë ato shpenzime, me gjithë atë ne gjatë hartimit të projektligjeve duhet të kemi shumë kujdes sa i përket kostos sepse edhe ajo është pengesë në implementimin e Ligjeve.

Një vërejtje e kamë pasur nga ekspertët të cilët kanë punuar në hartimin e Projektligjit që nuk janë marrë shumë për bazë vërejtjet konkrete të ekspertëve që kanë qenë pjesë e grupit punues. Kjo është si përfundim dhe njëherit Grupi Parlamentar i Orës i jep përkrahje këtij Projektligji dhe kontributin do ta japim edhe në Komisionin funksional gjatë amendamentimit të këtij Projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ Shpresa Murati

SHPRESA MURATI – Hvala. Poštovani predsedniče, ministri, g. Poslanici.

Zloupotreba biljaka od koje se proizvode narkotici kao od jedna od negativnih pojava u društvu zavređuje i zaslužuje snačaji preventivni pristup. Mnogi autori narkomanie naivaju društvenim zlom gde mlada populacija je najugroženija i najosetljiva struktura društva. Upravo u cilju sprečavanja zloupotreba ovih biljaka i narkotika izrađen je ovaj predlog zakona koji će staviti pod kontrolom delatnosti ovim biljkama, narkoticima i prekurzorima.

Narkomania se ne može iskorenti, ali se za to može kontrolisati. Sprovođenje ovog zakona zahteva međusobne saradnje većeg dela postojećeg ministarstava i blisku međunarodnu saradnju. S teoga je proizašla i potreba osnivanje komisizje za narkotike koja će ocenjivati podzakonske akte, koja donosi Vlada predviđenim ovim zakonom, vrši nadzor poštovanja odredbe ovog zakona, ocenjuje aktuelno stanje, sastavlja strategiju za suzbijanje ispsrečavanje zloupotrebe narkotika i naravno trudi se sa sprovođenje te strategije.

Moramo obratiti pažnju i na izjavu agencije za evropske integracije koja predivda propis kojim će se regulisati etiketiranje ovih substanci pre nego se stave u promet. Parlamentarna grupa 6+ podržava ovaj predlog zakona smatrajući ga značajnim i neophodnim kao i povezivanje zemajla u regionu i usklađivanje zakonodavstva koja će dovesti do efikasije borbe protiv zloupotrebe droga i psihotropnih substanci.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit për Integrim dr. Ferid Agani.

FERID AGANI – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra të nderuar kolegë. Kemi të bëjmë me një akt ligjor, një projektligj dhe nuk e di sa e keni të njohur, por paraqet njërin prej akteve ligjore më të rëndësishëm në procesin e mekanizmit të asocim-stabilizimit të Kosovës në Bashkësinë Evropiane. Një prej ligjeve në të cilën vëhet vëmendja më e madhe dhe është përcaktuar si një prej standardeve që Kosova duhet t'i mbërrij në procesin e stabilizim asocimit. Konkretisht ka të bëjë me bashkëpunimin që Kosova duhet të vendos në Bordin Ndërkombëtar, për kontrollin e narkotikëve që gjendet në Vjen dhe ky ligj kur të miratohet do të siguroj një bazë solide ligjore, në bazë të së cilës ky bashkëpunim do të realizohet. Për gjendjen në këtë lami në Kosovë folën parafolësti e mi dhe nuk dëshiroj t'ju lodhi, janë bërë edhe hulumtime konkrete shkencore, ka të bëjë me atë të verifikuar që nga viti 2002 të cilat dëshmojnë se Kosova për fat të keq sa i përket konsumimit të substancave narkotike është në nivelin e shumë shteteve të bashkësisë evropiane. Në të njëjtën kohë ballafaqohemi me një mungesë të skajshme të shërbimeve shëndetësore për këtë kategori dhe qregullimeve shëndetësore dhe dëshmia

më e mirë për këtë është të shiqohen vetëm buxhetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrive të tjera relevante në të cilat nuk ekziston asnjë vijë e ndarë buxhetore prej të cilit do të financoheshin këto shërbime.

Ti kthehem konkretisht projektligjit, të filloj së pari me grupin punues, t'ju them drejt kamë qenë i befasuar me faktin se në grupin punues nuk ka qenë prezent asnjë psikiatër ose neuropsikiatër, d.m.th. profesionist të cilët merren me këtë lami në baza ditore dhe të cilët me siguri se do të kontribuonin në kualitetin më të lartë të tij.

Kjo është përcaktuar edhe në nenin 6.2 të Projektligjit ku bëhet fjalë për komisionin për narkotikë si një këshill ndërmënytor i cili do të menagjoj situatën në këtë lëmi, i cili poashtu nuk e ka të paraparë asnjë neuropsikiatër, psikiatër si anëtar, njëkohësisht ky komision nuk parashihet asnjë shfrytëzues i shërbimeve, pra asnjë shfrytëzues i substancave narkotike gjë që është praktikë në të gjitha shtetet e avancuara. Njëkohësisht nuk është e përfaqësuar shoqëria civile fare në këtë komision. Është e qartë se këtij Projektligji i mungon një dorë kimike, i mungon një opinion shkencor profesional, psikiatrik i cili do t'i jepte zgjidhjet shumë më adekuate ligjore sa i përket shërbimeve shëndetësore. Mbështetur në mungesën e ekspertëve të kësaj lëmie në grupin punues, kemi p.sh. edhe situatën që neni 32.4 dhe 32.5 parashihet nxjerrja e dy programeve të ndryshme lidhur me këtë çështje, programit të përgjithshëm në nivel të Qeverisë dhe programit të veçantë në nivel të ministrisë së Shëndetësisë, po ashtu mungon elaborimi më detaj i sistemit të shërbimeve shëndetësore që duhet ofruar që e përmendi dr. Rexhepi çështjen e Institutit të specializuar për trajtimin e këtyre sëmundjeve etj.

Në aspektin teknik projektligji ka disa mangësi e veçanërisht në pjesën e përkthimit të tekstit në gjuhën serbe dhe angleze, vende vende edhe në gjuhën shqipe, ka disa mangësi përmbajtësore në pjesën e anekseve, konkretisht në tabelën 3, mungon p.sh. substanca e tramadollit që është një substancë e cila njihet në treg me emrin vaji trodon i cili është një prej substancave psikoaktive të cilat më së shumti keqpërdoren në mjedisin tonë.

Së fundi Grupi Parlamentar për integrim konsideron se ky është një tekst i pranueshëm ligjor, është mjaft gjithëpërfshirës në segmente të caktuara mjaft i elaboruar dhe i përpunuar, me këto mungesa që i përmenda dhe nëse tejkahen atëherë mund të llogarisim në një akt ligjor i cili do të mundësojë fillimin e tejkalimit të situatës së pavolitshme në këtë aspekt. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të LDD-së deputeti Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Faleminderit kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe deputet të pranishëm.

Grupi parlamentar i LDD-së ka shqyrtuar Propozimligjin për barërat narkotike, substancat psikotrope dhe ka vlerësuar që në parim ta përkrah në shqyrtimin e parë me arsyetimin se do ta jap kontributin e vetë në procedurën e mëtutjeshme Kuvendore dhe në veçanti në fazën e amendamentimit përmes komisionit funksional. Bazueshmërinë e aprovimit në parim të këtij propozimligji ne e shohim me sa vijon: 1. Tendencën e zvogëlimit të mundësive të keqpërdorimeve të barërave nga të cilat përpunohen apo përfitohen materiet narkotike dhe barnat narkotike si dhe substancat e dëmshme për shëndetin e njeriut. 2. I tëri ky qëllim konsiston në vuarjen nën veprim, pra në vuarjen e veprimeve në ligj të bimëve narkotike dhe produkteve të tyre. 3. Pengimin e mëtutjeshëm të përhapjes në shoqërinë Kosovare dhe në veçanti në mesin e rinisë nga kjo dokuri famkeqe e shoqërisë bashkohore. 4. Ndonë se Kosova nuk është terren ende i kultivimit

të bimëve narkotike së paku ashtu i trajtuar, LDD-ja konsideron se në këtë propozimligj duhet krijuar bazë të fortë juridike për të mos shfrytëzuar Kosovën si shtet transit për shpërndarjen e bimëve narkotike në Evropë dhe më gjerë e posaçërisht përmes sistemit doganor dhe kontrollit të përhershëm në terren në kultivim. 5. Derisa ligji që ndalon këtë veprimtari është i mangët: në këtë propozimligj dëshirojmë të arrijmë rregullimin ligjor të kësaj çështje siç është e rregulluar edhe në shoqëritë tjera në harmoni me primet e legjislacionit të Bashkësisë evropiane, por natyrisht edhe kushtet specifike që ka Kosova. Shoqëria Kosovare në tërësi dhe tradicionalisht ishte larg drogës dhe tani si shihet duhet të krijoj bazë ligjore shumë të ashpër me të cilën sanksionon penalizon dhe dënon prodhuesit, tregtuesit mbajtësit dhe konsumatorët e këtyre lëndëve narkotike dhe qëllimet dhe dëmet që u theksuan më parë. Ne vlerësojmë se nëse dëshirojmë ta ruajmë shoqëroinë dhe të kemi shoqëri të shëndoshë duhet patjetër të ndalojmë përhapjen dhe konsumimin e tyre dhe atë në mënyrë recidive për të ruajtur rininë me këtë propozimligj por me dispozita shumë më të forta sanksionuese dhe penalizuese për ata që e bartin këtë dukuri. Në këtë drejtim mendoj se është shumë e arsyeshme që nga ekspertët e narkotikës dhe profesionalistët e bimëve narkotike dhe ata të ligjit të mbajnë shqyrtime publike dhe natyrisht të jenë anëtar të komisioneve dhe bordeve udhëheqëse të debateve me nivelet më të njohura lidhur me këtë dhe të njoftohet popullata me ligjin që qëllimet e këtij propozimligji dhe ndëshkimet që mund t'i psojnë shkelësit e tyre, për ndryshe do jemi lart realizimit të qëllimit që parashtrohet ligji që në fillim. Natyrisht se edhe ky Propozimligj fillon gabimisht në bazueshmërinë juridike, në rregullat e UNMIK-ut e në kornizën kushtetuese si akt më të lart juridik, dukuri e cila po përsëritet prej ligji në ligj, apo prej Propozimligjit në Propozimligj, është shumë mirë e sanksionuar se e tërë kompetenca bie në agjencinë kosovare për produktet medicinave lidhur me këtë fushë dhe çdo veprim jashtë saj duhet të jetë shumë i ndëshkueshëm. Mbështetur në faktet, rrezikshmërinë në përgjithësi të paraqitura për bimët narkotike dhe produktet e tyre në raportet në mes të ndëshkimit dhe qëllimeve që dëshirojmë t'i arrijmë, ne mendojmë se masat ndëshkimore janë mjaft simbolike po thuaj se nuk qojnë në peshë me shitjen e barnave narkotike në raport me atë që fitojnë tregtarët dhe atë që shkaktojnë dëmin, pra duhet të kemi vëmendje shumë të madhe që masat ndëshkimore të jenë shumë më të rënda dhe të penalizuara edhe me denim me burg e jo siç u cek edhe më lart. Ne konfirmojmë se përkrahim si të domosdoshëm procedurën e mëtutjeshme të këtij propozimligji. Ju faleminderit.

BASHKËKRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit. Në radhë është dr. Fehmi Vula.

FEHMI VULA – Faleminderit z. kryesues. Z. ministra dhe kolegë të nderuar. Më në fund e kemi një ligj shumë të rëndësishëm në duart tona i cili sikur të kishte ekzistuar menjëherë pas luftës mendoj se do t'i kishte anët shumë të mira pozitive se sadopak do të ndikonte në zvogëlimin e numrit kaq të madh të njerëzve, të të rinjëve tanë të cilët fatkeqësisht konsumojnë këtë materie shumë të dëmshme për trupin e njeriut, gjegjësisht për trurin e njeriut. Numri i konsumuesve të drogës çdo ditë është në rritje e sipër dhe nga ana tjetër pozita gjeografike e Kosovës është bërë një vend transiti shumë të madh të drogës veri-jug dhe perëndim – jug. Unë do të isha ndalur kryesisht në mënyrën e prevencës dhe shërbimit. U thanë shumë gjëra këtu, do të mundohem t'i them vetëm ato që nuk janë thënë. Fillimisht thamë se bëhet fjalë për një Ligj i cili kujdeset vetëm për format e menagjimit legal të materieve psikotrope e narkotike. Për ato ilegale nuk kemi njohuri, për arsye se nuk janë në sferën e këtij ligji dhe bëjnë pjesë me siguri në kodin

penal. Sa i përket prevencës dhe shërimit, ne e dimë se prevenca është e një rëndësie shumë të madhe, shumë më e rëndësishme se sa e shërimit, për arsye se shërimi është fatkeqësisht shumë i dobët, shumë i mangët për shkak të dëmtimit shumë të mëdha të cilat ngjajnë në sistemin qendror nervor, gjegjësisht në tru. Në pervenca duhet të kemi një kujdes të posaqëm në format e ndryshme të vetëdijesimit të popullatës, kryesisht të rinjëve nga të gjitha format dhe asociacionet e ndryshme të cilat merren me këtë lami qfarë është edhe ky i shoqërisë civile etj.

Sa i përket pervencës e kamë një vërejtje shumë të theksuar se ata të cilët kanë fillur veç të marrin droga ata e kanë një formë shumë legale të ardhjes pa kurrfarë telashe deri te drogat, por atyre u mungojnë drogat cilësore, ne kemi përveç morfinës e cila shitet nëpër barnatoret tona kemi edhe një numër të konsiderueshëm të barnave me të cilat në mënyrë shumë të mirë të arsyeshme e mbulojnë, arsyetojnë dhe e plotësojnë mungesat në treg të drogave të ndryshme, këto preparate, këto medikamente fatkeqësisht mund të mirren shumë shpesh qfarë është praksa në barnatoret tona private çak edhe pa recent të mjekut, unë kamë besim në komisionin parlamentar do të sugjerojë që ose me akt të posaqëm normativ, barnatoreve tona t'u jepet një theks i veçantë në ndalesën e shitjes legale të këtyre barërave, kjo është edhe njëra prej formave të cilën duhet patur në konsideratë Ministria e Shëndetësisë që më në fund të mos lejoj funksionimin barnatoreve pa farmacist, kjo për arsye se prezenca e farmacistit e rritë peshën e deliktit shumë më tepër se sa prezenca e një tekniku ose të një personi tjetër që fatkeqësisht nëpër barnatoret tona edhe personat që nuk kanë lidhshmëri me farmacinë ata punojnë dhe gjegjësisht shesin barna. Jam i mendimit se në ligj parashihet se shërimi i atyre të cilët përdorin drogë mund të jetë çdo institucion i licencuar. Unë jam i mendimit se çdo institucion i licencuar privat ose shoqëror ta bëjë një punë të tillë nëse klienti shpreh gatishmërinë që të kërkojë ndihmë në drejtim të shërimit, por jam shumë i bindur se nënqiellit tonë i duhet patjetër një institucion shumë i specializuar në kuadër të Qendrës Klinike Universitare i cili do të mirret së paku me rastet ma drastike, me rastet me dëmtime më të theksuara të sistemit qendror nervor.

Menjëher vjen një pyetje se a ka implikime të mëdha financiare: Unë mendoj se ka, por jo aq të mëdha sa që do të ishin të papërballueshme, së pari se do të fitohen mjete financiare nga mbledhja e taksave nga licenca, nga denimet, por në botë kemi fondacione të shumta të cilat janë të gatshme me dhanë mjete e nëse dijinë të aplikojnë të marrin parasysh se kjo është në interesin reciprok, jo për t'i ndihmuar vetëm Kosovës, por në këtë formë i ndihmojnë edhe vetvetes, prandaj jam i bindur se ka mundësi që ne gjejmë mjete financiare që do t'i dalim në kry dhe do ta zbusim sado pak për mos me thënë sado shumë këtë efekt shumë të keq që bëjnë materiet narkotike në organizmin e njeriut dhe krejtësisht në fund, në ligj nuk e kemi të precizuar se si do të jetë forma e aszgjasimit, çfarëdo forme që do të gjejnë materiet narkotike dhe psikotrope, për arsye se nuk bëhet fjalë për barëra të rëndomt ku një komision ad-hoc i formuar do t'i fut këto në insenerator dhe përfundon çdo gjë, këtu duhet të jetë një kontroll shumë më e theksuar dhe kjo nuk është e precizuar në këtë ligj dhe mendoj se është një mungesë. Ju faleminderit.

BASHKËKRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit. Në radhë është Zahrije Jusufi, ndërsa në përgatitje deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI – I nderuari z. kryesues të nderur ministra dhe deputetë. Mendoj se para procedimit të mëtutjeshëm të Projektligjit Qeveria duhet t'i sqarojë

mundësitë e implementimit të ligjit dhe të kostos shtesë sepse përpos kostës së kalkuluar dhe të paraqitur nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Projektligji vlerësohet të ketë edhe kosto shtesë në dy nene shumë të rëndësishme.

1. Në parandalimin e përhapjes së narkomanisë sipas nenit 32 dhe
2. Rehabilitimi dhe asistenca sociale e personave që vuajnë nga narkomania në nenin 34.

Përpos kësaj rekomandojë që të parashihet edhe një dispozitë shtesë që do të rregullojë trajtimin gjegjësisht furnizimin e rregullt me barëra të listës esenciale të personave që vuajnë nga narkomania në institucionet publike ku bëhet mjekimi i tyre. Mendoj se disa nene të Projektligjit duhet të rishqyrtohen.

Në Projektligj në nenin 6 parashihet që Qeveria të themelojë komision për narkotik për koordinim të aktiviteteve të ministrive dhe për hartim të strategjisë për kontroll të narkotikëve dhe të prekursorve të cilën duhet ta miratoj Kuvendi.

Ndërsa në nenin 41 Qeveria është e obliguar që brenda 6 muaj ta themelojë komisionin për narkotik nga hyrja e Ligjit në fuqi. Ndërkaq deri në themelimin të Komisionit nuk do të kemi program të përgjithshëm dhe të veçantë për parandalimin e përhapjes së narkomanisë.

Në nenin 32.2. për trajtim të narkomanisë thuhet. Narkomania trajtohet në bazë të vullnetit të lirë të personit ose të kujdestarit ligjor apo vendimit të gjykatës. Mendoj se nuk duhet t'i lihet vullnetit të lirë për kushtet tona. Mendoj se këtu më e rëndësishmja është siguri i barërave për trajtimin e tyre.

Neni 33.3 mendoj se duhet të specifikohet se cilat institucione shëndetësore duhet të merren me trajtim të narkomanisë. Ata duhet të trajtohen në qendra speciale për sëmundjet e varshmërisë në mungesë të tyre në qendrat e shëndetit mendorë dhe në spitalet psikiatrike.

Në nenin 42 me qëllim të zbatimit të Ligjit Ministria e Shëndetësisë është e obliguar që brenda 12 muajsh do të nxjerrë aktet nënligjore të parapara, mendoj se afati duhet të shkurtohet në 6 muaj sepse Ligji vështirë se mund të implementohet në afatin e paraparë nga se shumica e veprimtarisë së Projektligjit parashihet të rregullohet me akte nënligjore. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI - - Faleminderit z. kryetar. U fol mjaftë nga ekspertët e fushës gjegjëse lidhur me këtë ligj. Unë do t'i qasem nga një aspekt tjetër. Nëse kemi njerëz që janë të varur nga përdorimi i narkotikëve atëherë unë do të sugjeroja që në fazat e amendamentimit të këtij ligji të parashikohet që Ministria e Rendit ta ketë listën e saktë të personave të cilët janë të varur nga përdorimi i narkotikëve dhe me atë listë t'i furnizojë të gjitha barnatoret e licencuara në mënyrë që kur të jepet nga mjeku bari i cili përmban substancë narkotike të jepet me reketë të dyfishtë dhe në fazat të caktuara kohore që do me thanë ose brenda muajit ose si ta sheh të arsyeshme mjeku ordinues. Nga ana tjetër mendoj se kur jemi te kapitulli i 9 i cili e rregullon çështjen e dispozitave ndëshkimore. Këtu i kemi përzi sikur shkeljet administrative, kundërvajtjet, dhe veprat penale. Nëse

kemi shkelje administrative në rregull do të kishte vend këtu për të shqiptuar edhe gjoba kur të përshkruhen mirë se çka paraqet shkelje administrative.

Nga ana tjetër për posedimin, vënien në trafikim e rastet tjera, këto kurrsesi kundërvajtje nuk paraqesin, por paraqesin vepër penale, e kur jemi te vepra penale për përdorimin vënien në qarkullim, posedimin e tjera të substancave narkotike dhe psikotrope, atëherë me kodin penal të Kosovës janë të parapara edhe sanksionet penale.

Nëse ne e lejmë këtë pa e rregulluar këtë pjesë të veprave penale dhe e lëmë kështu si është me këtë projektligj atëherë do të krijohet një dualizëm kur ky projektligj të shndërrohet në ligj, do të krijohet një dualizëm sa i përket shqiptimit të veprave të sanksioneve penale sepse sikur që thash kjo çështje është e rregulluar me kodin penal dhe me atë rast nëse mbetet edhe pjesa e sanksioneve penale të rregullohet me këtë ligj atëherë ne e kemi shfuqizuar ato dispozita të kodit penal të cilat i rregullojnë sanksionet penale për këto vepra penale sepse është ai parimi i mirënjohur në drejtësi, që domethënë ligji i mëvonshëm e suspendon ligjin e mëparshëm që është nxjerrë, prandaj unë do të propozoja që në fazat e amandamentimit të këtij ligji pjesa që ka të bëjë me veprat penale dhe sanksionet për ato vepra penale e që është përfshirë në këtë kapitull, në kapitullin 9 të hiqet prej këtij ligji. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, profesor Mark Krasniqi. Ju lutem deputetët të cilët nuk janë në sallë le të kthehen sa më shpejtë të votojmë.

DEPUTETI MARK KRASNIQI – I nderuar kryetar të nderuar deputetë, ky ligj është më se i nevojshëm sepse është tepër rrezik i madh që të deformohet një pjesë shumë e madhe e shoqërisë sonë nga importimi e sidomos nga përdorimi i drogës.

Ky ligj për ta pas efektin e vet duhet ta ketë edhe mbështetjen më të gjerë të shoqërisë sepse vetëm në paragrafë të ligjit nuk mbërrihet shumë në qoftë se këto paragrafë nuk hynë në jetë. Para se gjithash duhet të angazhohet në përkrahje të këtij ligji edhe kundër drogës, familja që në rrethin e vet më të ngushtë ta informojë domethënë rininë për rrezikun e madh që e paraqet përdorimi i drogave, prandaj, shkolla gjithashtu duhet ta luajë këtë rol shumë të rëndësishëm, edhe mjetet e informimit madje ishte dashur të botohet një literaturë e posaçme në formë të librave ose broshurave të vogla për rrezikun e gjithë atyre llojeve të drogave që mund të përdoren këtu. Ne jemi si u tha edhe përpara, ne jemi në udhëkryq këtu ku droga po importohet jo vetëm për Kosovën, por edhe për eksport, po kemi nga një herë raste të tilla, prandaj po them duhet shoqëria të angazhohet në mënyrë të gjithanshme që të luftohet ky rrezik shumë i madh për shoqërinë tonë e sidomos për rininë e cila duhet të jetë e shëndoshë e duhet të jetë në rrugë të drejtë edhe me shëndet të mirë.

Përdorimi i drogave është një kancer i madh, ne e kemi ma tepër frikë nga kanceri se sa nga droga, ajo njësoj është vetëm se droga është ma joshëse edhe ma e pa rrezikshme në fillim, por përfundimi dihet. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, meqë nuk ka më kandidatë të paraqitur për diskutim shkojmë në votim të ligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë aktualisht janë 62 deputetë.

Për..... 59;

Kundër..... 1.

Kalon ligji.

Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si funksion funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Çështjet Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisioni për Komunitete.

Komisioni duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit.

Pika e 5 e rendit të ditës

5. Shqyrtimi i parë i projektligjit për dokumentet e udhëtimit

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 1 qershor të vitit 2007, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin e tij dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin Blerim Kuçi që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTRI BLERIM KUÇI - I nderuar z.Kryetar,të nderuar deputetë,

Nevoja për nxjerrjen e Ligjit për Dokumentet e udhëtimit është me interes të veçantë për Kosovën dhe qytetarët e sajë, sepse përmes dokumenteve të udhëtimit qytetarëve të Kosovës, u mundësohet lëvizja e lirë në shtetet tjera pra kalimi i kufirit shtetëror. Projektligji është përgatit duke pas parasysh rrethanat dhe kërkesat e reja në Kosovë , për Dokumentet e udhëtimit. Gjatë kësaj periudhe qytetarët e Kosovës,janë pajisur me dokumentet e udhëtimit pasaportat e lëshuara nga UNMIK-u,ndërsa me këtë ligj shtetasit e Kosovës,do të pajisen edhe me dokumente tjera të udhëtimit të parapara në nenin 7 të Projektligjit, ndër to edhe me pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare për stafin udhëheqës të insitucioneve kryesore të Kosovës dhe stafin diplomatik e politik të cilat do të lëshohen nga Ministria për Punë të Jashtme, e cila shpresojme se do të themelohet së shpejti .Çështje tjetër me rëndësi e që lidhet me Dokumentet e udhëtimit është edhe përcaktimi i simboleve të Kosovës pasi dokumenti i udhëtimit duhet ta përmban edhe simbolin e shtetit të Kosovës. Mbesim me shpresë se së shpejti do të përcaktohen edhe simbolet e shtetit të Kosovës,pasi këto dy çështje janë të lidhura njëra me tjetrën

Me këtë Projektligj përcaktohen procedurat dhe mënyra e aplikimit për dhënien e dokumenteve të udhëtimit,llojet dhe vlefshmëria e dokumenteve të udhëtimit për shtetasit e Kosovës dhe gjobat për shtetasit që nuk ju përmbahen këtij ligji.

Kosovës i ka munguar legjislacioni i cili i referohet përgatitjes së dokumentacionit dhe pajisjes së qytetarëve me dokumentet e udhëtimit. Me këtë ligj eliminohen zbrastësirat ligjore që kanë të bëjnë me pajisjen e qytetarëve të Kosovës me dokumentet e udhëtimit. Qëllimi i Projektligjit është t,i përcaktoj rregullat lidhur me kërkesat e qytetarëve për tu pajisur me

dokumentet e udhëtimit, refuzimi për dhënjen e dokumenteve nga organi kompetent dhe vlefshmëria e tyre.

Projektligji ka tetë kapituj dhe katërdhjet nene.

Kapitulli i parë ka të bëjë me qëllimin, kuptimin, përkufizimet dhe detyrimin e shtetasve të Kosovës për bartjen e dokumenteve të udhëtimit me rastin e kalimit të kufirit dhe keq përdorimet.

Kapitulli i dytë ka të bëjë me llojet e dokumenteve të udhëtimit dhe kompetencat për lëshimin e tyre.

Kapitulli i tretë me vlefshmërinë e dokumenteve.

Kapitulli i katërt me procedurat për lëshimin e dokumenteve

Kapitulli i pestë me evidencat për llojet e dokumenteve, numrin e tyre, vlefshmërinë, dokumentet e humbura dhe të vjedhura dhe evidentimet tjera lidhur me

kërkesat për dokumentet e udhëtimit.

Kapitulli i gjashtë mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të këtij ligji nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Jashtme, secila nga fushe veprimtaria e vetë.

Kapitulli i shtatë dispozitat ndëshkues që përcaktojnë gjobën dhe lartësinë për shtetasit që nuk ju përmbahen këtij ligji.

Kapitulli i tetë bënë fjalë për dispozitat kaluese dhe përfundimtare.

Projektligji ka implikime buxhetore. Projektligji për Dokumentet e udhëtimit do të ketë një kosto financiare prej 10.462,00 milion euro.

Projektligji ka Deklaratën e Pajtueshmërisë të AIE-së (Agjencia për Integrim Evropian) dhe është në pajtim me legjislacionin e BE-së.

Nga arsyet e theksuara propozoj që Kuvendi i Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin për Dokumentet e udhëtimit. **Ju faleminderit**

KRYEDTARI KOLË BERISHA – Ftoj z. Gashi në emër të LDK-së

DEPUTETI ALUSH GASHI - Ju faleminderit z. kryetar, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështetë në parim Projektligjin për mbajtjen e të cilit në mënyrë shumë elokumente foli z. Ministër. Paraqitja e ish e strukturuar dhe përmbajtjesore, është një prej projektligjeve për të cilin dhe gjeneratat kanë punuar dhe ne kemi shumë arsye të mburrmi që do ta kalojmë në ligj se do të kemi dokumente të udhëtimit të niveleve të ndryshme, prej atyre të rëndomtë përmes dokumenteve dhe pasaportave zyrtarë diplomatike e tjera. Është një shenjë e pakontestueshme e mvetësimit të vendit tonë.

Ne e mbështesim këtë Projektligj i cili garanton që dokumenti i udhëtimit të jetë i një kualiteti të lartë të një sistemi të integruar i cili do të mundëson se qytetarët tanë të trajtohen me dinjitet gjatë udhëtimit.

Ne si grup mbështesim përpjekjet e Qeverisë dhe të presidentit që të kemi një dokument i cili do të ketë një afat si dokumentet tjera evropiane. Do të thotë që faza e zhvillimit tonë e mundëson që mos të angazhohemi për dokumente të përkohshme por të kemi një dokument të përhershëm të cilësisë më të lartë. Gjatë këtyre viteve në institucionet tona ne kemi ushtruar që mund të përdorim dokumente të cilësisë së lartë të cilët aktualisht quhen vetëm dokumente të udhëtimit, nuk janë pasaporta, por kanë të dhëna biometrike.

Mendojmë se me pasaportën e ri i cili do të jetë në nivelin më të lartë të teknologjisë do të mundësohen komunikime si në rrethin, po ashtu edhe më lartë. Fatmirësisht në Projektligj jepen edhe mundësi tjera të aranzhimeve, andaj me gjithë koston ne e mbështesim ministrinë që ta prodhojë dokumentin sa më parë dhe që të jetë sa më i mirë.

Z. kryetarë ne si grup përmes komisionit funksional që përket është Komisioni për Siguri, do ta japim kontributin tonë dhe presim që ky ligj të mos pres dy muaj ditë po ndoshta të na vie pas dy jave. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të PDK-së, Emin Krasniqi.

DEPUTETI EMIN KRASNIQI – Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së të Kosovës përshëndetje për kryetarin e Kuvendit z. Kolë Berisha, për ministrat e kabinetit të Qeverisë Çeku, kolegët deputetë, përfaqësuesit e organizmave ndërkombëtare të mediave.

Projektligji për dokumentet e udhëtimit përmban dhe përfaqëson aspektin ma emblematic të fushës së sigurisë për Kosovën, rajonin, dhe më gjerë. Është hartuar në përputhje me standardet e legjislacionit të bashkësisë Evropiane sipas modelit Slloven e i propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Grupi Parlamentar i PDK-së nëpërmjet përfaqësuesve të saj në komisionin për siguri që ka 3 anëtarë si dhe në mbledhjen e fundit të komisionit për siguri nga kryetari dhe përbërja e Kosovës dhe përbërja e komisionit për siguri të Kuvendit që do të bëjë paraqitjen edhe në emër të komisionit, ka shqyrtuar dhe analizuar projektligjin në fjalë i cili kurorëzon rrafshet reprezentative të interesave të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Me këtë rast komisioni për siguri i Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e fundit të datës 13.06. 2007 duke analizuar në mënyrë përmbajtjesore kuptimin, procedurat dhe mënyrat e aplikimit për dhënien e dokumenteve të udhëtimit lloj dhe vlefshmërinë e këtyre dokumenteve, përkitazi vërejtjeve dytësore që mund t'i bëhen në formulime gjuhësore dhe drejtshkrimore.

Në projektligjin për dokumentet e udhëtimit janë përfshirë të gjitha aspektet procedurale për të ndërtuar një infrastrukturë të plotë ligjore edhe në fushën e sigurisë. Përbërja e Komisionit për siguri nën drejtimin e z. Maloku fton deputetët e Kuvendit të Kosovës që të votojë në parim Projektligjin për dokumentet e udhëtimit duke premtuar se vërejtjet tuaja do të akceptohen edhe në shqyrtimin e dytë dhe të tretë të projektligjit gjatë amendamentimit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Naim Maloku në emër të AAK-së,.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari z. ministër të ndërruar deputetë. Para vete kemi një Projektligj shumë të rëndësishëm që rregullon procedurat dhe mënyrën e dhënies së dokumenteve të udhëtimit të pasaportave gjitha kategorive. Pra, është një projektligj i cili është i hartuar mirë dhe garanton kualitetin e pasaportave dhe dokumenteve të udhëtimit dhe mënyrën e dhënies së tyre.

Z. kryetarë, parafolësi foli në emër të Komisionit Parlamentar për Siguri, më lejoni që të njoftojë Kuvendin se në komision parlamentar për siguri në emër të listës serbe, pra të grupit parlamentar anëtarja e Komisionit Vesna Jovanović ka kërkuar që ky ligj t'i kthehet Qeverisë me arsyetimin se prejudikon statusin e Kosovës. Unë ftojë ministrin Kuçi, Qeverinë e Kosovës që t'i sjellin t'i procedojnë në Kuvend të gjitha ligjet që dalin edhe nga pakoja e Ahtisarit në mënyrë që Kosova të përgatitet për statusin e ardhshëm të saj. Ne nuk kemi arsye me u ndalë në punën tonë. Duhet të punojmë që t'i krijojmë infrastrukturën ligjore të nevojshme për shtetin e ardhshëm të Kosovës. Me gjitha votat tjera pro Komisioni sugjeron Kuvendit të Kosovës që ky Projektligj të shkon më tej të procedohet në shqyrtim Komision parlamentar dhe normalisht edhe të miratohet në leximin e dytë për shkak se edhe kualiteti i hartimit të këtij Projektligji me siguri nuk do të kërkon ndonjë kohë të gjatë në shqyrtim dhe ndonjë numër të madh të amendamenteve.

Lus kryetarin e Kuvendit që projektligjet dhe administratën e Kuvendit, projektligjet të cilat janë ndalë në procedurë, është Projektligji për Letërnjoftimin, pastaj Projektligji për numrin dhe emrin personal, për shkak të kërkesave të Komisionit Parlamentar për Komunitete që arsyetohen në projedukimin e statusit, pra të shkojnë më tej, ftoj edhe një herë Qeverinë, lus ministrin Kuçi që të gjitha Projektligjet që janë të kësaj fushe të hartohen sa më parë dhe të procedohen në Kuvend në mënyrë që të jemi të gatshëm për ditën e pavarësisë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të ORA, Ylber Hysa.

DEPUTETI YLBER HYSA – Kolegë të nderuar. Sot para vete kemi Projektligjin për dokumentet e udhëtimit i cili është një Projektligj shumë i rëndësishëm dhe shumë i shumëpritur nga qytetarët e Kosovës, më lejoni që të them që ai përmbushë një pjesë të madhe të standardeve të nevojshme edhe nga aspekti teknik edhe ato tjerat duke u bazuar në modelin sloven në mënyrë që të jetë më afër kriterijumeve evropiane që i duhet një dokumenti të udhëtimit.

Më lejoni vetëm që të tërheqë vëmendjen që ndoshta duhet përfillur edhe një mungesë e cila nuk është paraparë në sajimin teknik të dokumentit sipas informatave që unë posedoj, besoj që kategoria ku duhet specifikuar shtetësia në dokumentin e ardhshëm të udhëtimit mungon dhe kjo do të ishte kompatible me nenin 2 pikën g) ku përmendet shtetasi në mënyrë që konform këtij ligji të jetë edhe dizajni i pasaportës së ardhshme, konsideroj që është shumë me rëndësi që të theksohet edhe kjo pjesë e dokumentit të udhëtimit, dhe këtë e them jo vetëm për arsye teknike për faktin që ose praktike që janë një varg shtetesh të cilat e kërkojnë një kategori të tillë në mënyrë që të japin vizat brenda dokumentit të udhëtimit por edhe për arsye tjera të cilat përmbajnë më shumë se aspekte teknike ato funksionale dhe simbolike të një dokumenti çfarë e meriton Kosova që e ka pritur tash sa kohë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të LDD-së Ramadan Kelmendi, më falni Fadil Geci më falni.

DEPUTETI FADIL GECI – Ju faleminderit, i nderuar kryetar, ministra të nderuar deputetë.

Lidhja Demokratike Dardanisë është marrë me shumë seriozitet me ligjin e dokumenteve të udhëtimit. Ne mendojmë se ky ligj është një ligj shumë i rëndësishëm për Kosovën, ndoshta prej ligjeve më të rëndësishme që tregojnë identitetin e shtetit të Kosovës. Rëndësia e ligjit është në sigurinë e rregullimit ligjor dhe mbulon vakumin juridik në Kosovë në këtë lami dhe më gjerë. Edhe pse ky Projektligj mendohet se është një ligj i cili do të ketë një kosto mjaft të lartë por që është i domosdoshëm, unë mendoj se duhet të gjenden mjete dhe ligji të aplikohet sa më shpejtë dhe sipas standardeve.

Lidhja Demokratike e Dardanisë, vlerëson si ligj shumë të rëndësishëm dhe të mirë, LD duke parë fushën e veprimit, nevojat e ligjit, çështjet e vansuara të ligjit, përmbajtjen e ligjit, qëllimin e ligjit, rëndësinë e këtij ligji jep mbështetje të plotë në parim dhe mendon se më kalimin e këtij ligji nëpër komisione përkatëse do të përmirësohet edhe më tutje dhe do të dalë si një ligj shumë praktik për qytetarët e Kosovës.

Ne nuk e përkrahim eksperimentin në dokumentet e udhëtimit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit për Integrim Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. Edhe Grupi Parlamentar për Integrim ju bashkohet fjalëve të lëvdatës për Ministrinë e Punëve të Brendshme për përgatitjen e një dokumenti shumë kualitativ ligjor, e shprehim kënaqësinë tonë që jemi në gjendje në parim që ta përkrahim këtë projektligj dhe shpresojmë se ai së shpejti do të na vjen për miratim përfundimtar. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! në emër të grupit 6 + Hysnija Beshkoviq.

DEPUTETI HYSNIJA BESHKOVIQ - Parlamentarna Grupa 6+ je sa pažnom razmotrila N.Z. o putnim Ispravama i ocenujemo da je ovo još jednom u nizu Zakona neophodnih radi kompletiranja Zakonskog okvira Kosova.

Delokrug Nacrta .Zakona je da utvrdi Zakonska pravila u vezi: Značenja, sadržaja, procedure i načina podnošenja zahteva za izdavanje putnik isprava, vrste i važnosti putni isprava za građane Kosova.

Ovaj N.Z. ima veliki značaj zbog toga što Kosovo do sada nema odgovarajući zakon koje utvrđuje pripremu dokumentacije i obezbeđenje putnih isprava za građane Kosova.

Te predloženi Nacrta Zakona o putnim ispravama ima za cilj da reši sva pitanja koje se odnose na značenje, sadržaj, procedure i način podnošenja zahteva za izdavanje putnih isparav.Kao i vrste i važnost putnih isprava.

Kako je predviđeno U. Nacrta Zakona. o putnim ispravama, putne isprave su: Pasoš, Diplomatski pasoš, Službenih pasoš, putna karta, Dokument putrovanja za povratak, Grupni dokument, i putne isprave koje se izdaju na osnovu međunarodni ugovora.

Po članu 14 Nacrta Zakona putne isprave se izdaju u formi određene od strane MUP, u saradnji sa Ministarstvom za Inostrane Poslove koji isto tako određuju i cijenu putni isprava koje se plaću nadležnom autoritetu od strane korisnika dokumenta-građanina.

Svakako da je ovo jedan od bolih zakona sadržajnom i lingvističkih uređen koji je predstavljen ovoj Skupštini i u načelu je prihvatljiv, ali razmatrajući zakon utvrdili smo isvesne nedostatke, primera rade u članu 10 gde se govori o Diplomatski pasošu i kome se sve izdaje te pored Predsednika Kosova, Predsednika Skupštine Kosova, Zamenika Predsednika Skupštine Kosova u čitavu nizu nisu navedenih poslanici Skupštine Kosova u verziji prevoda koju ja imam.

A poslanici trebaju imati diplomatski pasos.

Član 15 Nacrt Zakona u svom sadržaju nedovoljno je jasan oko upotrebe službeno jezika na nivou Opštine tamo gde su službeni jezici Bosanski i Turski.

Te isti ovaj član treba dopuniti i precizirati.

Član 17 Nacrt Zakona predlaže da se Diplomatske pasoš izdaje na periodu 5 godina ali u našem predlogu vremenski period trajanja Diplomatskog pasoda treba harmonizovati sa zakonom o Pravima i Dužnostima Poslanika koje već izrađen i nalazi se u završne fazi.

Nacrt Zakona. o putnim ispravama po izjavi agencije Evropske Integracije ne krši neko od načela zakonodavstva Evropske Unije.

I u samom zaključku PG 6+ u načelu prihvata N.Z. i da ćemo svoj punih doprinos u daljem procesirivanju istog.

Hvala na pažnju

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Qibrije Hoxha

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA - Ju faleminderit z. kryetar. E mbështesë këtë Projektligj të rëndësishëm dhe të shumëpritur i cili rregullon me ligj pajisjen e shtetasve të Kosovës me dokument udhëtimi, dhe sigurisht ky ligj i gëzon gjithë qytetarët e Kosovës. Me këtë ligj qytetarët e Kosovës përfundimisht, qytetarëve pra po ju mundësohet e drejta elementare për lëvizje të lirë në mënyrë të dinjitetshme si u tha edhe më parë këtu. Megjithatë unë desha të ndalem në tri çështje rreth këtij Projektligji.

1. Së pari sa e pash unë në këtë Projektligj nuk ishte paraparë pagesa e pasaportës në rastin kur lëshohet pasaporta qytetarit, domethënë varësisht se prej natyrës së pasaportës, kjo është praktikë në vendet e Unionit Evropian,
2. Kam gjithashtu një vërejtje rreth kur organi kompetent ka të drejtën e marrjes së pasaportës prej qytetarit, këtu në këtë projektligj është e rregulluar kjo me nenin 27.3 por unë mendoj se përveç këtyre arsyeve që janë cek në nenin 27.3 ka edhe disa arsye tjera të cilat do të ishte mirë të përfshihen në këtë ligj në të ardhmen. Unë mundem me përmend, p.sh. humbja e nënshtetësisë pas lëshimit të

pasaportës, prindi i cili kujdesohet për fëmijun nën 18 vjeçar mundet të kërkojë marrjen e pasaportës, pastaj sidomos në qoftë se pronari i pasaportës gjendet në shërim psikik me trajtim të veçantë, gjithashtu edhe në këto raste merret pasaporta por marrja e pasaportave dmth. mund të bëhet edhe marrja e pasaportave që nuk janë pasaporta të përgjithshme qytetare por këto pasaporta të veçanta. P.sh. në qoftë se një diplomat i kalon koha e shërbimit të tij atëherë duhet të ceket se i merret pasaporta edhe sidomos mund të ekzistojë edhe marrja e përkohshme e pasaportave që mund të jetë deri në një afat prej 6 muajsh. Ekzistojnë edhe shumë arsye tjera të cilat ndoshta do të ishte mirë të inkorporohen këto.

3. Unë konsideroj se në të ardhmen domethënë për këtë fazë në cilën po kalon Kosova sigurisht se ky ligj është mjaft i mirë, por unë konsideroj se në një të ardhme të afërt Kosova duhet të ketë një ligj bazik vetëm për pasaportën kurse për me aktet tjera nënligjore do të duhej ndoshta të rregullohet pasaporta diplomatike, pasaporta zyrtare, fletudhëtimet dhe dokumentet e udhëtimit grupor e tjera e tjera, ndoshta edhe lloje të tjera të pasaportave. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Agim Krasniqi e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Nuran Malta.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra të nderuar deputetë. Unë më herët që të flas në emër të grupit parlamentar, kryetari i grupit parlamentar veç e manifestojë dhe e shprehu përkrahjen që ka grupi parlamentar i LDK-së për aprovimin në parim të këtij projektligji. Unë po e shfrytëzoj rastin që ti shprehu disa në të vërtetë ti them disa prej vërejtjeve që nuk janë aq esenciale por janë vërejtje që megjithatë duhet të inkorporohen në procedurën e mëtutjeshme të përpunimit të ligjit.

Ky ligj është thënë qysh në fillim se është hartuar shumë mirë, është një ligj komplet, një ligj që po thuaj se gjitha ato esencialet që duhet t'i ketë ky ligj i ka, por megjithatë ka vend edhe për disa plotësime dhe ndryshime.

1. Në dispozitën ligjore që përcakton përkufizimet e nocioneve të përdorura në këtë projektligj janë mirë të radhitura llojet e këtyre dokumenteve të udhëtimit tu filluar nga pasaporta, pasaporta e diplomatike, zyrtare, pastaj fletudhëtimi që është dokument i udhëtimit për kthim, edhe dokumenti i udhëtimit pastaj edhe dokumenti që arrihet përmes marrëveshjes me ndërkombëtarët. Mirëpo në brendinë e Projektligjit nuk respektohen këto përkufizime kështu që ndodhë që pasaporta që e ka emrin e vet mjaft domethënë për krah këtij emri këtij nocioni përdoret edhe pasaporta e vlefshme e udhëtimit. Mendoj që këtu nuk ka nevojë të përdoret por vetëm pasaporta mjafton të përdoret si nocion.

Pastaj nocioni tjetër fletudhëtimi që nënkupton sipas sqarimeve në preambulën e Projektligjit nënkupton dokumentin e udhëtimit për kthim të qytetarëve. Normalisht që duhet të përdoret si fletudhëtim dhe pastaj të bëhen sqarime tjera edhe në mënyrë se si implementohet kjo ligjor.

Tjetër, në një dispozitë tjetër ligjore thuhet se qytetarët e Kosovës mund të kthehen në shtetin e vet, në vendin e vet edhe me dokumente që nuk janë të vlefshme, kanë mangësi, kanë vërejtje, apo i ka skaduar afati dhe thotë mund të hyjnë, mund ti lëshohet edhe një dokument që mund të hyjnë në territorin e Kosovës por mos të vie në dyshim shtetësia dhe identiteti i tyre. Këtu ligji nuk e përcakton se në cilat dokumente me çfarë dëshmisë mund të argumentohet përkatësisë, gjegjësisht shtetësia e atij qytetari i atij personi edhe identiteti i tij, ndoshta do të duhej kërkuar dokumenti që mund ta dëshmon këtë.

Tjetër, gjithashtu rreth emërtimeve, disa vende përdoret si edhe ma herët në disa projektligje të mëparshme ministria kompetente e punëve të brendshme apo ministria kompetente e punëve të jashtme. Ne kemi ministrinë e punëve të brendshme dhe ai nuk është ministri që do të duhej në emërtimin e vet edhe një fjalë tjetër në emërtimin e saj në mes të përdoret si kompetente. E njëjta gjë vlen edhe për ministrinë që do të formohet sigurisht shpejtë, Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Kam vërejtje tjetër edhe në atë se nuk është përcaktuar saktë dhe qartë se kujt ti lëshohet dokumenti i udhëtimit gjegjësisht pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare.

Gjithashtu kam vërejtje në gjobat që janë paraparë me para për ata që i cenojnë ligjin dhe që falsifikojnë keqpërdorin e tjera, mendoj që gjobat prej 50 deri në 1000 euro nuk mjaftojnë sepse këtu nuk ka vetëm kundërvajtje po këtu mund të ketë edhe vepër penale, nëse keqpërdoret dokumenti në fjalë, kështu që mendoj që duhet të ketë masa ndëshkuese edhe të tjera përveç gjobës në para. Dhe krejtësisht në fund mendoj që komisioni funksional komisioni parlamentare për siguri dhe deputetët e LDK-së pra edhe këtij komisioni edhe deputetët e tjerë do të bëjnë atë që është e nevojshme që të bëhet që ky ligj të plotësohet, ndryshohet, kompletohet dhe të përgatitet për aprovim, unë e mbështes në parim aprovimin e parim të këtij projektligji.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Nuran Malta le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETJA NURAN MALTA – Sayin Bakanlar, Sayin Baskan degerli Milletvekileri Tartistigimiz Yolculuk Dokumanlari yasa tasarisinin , Kosova hukumeti ve vatandaslari icin onemli oldugu tartisilmazdir.

Onemli olmasinin tartismasiz en onemli sebebi bu dokumanlarin ve bunlarla ilgili yasaninin eksikligidir.

Yasayla ilgili olarak uyari ve onerilerimizi 6 + olarak az once arkadisimiz illeti. Ancak Kosova Demokratik Turk Partisi olarak 15 maddeye onerimizi , daha dogrusu uyarimizi bir daha tekrarlamak istiyorum.

Yasanin 15 maddesine gore; Yolculuk dokumanlarinin diller yasasina gore verilecegi ifade edilmektedir.

Avrupa bolgesel diller kartina gore her topluluk kendi dilinde istedigi dokuman ve pasaporttu alabililecegi gorulmektedir. Buna gore bizim bu maddeye onerimiz; belediyelerde bu gibi dokumanlarin verilecegi icin bu paragrafa “ belediyelerdeki kullaniman resmi diller” ekinin katilmasini onermekteyiz. Ayrica dokumanlarla ilgili verilen formlarin ve dilekcelerin bu kuralla uymasi gerekmektedir.

Butun bunlari goz onunde bulundurarak KDTP’ I olarak onergelerimizi {amandament} yasanin proseduru sirasinda verecegiz soz vernek istoyoruz.

Dikkatinize tesekkur ederim

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! le të përgatitet Fetah Berisha më pas vjen në radhë deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETI FETAH BERISHA – I nderuari z. kryesues, i nderuar z. ministër. Kemi para vete Projektligjin për dokumentet e udhëtimit përpiluar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës e të cilin po e shqyrtojmë sot në këtë seancë. Ky Projektligj është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Kosovës jo vetëm që eviton zbrastësirën ligjore nga se Kosovës i mungon ky ligj por me këtë ligj rregullohet juridikisht pajisja e shtetasve të Kosovës me dokumentet e udhëtimit, po ashtu rëndësi shumë të veçantë ka ky projektligj edhe për mërgatën tonë të mrekullueshme e cila në të gjitha kohërat ishte shtyllë kryesore e ndihmës së Kosovës prej asaj politike dhe asaj materiale, prandaj këtu lutet Ministria e Punëve të Brendshme që të përshpejtësojë nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit edhe të kenë përparësi qytetarët tanë tani e tutje do të vijnë në pushim në vendin tonë. Projektligji për dokumentet e udhëtimit është edhe një dëshmi reale për ministrinë e punëve të brendshme e cila dhe pse ska shumë kohë që është themeluar po dëshmon sukseset e mbara pos tjerash edhe në lëmin e licitacionit.

Në nëntë kapitujt e vet sa ka ky Projektligj ngërthen në vete edhe qëllimin e fushëveprimit edhe nevojat e procedurës për dokumentet e udhëtimit pra në përmbajtjen e kapitujve janë përfshirë llojet e dokumenteve të udhëtimit afati i vlefshmërisë procedurat e lëshimit, obligimet e shtetasit, evidencat e dokumentit të udhëtimit mbikëqyrja e të tjerë.

Ky Projektligj sa do që është i përafërt me ligjet e tjera si është ligji për dokumentet personale, ligji për numrin personal e të tjerë, prapë se prapë i ka specifikat e veta të veçanta sipas fushëveprimit të vet.

Edhe për hartimin e këtij Projektligji është thënë se si model janë marrë përvojat e të tjerëve, gjë që është mirë, por në veçanti është marrë përvoja sllovene, e kjo është edhe një dëshmi tjetër se Kosova duke ecur drejtë pavarësisë po përpilon ligje të cilat edhe nga forma edhe nga përmbajtja ajo i plotëson kushtet e standardeve ndërkombëtare. Andaj si i tillë edhe ky Projektligj nuk krijon zbrastësirë në legjislativin në këtë fushën. Me gjithë atë ky projektligj nuk është i tërë i përsosur, prandaj ka nevojë për ndërhyrje të vogla, kështu në tërë Projektligjin vetëm në nenin 36 është përmendur një udhëzim administrativ, e udhëzimet administrative do të ndihmonin që ta lehtësojnë zbatimin e projektligjit sepse sqaron kuptueshmërinë dhe specifikat e këtij projektligji, po ashtu edhe kriteret për procedurën e dhënies dhe marrjes së pasaportave diplomatike duhet të qartësohet pak më mirë, megjithatë Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë një Projektligj të nivelit të mirë me vlerë të dukshme standarde, prandaj meriton të votohet në parim në këtë Kuvend. Ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni Kaloshi .

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari z. kryesues, po më vjen shumë mirë që për herë të parë po e marr fjalën nga ju, ju po e kryesoni këtë seancë parlamentare, kjo tregon tërë madhësinë, përgjerësinë e popullit të Kosovës për trajtimin e barabartë të gjithë qytetarëve të saj. Tash po i kthehem ligjit i cili është objekt debati në këtë seancë plenare, vërtetë për rëndësinë e ligjit, formën e tjera unë nuk kam çka të them shumë, kam disa vërejtje të vogla të cilat nuk e zvogëlojnë rëndësinë e ligjit, por vetëm sa do ta begatojnë dhe ta bëjnë ma kualitativ.

Fjalën e kam për kapitullin VII, dispozitat ndëshkuese ose neni 34, ky nen përmban përshkrimin e abuzimit të dokumentit të udhëtimit i cili për shkrim ka po thuaj të gjitha elementet e veprës penale, prandaj sikurse që thash edhe për ligjin e mëparshëm për narkotikët ndoshta me këtë nen duhet t'i referohemi kur janë në pyetje këto abuzime duhet t'i referohemi sanksioneve penale që janë të parapara me kodin penal. Këtë e tha edhe kolegu im i nderuar Agim Krasniqi./

Kur jemi te neni 15 i ligjit i cili parasheh se në cilat gjuhë duhet të lëshohet dokumenti udhëtimit unë mendoj se edhe kjo çështje është rregulluar mirë sepse dokumenti i udhëtimit është një dokument i cili rregullohet në nivel qendror dhe i cili parasheh pikërisht përdorimin e atyre gjuhëve të cilat edhe me pakon e z. Ahtisari janë të parapara si gjuhë zyrtare, por edhe me kornizën e tashme të përkohshme janë të parapara si gjuhë zyrtare të Kosovës, ndërkaq që nuk e mohoj të drejtën e përdorimit të gjuhëve të tjera në nivel lokal por edhe në nivel qendror por ato janë vetëm përdorim, kurse gjuhë zyrtare dihet cilat janë gjuhë zyrtare.

Sa i përket nenit 27 marrja e pasaportave, mendoj se ky nen duhet të reduktohen rastet kur duhet të merren pasaportat, sikur p.sh. kur është fjala për dënimet dy herë për një vepër të caktuar penale sepse nëse ne pas mbajtjes së dënimit të atij individi i cili është dënuar dy herë ose më shumë herë për një vepër penale si recidivist atij nuk mund t'ia marrim dokumentin e udhëtimit sepse në atë mënyrë ne po ia cenojmë të drejtën e lëvizjes së lirë. Ai për atë vepër që e ka bërë e ka paguar me mbajtjen e dënimit dhe nuk mund ta dënojmë dy herë për të njëjtën. jepen në vepër. Prandaj në ato raste nuk duhet t'i mohohet e drejta e qarkullimit të lirë, nëse finet prapë atij do t'i merret pasaporta derisa të mbajë dënimin për të cilin është dënuar.

Mendoj se do të kishte vend të plotësohet vend të plotësohet ky ligj edhe me ndonjë nen i cili do të rregullonte simbolin që duhet ta ketë dokumenti i udhëtimit. Ne tani nuk e kemi simbolin e rregulluar, mirëpo duhet t'i referohemi se dokumenti i udhëtimit do ta ketë simbolin i cili do të përcaktohet me Ligjin për simbole, sepse disi, unë nuk më ka rastisë të shohë ndonjë dokument të udhëtimit pa një simbol të vetin. Dhe krejt në fund, është mirë e rregulluar që pasaportat e dhëna nga UNMIK-u do të mbesin në fuqi derisa të mos nxirret një vendim i ri nga ndonjë organ ndërkombëtar ose kombëtar, sepse, dihet se me zgjidhjen e statusit të Kosovës, kjo Korniza Kushtetuese dhe misioni i UNMIK-ut në Kosovë merr fund, natyrisht në periudhën që i është lënë, ajo periudha e tranzicionit. Dhe krejt në fund, neni 39 më duket i tepërt, sepse thotë: ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm me të cilat është në pajtueshmëri. Ne të vetmin dokument apo ligj, por në nivel të Rregullores së UNMIK-ut që e rregullon çështjen e dokumenteve të udhëtimit e kemi Rregulloren e UNMIK-ut, dhe natyrisht, se me nxjerrjen e këtij Ligji do të pushoj së zbatuari ajo Rregullore. Ligje të tjera nuk kemi. Ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI - Ju faleminderit! Në radhë është deputeti Hydajet Hyseni Kaloshi, ndërsa le të përgatitet deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. Kryesues. Nuk mund mos të mbështesë idenë e nismën për të pas një ligj të tillë dhe nuk mund e mos ta lavdëroj edhe tekstin e ligjit. Është një ligj i punuar mirë, por s'mund edhe mos të jem i singertë këtu, edhe them më duket një ligj aq i mirë, sa nuk di sa është funksional. Ne jemi organ ligjdhënës, prandaj mendoj që pos vullnetit të mirë duhet edhe të shohim sa i kemi krijuar të gjitha parakushtet për të proceduar dhe për t'i implementuar ligjet si ky. Nuk do shumë mend se ky është një nevojë e madhe, shumë e rëndësishme, e pashlyeshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, veçanërisht për mërgimtarët. Ata edhe mund të mos jenë të mrekullueshëm siç tha parafolësi, por kanë probleme shumë serioze. Sot mua më kanë ardhur, në postën time kërkesat e qytetarëve për t'u dal në ndihmë në problemet konkrete që i kanë. Edhe me këto dokumente të udhëtimit që i kanë. Ata duhet të kalojnë sa e sa probleme me viza që herë jepen e herë nuk jepen dhe e bëjnë të pamundur ushtrimin, realizimin e të drejtave elementare të tyre edhe për të pushuar në vendlindje. E them këtë edhe si një kërkesë Qeverisë që të bëjë përpjekje edhe me kontaktet me vendet fqinje për t'i lehtësuar problemet e tyre dhe veçanërisht me përforcimin e shërbimeve në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe në organet tjera komunale për të lehtësuar dhënien e dokumenteve të udhëtimit.

Megjithatë ky Projektligj kërkon tamam pasaporta, nuk ka gjë më të mirë, nuk ka gjë më të rëndësishme, por shtrohet puna vërtetë a jemi përgatitur për këtë zotëri. Ne po flasim në këtë ligj për shtetësinë a e kemi zotëri?

Flasim për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe themi ky ligj duhet të hyj në fuqi menjëherë pas miratimit të Kuvendit, është i vetmi Ligj që e kërkon këtë, dhe çka? Tre muaj më vonë Ministria e Rendit duhet të bëjë në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme një Udhëzim administrativ dhe të bëjë aplikacione, formulë e tjera, po a i kemi këto zotëri? Nuk është puna vetëm për të shprehur vullnetin e mirë, e theksoj këtë për të ardhur në dy përfundime, nëse nuk i kemi le të mobilizohemi zonja dhe zotërinj, dhe le t'i bëjmë, nuk i bënë tjetër kush, ne duhet t'i bëjmë dhe atëherë kemi të drejtë të flasim, por nuk mund të hiqemi sikur nuk e dimë dhe pastaj hajt te luajmë lojën se jemi diçka që nuk jemi dhe kemi diçka që nuk kemi ende, duhet ta kemi dhe duhet ta bëjë, por hajde ta bëjmë, dhe jo tash të krijojmë iluzione dhe të mbjellim iluzione edhe në qytetarët. Mjaftë me këto lojëra. Unë prandaj angazhohem që këtë proces ta shikojmë seriozisht, te respektojmë dhe ta shikojmë në kontestin politik dhe institucional në të cilin ndodhemi. A duhet të jemi vazhdimisht në këtë institucion është tjetër çështje, por ne ndodhemi zotëri, duhet ta ndërrojmë këtë, dhe deri atëherë le të synojnë që t'i harmonizojmë qëndrimet me praninë ndërkombëtare në Kosovë edhe me Zyrën ligjore të UNMIK-ut dhe t'i tejkalojmë pengesat.

Për mendimin tim, i tejkalojmë pengesat edhe duke evituar formulat që janë të drejta, shumë të dëshirueshme, shumë të pëlqyeshme, por janë ende pak herët, dhe Sami Frashri thoshte: “Nuk ka gjë më e mirë se ajo që është e drejtë, por e thënë kur s'është koha për të”

Unë, prandaj edhe do të sugjeroja që të rishikohen përveç tjerash formulat që mund të jenë Kazuzbeli. Neve nuk na duhen ligje që janë të bllokuara dhe presin pastaj me muaj dhe me vite në arkivat e Zyrës ligjore të UNMIK-ut, të rishikohen ato që u thanë dispozitat për sanksionet se vërtetë janë qesharake. Të rishikohen dispozitat

përfundimtare se nuk mund të hyjnë në fuqi me ta miratuar Kuvendi. Jam i bindur se në këtë mënyrë ne do ta lehtësonim, do ta përgatisnim për miratim dhe zbatim këtë ligj. Nuk kanë qytetarët e Kosovës nevojë për fjalë të mëdha për pasaportën e për shtetësinë e për Ministrinë e Jashtme, por kanë nevojë që ato t'i kemi, t'i bëjmë dhe t'i gëzojmë pastaj. Angazhohem për një qasje të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! Para se ta marrë fjalën deputeti Nazim Jashari, do ta kisha bërë një lutje të gjithë deputetëve që të kthehen në sallë, sepse Nazim Jashari është diskutuesi i fundit.
Urdhëroni z. Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit kryesues. I nderuar ministër, ministra, kolegë deputetë

Që të gjithë parafolësit e mi në një mënyrë apo në tjetër e shprehën miratimin për këtë Projektligj, sepse është një ligj i cili na duhet, mendoj etapa në të cilën po pritet të hymë tash a pak më vonë, do të mbetet të shihet, sigurisht se e kërkon këtë ligj dhe rregullimin e kësaj materie që është paraparë të rregullohet me këtë ligj.

Do të ndalem në disa aspekte lidhur me këtë draft që e kemi para vetit. Si anëtar i Komisionit për Buxhet, më së pari kam shikuar deklaratën financiare dhe është një deklaratë bukur kështu e stërholluar, mirëpo i ka disa gabime, brenda disa kontradikta të cilat i kam ndërmend t'i theksoj, dhe kontradiktat fillojnë prej pjesës së parë të deklaratës ku i analizon aspektet e përgjithshme nga ky Projektligj dhe thotë se zotërinjtë nga Departamenti i Buxhetit të Kosovës e marrin të drejtën të konstatojnë që dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga UNMIK-u, mund të përdoren një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Nuk e di ku e kanë marrë këtë konstatim, ose nga ku ju vjen ky konstatim dhe nga ku ju vjen e drejta për të konstatuar se sa kohë pas hyrjes në fuqi të këtij Projektligji do të ketë zbatim akoma dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga UNMIK-u, sepse, mendoj se më së paku ju takon këtyre në buxhet ta japin një konstatim të tillë, ato dokumente janë dokumente për të cilat validitetin e të cilave mundet me e definuar UNMIK-u, edhe se ata të cilët e kanë miratuar e jo kursesi ky far Departamenti.

Ajo që është dashur ta analizojnë më me saktësi, sigurisht ka qenë ndikimet buxhetore në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës, u është pjesa dy, dhe ku bëhet një analizë e kostos. Kjo analizë e kostos, ndër të tjera parasheh edhe pagat për staf shtesë prej 22 mijë eurosh, z. Ministër ia tërhiqni vërejtjen atyre dhe që ka të bëjë me 100 të punësuar 100 x 220 që bëjnë 22 mijë.

Te pjesa e katërt ku e marrin dhe e analizojnë tash pjesën e dytë, thotë që janë 80 punëtorë, që parashihen shtese e të cilët do ta kenë pagën vjetore prej 211.200 euro, pra 80 x 220 x 12 muaj e që e arrin koston më shumë se 22 mijë. Në 80 punëtorë e bëjnë koston shumë më shumë se sa 100 punëtor siç është në pjesën dy, aty ku është dhënë në mënyrë të përmbledhur shuma e kostos financiare të këtij Projektligji, prandaj janë disa gabime matematikore, të matematikës elementare që mësohet deri në klasë të dytë, e që këta zotërinj e Departamentit të buxhetit siç duken e paskan huq fare.

Do të lëshohem tash në përmbajtjen e ligjit dhe aty do të ndalem te neni 23, i cili ka të bëjë me procedurën për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit. Neni 23 e parasheh që kërkesa për lëshimin e pasaportës bëhet në formularin e caktuar, po e konsiderojmë se këtë formularë do ta definon Ministria, edhe në 23.2 i përmban të gjitha ato elemente të cilat duhet t'i përmbajë formulari, pra emrin personal, numrin personal, datën e

lindjes, gjininë e të tjera, ndërkohë që nuk sheh fotografinë, pra nuk parasheh së këtij formulari duhet t'i bashkëngjiten dy fotografi, siç parasheh për shembull te pika 23.2 e që ka të bëjmë me aspektet tjera, me dokumentet e tjera udhëtimi por jo me pasaportën. Mendoj se, në Projektligj duhet patjetër të thuhet që, aplikuesi duhet t'i bashkëngjis dy fotografi ose edhe të detyrohet, të detyrohet që fotografinë ta bie në formë elektronike që ka mundësi teknikisht, nuk është problem, sepse të nderuar kolegë deputetë fotografimi i ynë për letërnjoftime që i kemi tash aktualisht ngjanë në fotografitë e të burgosurve, dhe kursesi nuk duhet t'u lejohet zyrtarëve të drejtorive të ndryshme të na fotografojnë atje sikur të jem të burgosur, por duhet ne ta zgjedhim vet fotografimin ku dëshirojmë të fotografohemi edhe ta qojmë fotografinë ashtu siç dëshirojmë vet të dukemi, sepse ajo është aspekt edhe artistik. Ne dhjetë vjet kemi me e bajt atë dokument e jo me na fotografuar atje një zyrtar kushto qoftë ai, i cili ka talent apo nuk ka talent kurrfarë. Besoj se të gjithë ju jeni të pakënaqur me pamjet e juaja nga fotografitë e letërnjoftimit që i keni. Po ju shohë që po qeshni, besoj se po dakordoheni. Prandaj, ju kisha lutur që ta keni parasysh që, në dokumentet e udhëtimit që do ti mbajmë 10 vjet me veti, ta kemi fotografinë ashtu siç kemi qef të jemi, e jo siç ka qef dikush atje të na qetë atje në Ministrinë e Brendshme.

Do të ndalem po ashtu edhe te një aspekt që e trajtoj pak më parë kolegja Nekibe është neni 27. 1 (c). Mendoj se ky nen është shumë restriktiv. Zoti ministër nuk e di ku e keni marrë këtë model, veç ky model në vendet demokratike nuk është marrë. Madje, madje dyshoj që është marrë edhe në vende me një shtetësi të konsoliduar afatgjatë edhe që mund të jenë demokrat, se thuhet që nëse nuk i merret, nuk i jepet pasaporta ose edhe i merret pasaporta njeriut, në qoftë se i është shqiptuar së paku dy herë dënimi me burg për këtë vepër penale, për këtë vepër penale, është kufizim elementar i lirisë dhe të drejtave të njeriut e cila është një konventë gjerësisht e pranime, e cila është e sanksionume nëpër dokumente ndërkombëtare, prandaj mendoj se kjo dispozitë duhet të fshihet, të reduktohet në maksimum ose të saktësohet në maksimum ose të saktësohet në maksimum se cilat raste mund t'i kufizohet e drejta për të pasur dokument udhëtimi, në të cilat mundet që shtetasit t'i kufizohet e drejta për lëvizje të lirë, edhe pse ju këtë nocionin shtetas nuk e keni paraparë fare në këtë dokument të udhëtimit që u bë vërejtje nga kolegu im Hysa, dhe që mendoj se duhet po ashtu të jetë e saktësuar në këtë Projektligj pra.

Pavarësisht sa njerëz e kanë, e tha edhe kolegja Nekibe, e cila është edhe avokate me profesion, që sigurisht shumë më mirë se unë i mbulon këto aspekte, por një njeri që është dënuar, nuk mund të dënohet përsëri. Unë nuk di, nuk jam jurist, mirëpo në aspektin e funksionimit të të drejtave elementare njerëzore tash t'i ndalohet e drejta për pasaportë dikujt që ka bërë kalim të kundërligjshëm në kufirin shtetëror dy here, mendoj se është absurd kjo, është absurd sepse nuk e ka logjikën elementare të funksionimit të sistemeve demokratike. Ai duhet të sanksionohet, duhet të ndëshkohet, por jo t'i ndalohet e drejta për të pasur dokument udhëtimi, aty është aspekti. Një aspekt tjetër që, po ashtu duhet të dal z. Ministër është te dispozita ndëshkuese.

Të nderuar deputetë, ne derisa e kemi pasur Ligjin për letërnjoftimin, i kemi këtu disa amendamente të Ligjit për letërnjoftimin, të cilat janë miratuar në Komisionin për siguri të Kuvendit tonë, ku është kryetar z. Maloku, dhe një prej amendamenteve në nenin 21, Ligji për letërnjoftimin thotë se me gjobë prej 200 euro ose me burgim prej 30 ditësh, dënohet për kundërvajtje shtetasi që nuk ka letërnjoftim valim. Ju në, na atë e kemi kaluar si dispozitë, nuk e kemi të nënshkruar. Në këtë projektligj ju nuk e keni e keni paraparë asnjë kundërvajtje me burg për ata të cilët, në një mënyrë apo në një tjetër e

bëjnë kalimin ilegal të kufirit ose përdorin dokument të rrejshëm, të huajin për me e kaluar kufirin. Pra, dispozitat të cilat mendoj se duhet patjetër të caktohen me këtë Projektligj sa i përket aspektit të kundërvajtjes, sa i përket asaj që tha kolegja Nekibe të aspektit penal, ato sigurisht që duhet po ashtu të parashihet, që ato shkelje që paraqesin shkelje penale duhet të jenë të mbuluar me kodin penal të Kosovës, mirëpo kundërvajtjet duhet gjithsesi të parashihen edhe aspekte, duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit që e rregullon lëvizjen e qytetarëve. Duhet patjetër në këtë projektligj ta kemi edhe aspektin e ndëshkimit me burg për ata të cilët, këtë e kemi tek e fundit edhe obligim, sepse ne e marrim zotime këtu që do ta bëjmë një, do ta vendosim një rend në mënyrën e funksionimit të qytetarëve tonë edhe te aspekti i kalimit të kufirit edhe te aspekti i mënyrës se si ata do ta respektojnë këtë dokument edhe obligimet që dalin nga ky ligj. Mendoj se, edhe një aspekt tjetër që është te dispozitat ndëshkimore e që nuk është paraparë që duhet të parashihet, është që duhet të saktësohet saktë edhe ndëshkimi për zyrtarët të cilët janë të punësuar në këtë sektor të dhënies së dokumenteve dhe të cilat nuk i përmbushin detyrimet të cilat ligji ua parasheh. Në qoftë se një zyrtar e ka të obliguar që brenda 60 ditësh ta kthejë përgjigjen qytetarit lidhur me kërkesën të cilën qytetar ia ka parashtruar dhe ai zyrtar nuk e bënë një, nuk e përmbushë një kërkesë të tillë të Ligjit, ai duhet të sanksionohet, duhet saktë të parashihet sanksionimi i tij, sepse nuk mund të sanksionohet vetëm qytetari, por duhet të sanksionohet edhe zyrtari i cili nuk e kryen detyrën e vet. Më falni pak për zgjatjen, por mendoj se tema që e trajtojmë është një temë shumë serioze edhe shpresoj shumë që këto vërejtje, të cilat u bënë nga shumica e parafolësve të mijë, por edhe këto të mijat do të merren parasysh me rastin e amendamentmit të Ligjit. Ju faleminderit shumë për vëmendje.

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit!. Në sallë kemi 63 deputetë, dhe kërkojmë nga ju të nderuar kolegë deputetë që të deklaroheni për miratimin në parim të këtij Projektligji.

Lusim regjini të përgatitemi për votim. Votojmë tash! Konstatojmë se me 63 vota PËR dhe një KUNDËR – Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për dokumentet e udhëtimit. Po 64. Pas miratimit në parim në bazë të rregullave 23 dhe 35 Kuvendi ka kërkon këto komisione:

- Komisioni për Siguri si Komision FunkSIONAL dhe Raportues,
- Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

Komisioni duhet që në afatin jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë, ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Vazhdojmë pra të nderuar kolegë deputetë me pikën e gjashtë të rendit të ditës

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale.

Konstatime hyrëse: Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 25 maj 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim, në përparimin e tij.

Ftoj Ministrin Ibrahim Selmanaj, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantoj Projektligjin.

Urdhëroni z. Ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Ju faleminderit z. Kryesues, të nderuar deputetë. Para jush kemi sjell Projektligjin për ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Fushëveprimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, është ofrimi dhe sigurimi i mbrojtjes sociale për familjet kosovare të cilat përmbushin kushtet dhe kriteret e mirëfillta ligjore.

Ligji nr. 2003/15 për Skemën e ndihmës sociale në Kosovë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 11. korrik 2003, ndërsa është i fuqizuar me Rregulloren 2003/28 të nënshkruar me 18 gusht të vitit 2003 nga Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nga fuqizimi i këtij ligji, mekanizmat kompetentë për mbikëqyrje dhe kontratë të zbatimit të tij, në vazhdimësi kanë vlerësuar se ekzistojnë pengesat të ndryshme për zbatimin e drejtë dhe efikas të Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Këto pengesa dhe vështirësi në zbatim të drejtë të këtij Ligji kanë qenë dhe janë rezultat i disa dispozitave kontradiktore të pazbatueshme, të paqarta, konfuze dhe jo funksionale, e gjithë kjo ka ndikuar që mos efikasitetin dhe jo funksionalitetin e duhur në ushtrimin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të punëve, si dhe kanë mundësuar interpretimin e ndryshëm të dispozitave ligjore. Përveç vështirësive të zbatimit të dispozitave të këtij ligji, Departamenti i Mirëqenies Sociale i ka informuar shumë herë stafin politik të Ministrisë të Punës dhe të Mirëqenies Sociale në mënyrë që të arrihet deri te ndryshimi eventual i dispozitave ligjore me qëllim që ligji në fjalë të jetë funksional. Për shkak pengesave dhe vështirësive të përmendura në zbatimin e drejtë të Ligjit, si dhe duke pasur parasysh kërkesat e ndryshme të qendrave për punë sociale për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, Departamenti i Mirëqenies Sociale ka marrë iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e ndihmës sociale.

Pas analizave të bëra nga niveli politik dhe ai administrativ, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, qendrave për punë sociale që janë implementues të ligjit në fjalë, lidhur me nismën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, njëzëri u vlerësuar se duhet të bëhet amendamentimi i ligjit të përmendur. Konstatimi i përgjithshëm nga ky vlerësim ishte se ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit do të kenë efekt të drejtpërdrejtë në veprimet dhe efikasitetin e punës së qendrave për punë sociale, sepse me këto ndryshime dhe plotësime do të evitohen shumë paqartësi rreth interpretimit të dispozitave ligjore të Ligjit për Skemën e ndihmës sociale.

Unë ftoj deputetët që ta votojnë në parim këtë ligj. Ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! Ministër. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, është paraqitur deputetja Nafije Berisha. Urdhëroni, e keni fjalën

DEPTETJA NAFIJE BERISHA – I nderuari kryesues, të nderuar ministra, kolegë të nderuar

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale, në mënyrë që ky projektligj të jetë më i qartë dhe me lehtësi të zbatueshëm. Këtë kërkesë deputetët e Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike e kanë bërë edhe disa herë në Komisionin profesional dhe në biseda të ndryshme me vetë ministrin. Shumë dispozita të tij janë të paqarta dhe ju mundësojnë punëtorëve administrativ të qendrave për punë sociale, që në shumë raste të vendosin për ndihmën

sociale konform vullnetit dhe disponimit të tyre. Në Kosovë sot janë mbi 40.000 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale shifër kjo në shikim të parë mund të duket shumë e lartë, por ka edhe shumë familje të tjera të cilat shkak i paqartësisë së këtij Projektligji kanë mbetur pa përkujdesje sociale dhe të nevojshme të tyre. Megjithatë, z. Ministër ju keni qasur rregullimit të Ligjit në mënyrë që për ndihmë sociale të përzgjidhet familja që ka nevojë, por ashpërsimi i kriterëve siç e keni quajtur ju në memorandum shpjegues, do të thotë rrethanat dhe koha në të cilat është aprovuar ky Projektligj në të vërtetë kanë qenë të tjera, por nuk e keni dhënë sqarimin edhe analizën e rrethanave të tanishme sociale, pse ju kërkon ashpërsim të kriterëve në vend të përfshirjes më të madhe të familjeve që nuk janë të përfshira në ndihmën sociale. Sikur këto rrethana të ishin të tjera, siç jeni shprehur ju e do të thoni si zhvillim ekonomik, vende të raja të punës, ngritje të të ardhurve personale të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e mirëqenies sociale të popullatës do të ishte edhe normale të bëheshin amendamente të cilat i keni propozuar ju në këtë Projektligj.

Për shembull, një familje 7 anëtarësh e cila, sipas propozimit të juaj do të merrte 80 euro ndihmë sociale e kjo familje në mesin e tyre ka edhe dy të moshuar me pension të moshës gjithashtu prej shumë 80 euro, të gjitha këto do të ishin 160 euro në muaj, që do të thotë 23 euro për anëtarë të familjes në muaj. Si mundet një anëtar i një familje të kaloj muajin me 23 euro të cilat nuk do të mjaftonin që ta blejë një kilogram bukë dhe një litër qumësht në ditë. Andaj, shpresoj që në Komision së bashku me ju do ta analizojmë mirë propozimin e juaj në nenin 4.1.

Të gjitha të hyrat e familjes, si pensioni themelor, pensioni për aftësi të kufizuar që ju dëshironi ta llogarisni si të pallogaritshme, e ato janë aq shumë simbolike nuk meritojnë të quhen pensione, por thjeshtë edhe ato vetvetiu janë si lloj ndihme sociale. Në këtë Projektligj ka nevojë, faktikisht krahas këtij projektligji ka nevojë të amendamentohet edhe Projektligji për Pensionin ose për ndihmën e shfrytëzuesve dhe personave me aftësi të kufizuara sepse shpeshherë ka përzierje të kompetencave në mes të këtij ligji dhe atij ligji. Shpesh disa familje e gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale për shkak se kanë një person me aftësi të kufizuara në familje ose e plotësojnë edhe një kusht tjetër që nuk është e mjaftueshme, për shembull që ajo familje të gëzoj ndoshta ndihmën sociale. Gjithashtu, ne mendojmë se neni 5, me të gjitha pikat duhet të amendamentet dhe të rishikohet, jo vetëm tri pikat e tij, pastaj neni 4 gjithashtu, sepse në shumë raste në nenin 4 një fëmijë 5 vjeçar i ka mundur një familjeje të jetë shfrytëzuese e ndihmës sociale, ndërsa në rastet e tjera kur një familje e cila ka qenë ndoshta në gjendje shumë më të rëndë materiale ai fëmijë 5 vjeçar që nuk e ka pamundur ta merr ndihmën sociale, sepse punëtorët e qendrave për punë sociale shpeshherë e kanë anashkaluar nenin 2. pika 7 të këtij Projektligji dhe kështu që janë bërë padrejtësi të ndryshme, do me thënë është iniciativë shumë e mirë e ndryshimit dhe i sqarimit të këtij Projektligji, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike do të jap kontributin e vet në rishqyrtimin dhe në amendamentimin e tij në Komisionin profesional. Ju faleminderit!

KRYESUESI BILIM HOTI- Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, përgatitet deputetja Zahrije Jusufi

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI – I nderuar Kryesues, të nderuar ministra dhe deputetë. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale është i rëndësishëm nga se qartëson dispozitat e Ligjit mëparshëm, përcakton kriteret e reja për përfituesit e ndihmës sociale nga se Ligji 2003/15 për ndihmën

sociale, i fuqizuar me Rregulloren 2003/ 88, ka shumë paqartësi në interpretim të disa dispozitave, ka dispozita kontradiktore, të paqarta dhe jofunksionale. Me këtë Projektligj ashpërsohen kriteret për familjet që në nevojë për ndihmë sociale, nga ana tjetër do të mundësohet një rritje e lehtë e shumës financiare edhe pse minimale për familjet që kanë të drejtë për këtë ndihmë.

Projektligji në përgjithësi është formuluar mirë, por mendoj se ka vend edhe për disa ndryshime: në nenin 2 për shembull të Ligjit nën 2.8 duhet të shtohet: “ formohet shkalla e dytë e Komisionit mjekësor në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale”. Neni 4 i Ligjit për kriteret jo financiare për ndihmë sociale ka qenë neni më problematik, mendoj se ky nen duhet të plotësohet dhe riformulohet. Po ashtu edhe te neni 5, nën 5.3 duhet të saktësohet prona e përfituesve. Disa lloje të caktuara dhe të patundshmërisë si toka, duhet të precizet sasia dhe cilësia e tokës, deklasifikimi i saj, dallimi i tokës për shembull në Has dhe i tokës në rrafsh ose në qytet. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës e miraton në parim. Ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, doktoresha Zylfije Hondozi

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI - Z. Kryesues, z Ministër, deputetë të nderuar, gjatë zbatimit të Ligjit për Skemën e ndihmës sociale janë vërejtur disa mangësi, siç janë disa dispozita kontradiktore e disa të tjera të pa qarta dhe të pazbatueshme, kështu që ishin jo funksionale, prandaj ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji është edhe i arsyeshëm.

Me përcaktimin e kriterëve të reja për përfituesit e ndihmave sociale do të mundësohet që të eliminohen nga lista personat që nuk kanë nevojë për ndihmë sociale, ndërsa do të rritet ndihma materiale i atyre që me të vërtetë kanë nevojë, edhe pse kjo ngritje parashihet që të jetë vetëm 5 euro. Gjer më tani ka pasur raste që kanë qenë në skemën e ndihmës sociale, e që kanë pasur anëtar që kanë marrë edhe pensione bazë dhe anëtarë që kanë marrë pensione nga shtetet e jashtme. Dhe tani me këtë plotësim, këto parregullsi do të rregullohen, pasi që Projektligji ofron zgjidhje më të mira për implementimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në jetën e përditshme Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar ORA Fatmire Mulhaxha-Kollçaku

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. Kryesues, z. Ministër, kolegë deputetë të nderuar

E ke në memorandumun shpjegues të qëllimi i Projektligjit flitet se kriteret duhet ndryshuar dhe plotësuar nga se rrethanat në kohën e aprovimit të ligjit në fjalë kanë qenë të tjera, nëse i krahasojmë me rrethanat e tanishme të gjendjes sociale. Nëse nisemi prej kriterit se diçka ka ndryshuar në gjendjen e tanishme. Kisha theksuar që vetëm sa kemi përkeqësim, rritje të varfërisë, varfërisë së skajshme, nuk kemi ndryshim të rrethanave, nuk i kisha marrë si argument që kemi ndryshim të gjendjes së rrethanave, sa i përket gjendjes sociale.

Nën dy, ky ligj me të vërtetë nevoja për mu qartësuar kriteret është e domosdoshme, edhe ne pajtohemi me faktin që kemi nevojë me i qartësuar kriteret, mirëpo nëse e marrim për bazë komentet që i jep Ministria për Punë dhe Mirëqenie të cilat flasin, ne pretendojmë, ai qëllimi i këtij projektligji në fakt po donë me tregu që kur t'i largojmë

6431 përfitues, do me thënë duhet të kemi shumë kujdes te kriteret kur nga 40.000, përfitues aktual dalim në 33.569 sa parasheh Ministria për Punë dhe Mirëqenie që do të mbesin përfitues. Do me thënë 6431 familje duhet të privohen. Supozohet në bazë të Memorandumit këtu, kjo tregon se shkon në favor përmirësimi i gjendjes atyre familjeve që do të mbesin si përfitues së skemës sociale. Sa do të përfitojnë 5 euro ma shumë, por ju lutem edhe ato nuk janë të sigurta, të jeni të bindur nëse nisemi prej komenteve të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie. Rekomandon se me rastin e zbatimit të këtij ligji nuk mund të filloj rritja e numrit pikave për kategoritë e shfrytëzuesit të ndihmave, rritja e ndihmës pa u identifikuar kursimet në Skemën e ndihmës sociale. Janë edhe disa komente që krejt flasin në drejtim që asaj se Ligji nuk do të jetë menjëherë i implementueshëm.

Ju lutem, si të ardhura të llogaritshme tani më e tutje do të hyjë pensioni bazë, ndihma sociale e famshme që ju jepet të moshuarve të moshës 65 vjeçare, pensioni për personat me aftësi të kufizuar. Pak më vonë do ta kemi në rend dite një ligj tjetër që ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuar ku flitet, supozohet se persona me aftësi të kufizuar në Kosovë janë 150.000, të cilët jetojnë në kushte të vështira jetësore dhe të cilët i karakterizon varfëria, izolimi dhe inferioriteti, ndjenja e përjashtimit si rezultat i pabarazisë ekonomike, politike dhe sociale. Por, zonja dhe zotërinj në Kosovë kemi nevojë ta rishqyrtojmë skemën, por me shumë kujdes, me shumë vëmendje. Nëse spekulojmë që disa njerëz vijnë me vetura luksoze dhe marrin ndihmë sociale, ju sigurojë që janë minimumi edhe frikësona që do të vazhdojnë t'i marrin, por mos t'i privojnë ata që kanë nevojë të domosdoshme, nëse supozojmë që në një familje kur e kanë një të moshuar dhe e gëzon këtë ndihmë sociale prej 40 euro, dhe dëshirojmë që ajo të ketë rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin gjatë ndarjes, mandej në rangimin në skemën sociale, ju lutem Ministria për Punë dhe Mirëqenie të ketë kujdes t'iu mundësoj minimumin ekzistencial familjeve, jo vetëm që kanë nevojë për përkrahje institucionale, por janë buzë ekzistimit, do me thonë mundësisë për me mbijetuar. Prandaj, për momentin Grupi parlamentar ORA nuk mund të jep përkrahje në parim të këtij ligji. Mendojmë që duhet projektligji, mendojmë që Ministria duhet edhe një herë të ulët seriozisht ta rishikon mundësinë reale të implementimit të këtyre ndërrimeve dhe ta rikthen në Kuvend për miratim, sepse edhe ne mendojmë se ka nevojë të rishqyrtimit të Ligjit të mëparshëm. Ju faleminderit.

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit edhe prej juve edhe për përkrahje. Ftojme përfaqësuesin e Grupit 6+ Shpresa Murati

DEPUTETJA SHPRESA MURATI - Hvala g. Predsedavajući, nadležni mehanizmi za kontrolu sprovođenja Zakona o šemi socijalne pomoći ocenili su da postoje razne prepreke za efikasno i pravilno sprovođenje ovog Zakona. Ove prepreke i poteškoće bile su i jesu posledica nekih kontradiktornih nejasnih i nefunkcionalnih odredbi. Ove izmene i dopune imaju neposrednog efekta na delovanjima i efikasnosti centra za socijalni rad i otkloniće mnoge nejasnoće oko tumačenja zkonstih odredbi. Osnovni cilj ovog Nacrta zakona i avansiranje mreže socijalne zaštite za određene porodice u šemi socijalne pomoći, pooštavanje kriterijuma za korisnike socijalne pomoći, povećanje finansijskog iznos socialne pomoći kao i eliminisanje nekih smetnji u toku primene Zakona.

Predložene izmene i dopune verovatno će uticati na podizanju kvaliteta rada službenika socijalne pomoći na pružanju socijalnih usluga. Na funkcionalnoj komisiji zaista jako težak zadatak i ako detaljno razmotri kriterijume za korisnike socijalne pomoći koji su po nama dovoljno oštri.

Parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i daće svoj dopinos u toku njegovog daljeg procesuiranja. Hvala!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim Vezira Emrush

DEPUTETJA VEZIRA EMRUSH – Pozdravljam sve prisutne. Ovaj Zakon o socijalnoj šemi je jako važan sa kosovsko društvo. Zakon spada u socijalni program za Kosovo. Delimično ses ovaj zakon sprovodi na ime UNMIK-ove Uredbe br. 2001/9, od maja 2001. godine, i sada je u toku izrada Zakona pod brojem 2003/15 koji smo mi dobili na analizu.

Zakon koji nam je dostavljen na analizu ima 17 opštih člana. Član 1, 2. i 3. ini definišu opšte odredbe Zakona, funkciju i namenu zakona sa definisanjem kategorija, porodica i članova porodica koji mogu koristiti ovu socijanu pomoć. Sredstva na ime socijalne pomoći se izdravajaju, vidimo iz Konsolidovanog budžeta Kosova i isata se namenski, i sa istim ovim sredstvima namenski raspolaže Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu. Isto Ministarstvo treba da jako tesno i savesno saradjuje sa Centrom za socialni rad koji praktično snima kategorije korisnika na terenu po svim lokalnim samoupravama. Korisnici socijalnog primanja trba da su stalno naseljene porodice, vidimo na Kosov i to sa jako teškom socijalnom situacijom za normalan život i porodice koje imaju u svom svojstvu i članove kao što su: invalidi, penzioneri i da vam iskreno kažem i penzioneri su danas kategorija koja prima socijalna primanja. Zakon definiše i sve kategorije korisnika socijalne pomoći i definiše i snima ovo procenu materijalnih dobara koja smanjuju mogućnost socijalne pomoći i definiše ih kao neprocenljiva i procenljiva dobra. Ovde se daje mogućnost za blago kršenje prava korisnicima iz nerazvijenih seoskih sredina, zašto ovo kažem, na primer gde materijalna dobra nemaju ostvarljivu vrednost tržišta, a zbog konfiguracije terena nisu rentabilni za obradu, znači porodice poseduju te materijalna dobra kao što su: njive livade, ali su ovo na tržištu nemaju neku ostvarljivu vrednost a sa tim materijalnim dobrom njima se smanjuje, imaju umenjenje na ime primanja socijalne pomoći.

Potrebno je mnogo pažljivo i da se definišu baš, eto umanjenja na mime prcenljivih i neprocenljivih vrednosti. Potrebno je tačno i odredjivanje limita kada je vrednost materijalna u pitanju i limit ličnog primanja zaposlenog člana porodice. Da zarade porodice može realno da pokrije troškove za osnovni život na ime ovog Zakona.

Član 9. daje nam jednu šemu iznosa mesečne isplate socijalne pomoći, vidimo da je najniži iznos 35 eura za jednog člana porodice a najviši 75 eura za 7 i više članova porodice. Vrednost isplate je kako niska, imamo predlog da bude povećanje od 50% po svim nivoima korisnika socijalne pomoći. Zakon predvidja i novčane kazne u slučaju zloupotrebe za korišćenje socialne zaštite. Ovo kažem stvarno da u ovoj socijalnoj šemi ima korisnici, vrši se i zloupotrba oko korišćenja socijalnog programa. Istim zakonom vidimo da upravlja Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu i to u skladu sa Ministarstvom za finansije i privredu i u skladu sa Zakonom o upravljanju javnim fnansijama gde se daje obaveza znači izrade godišnjih bilansa.

Naša Grupa za Integraciju smatra da je potrebno, jako potrebno da se ponovo razmotre članovi 4. i 5. gde se definišu kriterijumi za sticanje prava na socijalnu pomoć. Zakon mora imati analitički stav oko definisanja primene za stvarnu potrebu socijalne pomoći da se obezbedi minimum za održavanje jedne porodice. U načelu Zakon smatramo da mora da se dopuni sa još detaljnim članovima i amandmanima i unapred Hvala!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar LDD, deputeti Ramadan Kelmendi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit. I nderuari kryesues, i nderuari ministër, deputetë të pranishëm të nderuar

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, natyrisht se ka shqyrtuar dhe analizuar propozim ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për skemat e ndihmës sociale, andaj duke u mbështetur në bazushmërinë ligjore si dhe në gjendjen faktike të realizimit të skemave të ndihmës sociale në terren, përshëndet Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për punën e mirë të bërë rreth këtij dhe këtyre propozim plotësimeve dhe ndryshimeve në parim përkrah procedimin e mëtutjeshëm dhe aprovimin e propozime për plotësimin dhe ndryshimin duke konstatuar si shumë të arsyeshme, sepse Ligji ekzistues 2003/15 për ndihmën sociale nuk është treguar edhe aq efikas dhe shumë arsyeshmëri nga se shumë familje edhe pse i përmbushin dhe i plotësonin të gjitha kriteret nuk mund ta realizonin ndihmën sociale për shkak të paqartësive, kolizione të dispozitave dhe kriterëve aty-këtu absurde apo në kundërshtim njëra me tjetrën.

Në veçanti vlerësojmë pozitivisht llogaritjen e të hyrave dhe rritjen e ndihmës sociale si propozim mjaft përmbajtësor për ta ndryshuar këtë propozim ligj, nga me këto do të arrihet mbrojtja sociale e familjeve në gjendje faktike të rëndë ekonomike, si meritore e vërtetë e njohjes së ndihmës sociale dhe pikërisht ky fakt bënë domosdoshmërinë e nxjerrjes sa më të shpejtë të këtyre propozim ndryshime për t'i ashpërsuar dhe edhe kriteret mbi bazën e së cilave do të realizohet ndihma sociale, reale, faktike dhe e drejtë. Më duhet të veçoj se është propozim i parë i një Propozim ligji, që bazushmërinë juridike për miratim e bënë në mënyrën më të duhur profesionale mbi bazën e parimit të ligjshmërisë. Shikuar në tërësi këto propozim ndryshime dhe plotësime kanë avancuar rritjen e dukshme të mbrojtjes sociale për familjet e vërteta që duhet ta gëzojnë ndihmën sociale duke, natyrisht pamundësuar keqpërdorimin përdorimet. Vlerësimi se do të kemi kurse të dukshme për vitin 2008, më bënë të konkludoj se, do të vije deri te ashpërsimi i kriterëve dhe nuk e shoh edhe aq të drejtë dhe nuk është kjo popullore, sepse, papunësia është në një shkallë të pa lakmueshme dhe ngase mbrojtja e atyre që duhet ta gëzojnë ndihmën sociale, natyrisht se do të ballafaqohemi me pakënaqësitë ndoshta edhe ndonjë krizë sociale dhe kjo më shtynë të konkludoj që, tani duhet të mendojmë për propozime alternative, në raste të tilla. Me gjithë këto plotësime dhe sugjerime, mendoj dhe vlerësoj se, është unanim vendimi i grupit parlamentar i LDD-së, dhe duke konfirmuar përkrahjen e këtyre propozim-ndryshimeve dhe plotësimeve natyrisht si të domosdoshme dhe të arsyeshme që në procedurë sa më të shpejtuar natyrisht në procedurë të përcaktuar kuvendore të vije deri te aprovimi i tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI - Ju faleminderit deputeti Klmendi, edhe kësaj radhe diskutuesi i fundit për këtë projektligj Nazim Jashari, por paprakisht ftoj prapë deputetët që të kthehen në sallë, urdhëroni zoti Jashari e keni fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – sigurisht që unë do të jem në njëfar mënyrë ditën linjë me kryetarin e Komisionit të Kuvendit dhe kolegen time të grupit parlamentar Fatmiren, mendoj se një gjë që duhet ta kemi në konsideratë që të gjithë ne këtu që jemi në Kuvend të Kosovës dhe që jemi përfaqësues të popullit të Kosovës, është se nuk guxojmë këtë problem ta këqyrim mekanikisht se që ka kundru Qeveria.

Ky problem nuk mund të shihet pa emocion, po që se e këqyrim pa emocion pra, me një ftohtësi matematikore, ne sigurisht që do të vijmë në përfundim të këtyre siç ka ardhur atje një kalkulues diku në zyrën e buxhetit dhe që ka paraparë që kur ti shkurtujmë 6 e kusur familje prej skemës sociale ne do ti kursejmë 5,330.000 € të cilat do të mund ti ridestinojmë ndërtime tjera, pra, një kundrim ora matematikor i një problemi që është shumë emocional, të nderuar kolegë deputet, duhet ta kemi një gjë parasysh, kur thuhet se 3951 familje që kanë persona mbi 65 vjet do të kursejnë nga 25 € mesatarisht në muajt për tu arritur një kursim vjetor prej 1185.000 € do me thënë që, ata njerëz nuk kanë nevojë më për ndihmë sociale, pse se kanë analizua pensionin e pleqërisë ose pensionin bazë të pleqësinë prej 40 €, dhe që me atë 40€, po ja dalkan që ti përmbushin nevojat e tyre elementare për funksionalitet të familjes.

Pra, ky është kundrim shumë i përcipt, shumë sipërfaqësor i problemit, njerëzit të cilët do ti mbushin 65 dhe do ta mbërrijnë moshën e pensionit të pleqërisë duhet ta lusin Zotin mos ti mbushin vjetët e pleqërisë, sepse automatikisht i humbin 25 €. Mendoj se kjo është një qasje shumë, shumë e pa pranueshme, e konceptueshme për një shoqëri, e cila që të jemi të sigurtë të gjithë këtu ne, edhe njerëzit që punojnë pra edhe mësuesit kanë nevojë për ndihma sociale, se lere më ata që nuk punojnë dhe nuk realizojnë kurrfarë të hyrash. E di e kam shumë të qartë që, buxheti jonë është i stërngarkuar me dhënie sociale, por nuk është faji i njerëzve që kanë nevojë për ndihma sociale, por është faji i sistemit tonë shoqëror të cilin e kemi formua, ose e kemi konstituua në atë mënyrë që realisht nuk i përgjigjet as nevojave elementare të qytetarëve dhe as nuk i përgjigjet nevojave elementare zhvillimore të Kosovës, sepse në të gjitha anët hasim në paraliza, sa për shkak të kufizimeve që na qesin, sa për shkak të kufizimeve tona të brendshme që i kemi për shkak të mos pasjes së ideve, mungesës së ideve për ta zgjidhë problemin më mënyrë të qëndrueshme.

Mendoj se, edhe, po ashtu edhe shkurtimi i atyre që gëzojnë pensione invalidore prej 671 familjeve, shkurtimi për 25 € në muaj, edhe shkurtimet tjera që janë paraparë këtu më qojnë te ideja që këtu është mendua që në rend të parë të sigurohet një shumë prej 5 milion €, që njerëzve të cilët e gëzojnë ndihmën sociale tu hiqen ato para dhe ato para të destinohen në tjetër drejtim. Nuk them që nuk ka abuzime, ka abuzime por po e përsëris edhe një herë edhe të punësuarit nga buxheti i Kosovës qofshin ata në administratë, qofshin në arsim, qofshin në shëndetësi kanë nevojë për mjete shtesë, për ndihma sociale, për të përmbushë nevojat e tyre elementare si familje, për ti shkolluar fëmijët, për ti paguar qiratë etj.

Është një aspekt që këtu dua ta trajtoj para jush lidhur me, që të gjithë detyrimisht lidhet me këtë problematikë. Përpara se të hyhej në herrjen e skemës sociale, është dashur të hyhet në herrjen e skemës pensionale e pensioneve bazë.

Të nderuar kolegë deputet, ne kemi në Kosovë njerëz të cilët e gëzojnë të drejtën e pensionit bazë të pleqërisë, vetëm pse kanë lindë në Kosovë dhe që mund fare që nuk jetojnë në Kosovë sot aktualisht, nuk kanë adresë banimi në Kosovë, janë njerëz të cilët vijnë nga Maqedonia, edhe i marrin ato 40 € dhe nuk kanë nevojë të vijnë për çdo ditë, ata vijnë një herë në vit dhe i marrin ato para, të cilat u grumbullohen në konton e tyre të cilën e kanë hapur një herë, sepse e kanë dëshmuar që me lindjen e tyre, e kanë dëshmuar që janë shtetas të Kosovës ose banor të Kosovës, se termi shtetas nuk po përdoret.

Pra përpara se të vendoseshin kritere të reja të ndihmës sociale, është dashur të hyhet në kriteret të reja të pensionit bazë, dhe aty të shihet se sa ka njerëz të cilët nuk jetojnë në Kosovë pra, as shëqullin e tyre të jetesës dhe të punës nuk e kanë përmbushë në Kosovë, dhe që marrin para nga ky buxhet mirabel i Kosovës.

Pra mendoj se, edhe ky element është element i mjaftueshëm për të na shty të mendojmë në këtë aspekt që të përpiqemi që vetëm njerëzit që jetojnë në Kosovë, pra që e kanë mbushur moshën e pensionit në Kosovë, të kenë të drejtë ta gëzojnë të drejtën e pensionit të pleqërisë në Kosovë, por jo edhe ata që kanë dëgjua, e kanë me dëgjim të rastit që edhe nga Turqia ka njerëz që vijnë edhe i marrin pensionet e pleqërisë në Kosovë. Pra mendoj se është shumë, shumë, situatë e ndjeshme por them se nuk guxojmë në asnjë mënyrë që ta shikojmë këtë punë matematikisht por ta shikojmë me më shumë emocion dhe të përpiqemi që njerëzit të mos i reduktojmë në atë minimum ekzistencial të cilin e kanë realizuar përmes një skeme sociale. E ata që kanë abuzua të përndiqen, të përpiqemi ti përndjekim por jo kështu matematikisht kaq familje po i eliminojmë, kaq familje eliminojmë, por të përpiqemi kush ka abuzua të eliminohet, dhe jo duke i ndryshua kriteret të përpiqemi që ti qesim njerëzit nga skema sociale. Ju faleminderit për vëmendje. Grupi ynë nuk e përkrahë, edhe një herë po e përsëris.

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit zoti Jashari, pasi që nga sekretaria njoftojmë se, kemi forum për të votuar, andaj kolegë deputet kërkojmë që të deklarohen në miratim për parim të këtij projektligji.

Lusim rezhinë për votim dhe votojmë tani:

PËR.....	52
KUNDËR.....	7
ABSTENIM.....	1

Me 52 vota për, 7 kundër dhe 1 abstenim, kalon projektligji.

Pas miratimit në parim, në bazë të rregullave 23 dhe 35 Kuvendi ngarkon këto komisione.

1. Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe Komisionin funksional e raportues
2. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuse,

3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Pra si zakonisht komisionet duhen që në afatin jo më vonë se dy muaj, nga shqyrtimi i parë i këtij Projektligji, të paraqesin raportin me rekomandime.

Mos keni nevojë për pauzë ndoshta 15 minuta?

Ju faleminderit! atëherë vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Konstatime hyrëse:

Projektligji iu është shpërnda deputetëve me 1. qershor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim andaj ftojme ministrin Ibrahim Selmanaj që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

Urdhëroni zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ - Ju faleminderit zoti kryesues, do të përpiqem të jem sa më i shkurtër, arsyet e nxjerrjes së Projektligjit për personat me aftësi të kufizuara, janë pjesë e natyrshme dhe integrale e shoqërisë si tërësi. Për këtë shkak atyre duhet të ju ofrohet mundësia që përmes formave të ndryshme të integrojnë në zhvillimin e vendit tonë dhe në të njëjtën kohë të integrohen në proceset e ndryshme shoqërore. Në të kaluarën çështja e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, në masë të konsiderueshme ka qenë e lënë pas dore apo e rregulluar në mënyrë parciale. Ky fakt ka qenë një nga shkaqet kryesore që personat me aftësi të kufizuara në vazhdimësi kanë qenë të anashkaluar në integrimet shoqërore dhe një gjendje shumë të rëndë socio-materiale, një anashkalim i tillë i personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, është rezultat i shumë faktorëve të karakterit ekonomik social, kulturor, familjar dhe institucional.

Në përjashtimin e tyre nga jeta ekonomike, politike, kulturore, sportive dhe fushat tjera, ka ndikuar pabarazia ekonomike dhe politike, dhuna e aplikuar në familje dhe mjedise tjera shoqërore, pikëpamje të mekanizmave të ndryshme shoqëror, të cilët kanë krijuar stereo-tipe, për personat me aftësi të kufizuara. Si persona të varur dhe të cilët kanë nevojë për kujdesie të madhe, apo kujdesie kujdesi për ta nuk ja vlen. Mendimi dhe opinionet e shërbimeve të ndryshme të specializuara se personat me aftësi të kufizuara nuk mund të integrohen në shoqëri, mungesja e qasjes së personave me aftësi të kufizuar në arsim, në ngritjen e tyre intelektuale dhe arsimore, mungesa e resurseve institucionale për resorët qeveritar dhe joqeveritar.

Për përkujdesjen permanente të personave me aftësi të kufizuara dhe shumë mariera tjera, të cilat drejtpërsëdrejti jepen në mënyrë indirekte kanë ndihmuar në vetë izolimin e personave me aftësi të kufizuara. Krahësuar me periudhat e mëhershme në periudhën e pasluftës, qasja dhe angazhimi institucional, për këtë grup të qytetarëve, ka qenë i nivelit më të lartë. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm lidhur me personat me aftësi të kufizuara nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ka qenë marrja e vendimit për formimin e një grupi punues të quajtur task-forca, për çështjen e aftësisë së kufizuara në Kosovë.

Detyrë kryesore e këtij grupi punues ka qenë të zhvilloj dhe të përgatis strategji gjithëpërfshirëse mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë radhë kemi sjellë një projektligj, që me angazhimin e juaj të nderuar deputet, me siguri se ligji do të ketë, projektligji do të ketë një pamje krejt ndryshe, ju faleminderit që ua humba pak kohë.

KRYESUESI BILIM HOTI – Ju faleminderit zoti ministër, dhe në emër të grupit parlamentar LDK Ilaz Pireva. Urdhëroni zoti Ilaz.

DEPUTETI ILAZ PIREVA – zoti kryesues i seancës, zoti ministër, të nderuar kolegë deputet,

Në emër të grupit parlamentar të LDK-së dhe si anëtarë i Komisionit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale e të shëndetësisë, kjo është njëherit edhe si komision funksional, shpreh mbështetjen e Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Që në fillim theksoj se kemi të bëjmë me një ligj të rëndësishëm së veçantë e veçantën e përbënë fusha të cilin e rregullon ky Projektligj. Pra me këtë ligj bëhet përkrahja institucionale e rehabilitimit profesional dhe e punësimit të personave me aftësi të kufizuara duke bërë integrimin plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri përmes rehabilitimit dhe aftësimit profesional dhe të punësimit.

Me miratimin e këtij ligji dhe me ngritjen e institucioneve përkatëse do të ngritët edhe vetëdija shoqërore për përkujdesje institucionale ndaj këtyre personave, vetëm në vitin 2003 nga ky Kuvend, u miratua ligji për pensionet e aftësisë së kufizuar dhe me këtë u krijua një siguri, për një përkujdesje materiale institucionale. Ky Projektligj për mbanë nëntë kapituj, ku rregullon statusin, procedurat për caktimin e aftësisë për punë, rehabilitimi dhe aftësimi profesional, kushtet e punësimit, benificionet e punëdhënësve për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, mjetet financiare për punësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe çështje të tjera.

Sipas të dhënave që na jep sponsoruesi i këtij Projektligji, kemi të bëjmë me afro 150.000 persona, që paraqet një shifër të lartë, që jetojnë në kushte të vështira materiale. Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të këtij ligji, duhet një angazhim i veçantë prej institucioneve tona më të larta, të punëdhënësve dhe të gjitha kategorive dhe deri te organizatat e ndryshme të interesit. Sipas Ministrisë së mirëqenies sociale e të punës përpos Ministrisë së Mirëqenies Sociale të Punës edhe Ministria e Shëndetësisë, edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Teknologjisë, duhet të ketë rolin e vetë për të kontribuar në zbatimin suksesshëm të këtij ligji.

Duhet cekur se, implikimet buxhetore për vënie në zbatim, të këtij ligji, që parashihet së aplikuari nga 2008 janë relative. Këtu nga departamenti i buxhetit të konsoliduar të Kosovës, na jepen edhe disa dilema, se do të krijohet një fond për rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, apo do të hapet një llogari bankare, ose do të procedohet përmes një procedimi të veçantë të buxhetit. Kjo pra çështje do të zgjidhet më vonë.

Në fund më lejoni ta shpreh mendimin tim se ky Projektligj është prej më të mirëve që kanë arritur për miratim në Kuvend, në aspektin e shtjellimit të materies dhe të gjuhës.

Sigurisht që Komisioni funksional përmes amendamenteve do të bëjë punën e vetë dhe duke bërë edhe më cilësor, mirëpresin edhe propozimet dhe ndihmën e tyre që u dedikohet ky ligj, grupet e caktuara të interesit. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI – ju faleminderit edhe juve, në emër të grupit parlamentar PDK deputetja Zahrije Jusufi.

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI – i nderuari kryesues, i nderuari zoti ministër, të nderuar deputet,

Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuar, është i rëndësishëm, ngase me legjislacionin ekzistues janë krijuar konfuzione konfuzione në shumëllojshmërinë e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Rehabilitimi profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuar është lënë pas dore dhe legjislacioni ekzistues, ka kontribuar në përjashtim të pesonave me aftësi të kufizuar, të mos kenë mundësi të barabartë për qasje në rehabilitim dhe punësim. Projektligji përcakton të drejtat, mënyrën e rehabilitimit profesional dhe të punësimit, të drejtat për punë, kushtet e punësimit, obligimet e punëdhënësve lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe beneficinet për punëdhënësit e tyre.

Projektligji në përgjithësi është strukturuar mirë, por për të pasur një ligj të zbatueshëm dhe funksional, propozojmë që para procedimit të mëtutjeshëm të plotësohet me njërën nga standardet e të drejtës së patjetërsueshme, të personave me aftësi të kufizuar, që ata të jenë pjesëmarrës, në implementimin e rekomandimeve të tyre. Si subjekt të Projektligjit për avancimin e mundësive për aftësim profesional dhe punësim, me qëllim të pavarësimit ekonomik, përmes aftësimit profesional dhe punësimit, dhe zvogëlimit të shkallës së izolimit dhe integritetit të tyre të barabartë në shoqëri. Ngase ata janë pjesë natyrale e jona, dhe atyre duhet të ju ofrohet mundësi, që sipas llojit të aftësisë së kufizuar, qoftë fizike shqisore, mendoje ose të shumëllojshme për të siguruar një punë më të përshatshme.

Po ashtu propozojmë dhe një dispozitë që do të mundësonte përmirësimin dhe përshtatjen e transportit publik për nevojat e tyre. Ngase mungesa e transportit për persona me aftësi të kufizuar pengon që të rriturit të punojnë. Ne emër të Partisë Demokratike të Kosovës, projektligjin e miratojmë në parim, në shqyrtim të mëtutjeshëm do të kontribuojmë ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit edhe juve, në emër të grupit parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, doktoresha Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – zotëri kryesues, zotëri ministër, zotëri deputet, Çështja më me rëndësi e një shoqërie sa i përket personave me aftësi të kufizuara është që ata të integrohen në shoqëri dhe të ndihen që janë anëtar të dobishëm të sajë. Në vendet e përparuara, këto çështje janë kuptuar dhe zgjedhur qysh moti dhe tani po fillohet edhe të ne që të iket prej mentalitetit që këta persona të izoloohen nga shoqëria të lënë në mëshirë vetëm të familjes së tyre që të kujdeset për ta. Menjëherë pas luftës personat me aftësi të kufizuara janë ndihmuar mjaftë, nga shoqatat bamëmirëse ndërkombëtare, por tani paraqitet nevoja që kjo çështje të rregullohet me ligj.

Me këtë projektligj synohet që të arrihet rehabilitimi profesional, në përputhje me aftësitë e tyre të mbetura punuese dhe njëherit përshtatjes së kërkesave të tregut dhe mundësive tona në mënyrë që të realizohet punësimi i tyre. Supozohet se persona me aftësi të kufizuara në Kosovë janë 150.000 të cilët jetojnë në kushte të vështira jetësore, me punësim të personave me aftësi të kufizuara, do të zgjidhen shumë probleme materiale për ta dhe familjet e tyre, si dhe do të bëhet risocializimi i tyre. Me këtë Projektligj parashihet që të zgjidhet statusi, mos të lejohet diskriminimi të ndërtohen qendra për rehabilitim profesional dhe obligimet e punëdhënësve, kështu që me këtë Projektligj synohet që të zgjidhen të gjitha këto çështje.

Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahë miratimin e këtij Projektligji në parim, mirëpo i kemi disa vërejtje. Dispozitat ndëshkimore, janë caktuar në shuma shumë të vogla, 200 deri 2000 €, për diskriminim në punësim, kur nuk e paguan kontributin e posaçëm, ndërsa ka qenë i obliguar ta paguaj, kur i dorëzon të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara dhe shkelje të tjera. Vlerat prej 200 deri 2000 € paraqesin një diapazon shumë të gjerë dhe vlerësimi i shumës me të cilën do të ndëshkohet personi që i ka shkelë dispozitat e këtij ligji, do të mbetet në ndërgjegjen e inspektoratit të punës, i cili edhe nëse qëllon i njohshëm me punëdhënësin, do ta zbatoj dënimin prej 200 € dhe kjo do të jetë stimulim për punëdhënësit që këtë ligj mos ta zbatojë fare. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI –Ju faleminderit edhe prej juve diktoreshë, në emër të grupit parlamentar ORA, Fatmire Mulhaxha Kollçaku,

DEPUTETJA FARMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU – Ju faleminderit zoti kryesues, edhe grupi parlamentar i ORA, përshëndet Ministrinë për Punë dhe Mirëqene Sociale që ka sjellë këtë Projektligj për miratim në Kuvend të Kosovës, një ligj që është i domosdoshëm, një ligj në rend të parë duhet ta ketë pretendimin kryesor që të mundësojë integrimin e personave me aftësi të kufizuara, do me thënë integrimin e plotë në shoqërinë kosovare. Është e qartë që edhe ky Projektligj do ti ketë implikimet e veta buxhetore.

Mirëpo, është qëllimi kryesor është që përveç kushteve edhe institucioneve speciale ku do të edhe shkollohen edhe punësohen personat me aftësi të kufizuara, qëllimi kryesor është që të ju krijohet edhe mundësi përveç edhe punësimit me kushte të përgjithshme do me thënë me kushte të përgjithshme të punësimit, që nënkupton punësimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e afërt të punës dhe kjo normal nënkupton edhe shumë obligime nga punëdhënësit, duke filluar edhe prej përshtatjes së ambientit të punës, qasjes në ato institucione siç u përmend këtu edhe qasjen në transport publik, sepse çdo gjë që ne duhet ti krijojmë ato parakushte që do ti mundësohen, një personi me aftësi të kufizuar që ti krijoj kushtet që, të shkoj prej shtëpisë së vetë në vend të punës dhe kthehet duke i tejkalua ato pengesa që normal kryesisht ballafaqohet sot në jetën e përditshme.

Ne si grup parlamentar e kemi qëllimin kryesor që, përmes amendamentimit të këtij projektligji të japim kontributin tanë dhe njëkohësisht që shpresojmë që gjatë amendamentimit të këtij Projektligji zëri do të dëgjohet edhe zëri i gjithë atyre që do të

përfitojnë nga ky Projektligj dhe besoj që do të jetë edhe vendimtar në periudhën e amendamentimit të këtij Projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit, në emër të grupit parlamentar 6+, fjalën e merr deputetja Shpresa Murati.

DEPUTETJA SHPRESA MURATI – Hvala, poštovani predsedavajući, ministri, U nedostatku zakona koji uređuje ovu oblast ukazala se potreba i neophodnost za donošenje jednog ovokvog zakona. Pitanja koja su obuhvaćena od ovim Nacrtom zakona su: status lica sa ograničenim sposobnostima za rad, nediskriminacija prilikom tretiranja za zapošljavanje i osposobljavanje, uređivanje procedura za određivanja stepena radne sposobnosti, vladine politike za profesionalnu rehabilitaciju, uslovi zapošljavanja, obaveze poslodavca, izgradnja centra za profesionalnu rehabilitaciju, osnivanje radnog centra i zaštitne radionice, utvrđivanje donacije za posebne namene, beneficije poslodavca carinski poreske olakšice, stimulacije u finansijskim sredstvima, obavljanje nezavisne delatnosti lica sa ograničenim sposobnostima u farmi za ... ili trgovinski društava, budžetski kodeks za finansiranje rehabilitacije i zapošljavanja lica sa ograničenim sposobnostima uključeni u razvojnim programima i utvrđivanje odredbi za nadzor sprovođenja ovog zakona u praksi. Kosovske institucije su preduzele izvesne mere, za poboljšanje položaja ove kategorije stanovništva. Osnivanje kancelarije za lica sa ograničenim sposobnostima, u okviru ureda premijera, formiranje nacionalni odbor za lica sa ograničenim sposobnostima, usvojen je i zakon o penzijama za ova lica, eliminisane su im mnoge građevinske prepreke, za pristup ovih lica raznam javnim objektima. Međutim potrebno još mnogo toga uraditi, i znači mehanizme za zaštitu ovih lica posebne za njihovo osposobljavanje i zapošljavanje u svim sverama s hodno njihovim mogućnostima.

Navešćemo i par sugestija i primedbi na sadržaj predloga zakona počevši od samog naziva Nacrta zakona koji glasi. Nacrt zakona o profesionalnoj rehabilitaciji i zapošljavanju lica sa ograničenim sposobnostima. Pri Skupštini opštini Prizren, pre nešto više od godinu dana, formiran je Komitet za lica sa posebnim potrebama, znači ne sa ograničenim sposobnostima, već posebnim potrebama, pa smatramo da je ovaj naziv pogodniji, za i onako posebno osetljivu grupu stanovništva, i predlažemo da se u nacrtu zakona primeni taj termin ako adekvatni. U članu 12 tačka 2. predlaže se da poslodavac koji ima 24. zaposlene radnika, obavezan je da zaposli jednu osobu sa takvim potrebama. Tačnije svaki 25 radnik.

Zašto ne bi svaki 20. radnik bio lica sa posebnim potrebama, s obzirom da na Kosovu ima preko 150 hiljada lica sa posebnim potrebama a sigurno da je ta brojka i mnogo veća, jer ima puno osoba kje nisu registrovane po gotovo u ruralnim sredinama ili ipak koji prikrivaju čak i ne priznaju svoje poteškoće ili smetnje. Za to je potrebno njihovo zapošljavanje i ekonomsko jačenje. Za to je potrebno povećati svest kod ovih osoba. Podsteći poslodavci da zaposle više ovakvih osoba.

Član 28. predviđen novčanim kaznim. Smatramo da će veće kazne naterati poslodavce da za dosljenju primenu ovog zakona. I na samom kraju parlamentarna grupa 6+, podržava ovaj Nacrt zakona koji je od ogromnog zbnačaja za ovu kategoriju stanovništva. Hvala!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Ju faleminderit, në emër të Grupit parlamentar për integrim deputeti Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit zotëri kryesues, të nderuar ministra të nderuar kolegë deputet,

Me të vërtetë jam i kënaqur që sot jemi në situatë që në parim ta miratojmë këtë Projektligj i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm për mirëqenien shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar në Kosovë.

Si profesionist i lëmisë jam në situatë që çdo ditë të shoh individ të cilët sikur të kishin mundësi që të rehabilitohen në aspektin profesional ose të punësohen në mënyra të ndryshme do të kontribuonin drejtë për drejtë në shëndetin e tyre dhe me këtë do të ulnin shpenzime enorme, për trajtimin e do të thotë përkeqësimeve të sëmundjeve të tyre kronike. E përgëzoj Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për iniciativën dhe për një tekst mjaftë kualitativ ligjor, kisha pasur dëshirë që të dijë se, kush ka qenë në grupin punues që ka punuar këtë Projektligj, edhe për një arsye të veçantë se e ka gjet një zgjidhje shumë ligjente për ballafaqimin me koston e madhe financiare për zbatimin e këtij ligji. Nga raporti financiar i Departamentit të buxhetit Kosovës shihet se në variantin e parë implementimi i këtij Ligji kushton diku rreth 3 milion euro ndërsa në variantin e dytë - të mos hymë në detaje diku rreth 17 milion euro. Ne kemi pas probleme të njëjta me rastin e zbatimit të projektligjeve të ngjashme kur kanë qenë në pyetje sigurimet pensionale, invalidore kur ka qenë pyetje Ligji për sigurimet shëndetësore.

Grupi i punës që prapë po e përsëris shumë kisha pas dëshirë të di se kush ka qenë në të, e ka gjet një zgjidhje që të formohet me nenin 27 paragrafin 2 nën kodin buxhetor të cilën do ta menaxhojë dhe mbikëqyrë këshilli drejtues të cilin do ta emërojë dhe shkarkojë Qeveria. Unë mendoj se kjo është një zgjidhje shumë kreative e cila do të mundësojë pa burokratizim të teprum që mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e këtij ligji të grumbullohen aty ku duhen dhe të menaxhohen dhe të distribuohen deri te shfrytëzuesit e fundit.

Shumë më kish interesuar të di, sepse një zgjidhje e tillë nuk është ofruar më herët nga ministrinë tona konkretisht nga dy ministrat që i kemi këtu dhe që zgjidhjet e ngjashme të ofrohen edhe për fondin e sigurimeve shëndetësore edhe për fondin e sigurimeve pensionale dhe invalidore. Me qenë se njëjtë bëhet fjalë për grumbullim të mjeteve publike në fonde të caktume. Këtu nuk e ka emrin Fond por e ka emrin nën kod buxhetor që në esencë nuk ndryshon shumë sepse bëhet fjalë për grumbullimin e mjeteve të tatimpaguesve, pra është një intervenim në politikë fiskale.

Edhe një vërejtje e kisha pas në tekstin e Projektligjit më tepër një sugjerim jo aq shumë vërejtje, por një plotësim kur është pyetje qendra për rehabilitimin profesional që planifikohet të themelohet të kenë parasysh resurset të cilat ekzistojnë në entin special në Shtime një institucion i cili është tash në menaxhimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në cilën ka mjaft kapacitete institucionale dhe njerëzore dhe plani , sipas planit strategjik të shëndetit mendor të Kosovës kjo Qendër planifikohet të deinstitutionalizohet pra që pjesa më e madhe e klientëve të kësaj qendre të largohen nga ky institucion kështu që në këto hapësira do të mund të themelohet kjo qendër me shpenzime shumë të vogla. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Faleminderit. Kemi edhe përfaqësuesit e Grupit Parlamentar LDD, po tash nuk di ju Ramadan apo Milazimi. Faleminderit që e keni dhënë rendin. Prandaj mikrofoni për deputetin Milazim Haliti.

DEPUTETI MILAZIM HALITI – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me vëmendje ka shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe në emër të grupit shpreh mendimin se ky Projektligj është i hartuar mirë dhe ka strukturën e duhur ligjore. Projektligji plotëson vakumin ligjor dhe është në përputhje me ligjshmërinë e Bashkësisë Evropiane. Për rëndësinë e miratimit të këtij Projektligji është thënë edhe në memorandum shpjegues të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Në këtë drejtim për personat me aftësi të kufizuara ka pasur përkujdesje edhe menjëherë pas luftës kur është nxjerrë korniza gjithëpërfshirëse e politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë dhe janë marrë hapa konkretë për avancimin e statusit të personave me aftësi të kufizuara.

Arsyet për miratimin e këtij Projektligji janë të shumta. Duke pasur parasysh se personat me aftësi të kufizuara në Kosovë janë rreth 150 mijë që jetojnë në kushte të vështira dhe në këtë drejtim është e domosdoshme një përkujdesje më e madhe për këtë grupacion të qytetarëve. Me dispozitat e Projektligjit parashihen rehabilitimi profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, integrimi i tyre në punë dhe në shoqëri, mos diskriminimi, rregullimi i procedurave për caktimin e paaftësisë për punë, rehabilitimi profesional dhe aftësimi i tyre, si dhe kushtet e punës, ndërtimi qendres për rehabilitimin profesional, obligimet e punëdhënësve që kanë lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe rregullimin e formave financiare.

Obligimet që dalin nga neni 12 i këtij Projektligji për organet e administratës shtetërore punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare ku parashihet që punëdhënësi që ka të punësuar më tepër se 24 punëtorë obligohet të punësojë një të punësuar me aftësi të kufizuar. Që për krijimin e kushteve të punësimit dhe personave me aftësi të kufizuara të paguajnë kontribut ata që nuk e kryejnë këtë obligim do të thotë të paguajnë kontribut mujor në lartësi prej 1% në shumën e pagës minimale, me çka do të krijoheshin kushte më të favorshme për punësimin e tyre.

Për zbatim sa më të mirë të dispozitave të këtij Projektligji do të duhej të rriten masat ndëshkimore të parapara në nenin 28 për punëdhënësit që nuk i zbatojnë dispozitat e neneve 5, 12, 13, 16 dhe 25 si dhe nxjerrja e akteve nënligjore, për implementimin e këtij ligji që është paraparë të bëhet në afat prej një viti do të duhej të ishte që në afat prej 6 muajsh të nxirren akte nënligjore për zbatim, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim miratimin e këtij Projektligji dhe do të kontribuojë në fazën e mëtutjeshme të amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI BISLIM HOTI – Faleminderit edhe juve. Në radhë vazhdojmë me deputet sipas radhës që janë paraqitë dhe kështu fillojmë me deputeten Gjylshen Berisha.

DEPUTETJA GJYLSHEN BERISHA – I nderuari kryesues, ministër dhe të nderuar deputetë. Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar është një projektligj shumë i vonuar që dëshmon në një anë trajtimin e shoqërisë ndaj kësaj kategorie tej mase të marginalizuar deri vonë dhe në anën tjetër domosdoshmërinë për vetëdisimin dhe ndryshim të qasjes të institucioneve dhe shoqërisë ndaj kësaj kategorie.

Unë e përshëndes Qeverinë që më në fund kemi para vetes një projektligj të hartuar mirë përmes të cilit kemi plotësimin e vakumit ligjor për të realizuar dhe mbrojtur edhe ligjërisht dhënien e mundësive barabarta për qasje në rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar për të bërë integrimin e tyre në proceset shoqërore. Kjo kategori e shoqërisë sonë që nuk është e pakët në numër nuk kërkon lëmosh por integrim në shoqëri ashtu siç kemi fëmijët me aftësi të kufizuara dhe inkluzionin e tyre përmes paraleleve të bashkangjitura nëpër shkollat fillore, një përvojë e re e implementuar me shumë sukses nga Ministria e Arsimit dhe do të bëjë një digresion këtu dhe dal nga tema për të shprehur falënderimin tim dhe respektin Qeverisë finlandeze për programet e veçanta dhe investimet në këto paralele të bashkangjitura që reflektojnë në kujdesin dhe interesimin e shtuar edhe të familjeve për të përfshirë ato fëmijë në shkolla. Gjithashtu do të falënderoja edhe mësimdhënësit e angazhuar për këta fëmijë. Përkujdesjen ndaj kësaj kategorie sa është humane është aq edhe e drejtë njerëzore e mbrojtur me konventat ndërkombëtare.

Gjithashtu do të rekomandoja Komisionin përkatës që të bëjë amendamentimin në këtë Projektligj, ku do të shprehet ndërveprimi konkret ndërministror i të gjitha ministrive. Edhe një herë e përshëndes dhe e përkrah këtë Projektligj. Faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Faleminderit. Vazhdojmë me deputeten Nafije Berisha.

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA – I nderuari kryesues, të nderuar ministra kolegë deputetë. Pa dyshim se papunësia edhe mungesa e aktiviteteve ekonomike janë një ndër problemet fundamentale të cilat prekin pjesën më të madhe të personave me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre.

Papunësia në Kosovë arrin lartësinë diku rreth 40% por pa dyshim se njerëzit me aftësi të kufizuar përjetojnë shkallën më të lartë të papunësisë. Personat me aftësi të kufizuar duhet patjetër të marrin pjesë në atë çka zhvillojnë punëdhënësit dhe për ta bartur imazhin dhe përvojën se personat me aftësi të kufizuar mund të jenë ekonomikisht produktiv. Ne e dimë që këta persona nuk janë të përfshirë sidomos në punësim dhe në shërbimet civile. Andaj ka qenë shumë e nevojshme hartimi i legjislacionit i cili do të mënjanojë pengesat të cilat shpien në diskriminim të personave me aftësi të kufizuar në procesin e punësimit si dhe në vendin e punës për ata që janë të punësuar.

Andaj ky Projektligj do të krijojë kushte për rritjen e shkallës së punësimit realizimin e të ardhurave dhe për fuqizimin ekonomik të personave me aftësi të kufizume me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre të ndryshme dhe ofrimit të mundësive reale për zgjidhje ekonomike.

Ky Projektligj do të ndikoj në ngritjen e vetëdijes dhe besimit të persona me aftësi të kufizuara mbi potencialet dhe mundësitë e tyre, do të sigurojë bashkëpunim ndërsektorial midis Qeverisë dhe sektorit privat duke u përqendruar në punësim të personave me aftësi të kufizuara. Do të përkrah politikën jodiskriminuese në punësim në sektorin privat dhe në atë publik dhe siguron vlerësim të drejtë të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu do të jap obligime dhe benificione për punëdhënësin me rastin e punësimit dhe të personave me aftësi të kufizuara të cilat janë të shprehura në nenin 12 në pikat 1 dhe 2. Dhe shpresoj z. ministër që sa i përket nenit 12 e keni analizuar mirë dhe do të jeni këmbëngulës gjatë bisedimeve me institucionet ndërkombëtare lidhur me, siç Banka Botërore e kështu me radhë sepse s'kisha pas dëshirë që ky Projektligj të përfundojë sikurse ligji i punës me një rekomandim të fondacionit botëror i cili ka ardhur për ligjin e punës e pengon investimet e jashtme në Kosovë. Andaj obligimet e punëdhënësve ndaj Qeverisë lidhur me këtë s'kisha dashur që në të ardhmen të na vinë një letër e atillë dhe të na shtyjë që ta prolongojmë Projektligjin. Kishte me qenë mirë që benificionet e të punësuarve të cekura në Projektligj që të qartësohen më mirë dhe të definohen më mirë dhe ndoshta nuk është krejt rastësisht që z. ministër këtë Projektligj e keni prurë në seancë së bashku me Ligjin mbi skemën e ndihmës sociale, sepse atje keni planifikuar me i kursye me reduktim të skemës me i kursye nga 6 milion euro ndoshta këto do të mjaftonin për fillimin e implementimit të këtij Projektligji.

Edhe pse me ju thanë të drejtën për mua kishte me qenë ndoshta edhe shumë e rëndësishme që para këtij Projektligji ta bëni në Kuvend Projektligjin për mbrojtjen e të drejtat e fëmijëve prej 0 deri në 18 të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë të mbrojtur me asnjë projektligj. Faleminderit dhe kërkoj falje.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Faleminderit. Në vazhdim deputetja Naxhije Doçi, ndërsa le të përgatitet deputeti Hajredin Hyseni .

DEPUTETI NAXHIJE DOÇI – Faleminderit z. kryesues, i nderuari z. kryesues të nderuar ministra, kolegë të nderuar ministra kolegë të nderuar deputetë.

Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara e ka rendësinë e vet të veçantë dhe është një domosdoshmëri e pakontestueshme që mbulon me legjislacion të funksionalizuar një sferë të tërë të caktuar dhe shumë të ndjeshme në Kosovë. Përmes këtij Projektligji bëhet kthimi ose rehabilitimi zyrtarisht i të drejtave të humbura profesionale të një kategorie të caktuar të qytetarëve të Kosovës siç janë personat me aftësi të kufizuara për të cilët ndoshta mund të themi se shoqëria jonë nuk ka pasur nëpër kohë të caktuar një përkujdesje të duhur dhe të barabartë ashtu si edhe për qytetarët e tjerë të vendit. Pas luftës së vitit 1999 angazhimi i institucioneve vendore në bashkëpunim me ato ndërkombëtare për këtë kategori shoqërore ishte i një niveli më të dalluar çka ka rezultuar edhe me përgatitjen e ligjit në fjalë. Arsyeja e nxjerrjes së këtij Projektligji është pikërisht përmirësimi i gabimeve të bëra në trajtimin e personave të tillë si dhe njohja dhe mbrojtja e të drejtave themelore të punësimit të tyre në harmoni me kërkesat në tregun e punës. Projektligji është në përputhje me Konventën ndërkombëtare dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara si dhe në pajtueshmëri me parimet kryesore të tërësisë së ligjeve të Unionit Evropian. Qëllimi i Projektligjit është përmirësimi dhe zhvillimi i politikave institucionale për të krijuar kushte të përshtatshme ekonomike si dhe për të krijuar mundësi për punësim produktiv të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të

realizojnë të ardhura për ta mbajtur veten si dhe që ta ndien veten mirë si të dobishëm për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Për mundësinë e krijimit të kushteve për rehabilitimin dhe nxitje të punësimit në këtë Projektligj është paraparë themelimi i institucionit të qendrës për rehabilitim profesional dhe për punësim në Kosovë që ndër të tjera rregullon edhe donacionet dhe mjetet financiare për punësim. Objektivi me rëndësi është se ky Projektligj përmes dispozitave të caktuara parasheh eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit si dukuri të dëmshme për shoqërinë gjatë punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Në to parashihet edhe shkalla e vlerësimit të aftësive të punës me persona me aftësi të kufizuara për realizimin e së drejtës së tyre për t'u punësuar me të drejtat dhe detyrimet sipas Ligjit të punës.

Ndërsa integrimi në tregun e punës në kushtet e përgjithshme pra në tregun e hapur të punës dhe në kushtet e veçanta- në vend punësim dhe në punësim të ekonomive familjare i krijon mundësi legjislative kësaj pjese të natyrshme të shoqërisë për socializim dhe për kuptueshmëri të jetës ndryshe për të mirë. Në pasqyrën e dhënë nga Departamenti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës tri herë theksohet se punëdhënësi apo Qeveria e Kosovës që ka të punësuar më tepër se 24 punëtorë është e detyruar të punësojë 1 person me aftësi të kufizuara. Përkatesisht çdo i 25 punëtorë i punëdhënësit të caktuar të jetë prej personave me aftësi të kufizuara. Po kjo çështje theksohet edhe në nenin 12 pika 2 në bazë të numrit të madh që ka Kosova prej 150 mijë personave me aftësi të kufizuara jo të jetë i punësuar çdo i 25 punëtorë por do të duhej të ishte një shifër me përfshirje më të lartë.

Në nenin 9.2 theksohet konkursi për pranimin në punë të personave me aftësi të kufizuara, por nuk është thënë se duhet shpallur konkursi publik. Propozoj të shtohet një amendament pas pikës 2 të nenit 9 ku do të precizohet që gjatë shpalljes së konkursit publik të obligohet barazia gjinore e pranimi të punëtorëve me aftësi të kufizuara se përmes realizimit të nenit të tillë shtesë ndër të tjera do t'i respektojmë të drejtat e njeriut, Ligjin për barazi gjinore si dhe do t'i krijojmë një disponim pozitiv për jetë të personat gjegjës.

Në nenin 17.1 theksohet se punëdhënësit e ri janë të liruar 24 muaj që nga dita e fillimit të punës që të mos pranojnë punëtorë me aftësi të kufizuara. Kjo është një periudhë e gjatë dhe kujtoj se duhet shkurtuar afati me përgjysmë do të thotë që brenda 12 muajsh të mos pranojë punëtorë me aftësi të kufizuara.

Në nenin 18.1 është cekur se punëdhënësi i cili punëson punëtorë me aftësi të kufizuara ka të drejtë benificionesh për shembull me zbritje të tatimit, marrje kredish, blerje mjetesh për punë etj. gjë që është paraparë me të drejtë në mënyrë që të punësohen sa më shumë punëtorë me aftësi të kufizuara.

Është një projektligj i hartuar mirë çka tregon se grupi punues ka punuar me një përkushtim të veçantë por me gjithat do të kisha thënë se në këtë Projektligj përkundër vlerësimit që u bë dhe që po e bëjë edhe vet ka edhe disa gabime gjuhësore të cilat ndoshta janë lëshuar më tepër si gabime teknike apo nga pakujdesia por besoj se me një lekturim me përkujdesje do të përmirësohen këto gabime dhe do t'i shtohet vlera këtij Projektligji.

Në fund e përkrah në parim këtë Projektligj me bindjen se komisioni funksional do të plotësohet dhe do të amendamentohet mirë. Faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Faleminderit edhe juve. Në radhë është deputeti Hajredin Hyseni, kurse më pas deputetit i fundit Ramadan Kelmendi, keni kohë të mendoni a doni me diskutua apo jo.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Faleminderit z. kryesues, ministrat të pranishëm, deputetë të nderuar. Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar mendoj se është një nismë e mirë e Ministrisë që në Kosovë të sanksionohet me ligj se të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë dhe duhet të trajtohen të tillë nga institucionet e Kosovës. Institucionet dhe shoqëria kanë obligim që kësaj kategorie t’ia mundësojnë të jetë pjesëmarrës në zhvillimin shoqëror të përgjithshëm dhe mendoj se ky Projektligj është një nismë e mirë që kjo kategori më në fund të fillojë të trajtohet e barabartë si gjithë qytetarët. Duhet të theksohet se këta qytetarë të Kosovës nuk kanë kërkuar dhe as nuk kërkojnë asnjë diskriminim pozitiv, këta qytetarë kërkojnë si pjesë e shoqërisë në të gjitha fushat t’u jepet shans i barabartë që të konkurrojnë për veten për shoqërinë pra të jenë pjesëmarrës të barabartë në vendimmarrje për të ardhmen e vendit.

Punësimin, i cili është një nga faktorët që kjo kategori të bëhet e barabartë në shoqëri, mendoj se në masë të madhe të e rregullon ky rojektligj, por mendoj se duke pasur parasysh gjendjen në cilën ndodhet kjo kategori nuk duhet pritur aq gjatë për nxjerrjen e akteve nënligjore siç parashihet në nenin 32 një vit pas nënshkrimit të tij, por të shpejtohet ajo për shkak të nevojave akute që ndihen në shoqëri.

Mendoj se nenet 11 dhe 12 z. ministër duhet të rishqyrtohen sepse në këto dy nene kemi edhe elemente segregative. Sipas këtyre neneve më tepër favorizohen dhe inkurajohen strukturat e veçanta të punësimit të cilat shkaktojnë segregacion. Ndërsa tregu i hapur i punës ka hapësirë për mos nxitje për punësimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe të çështja e aftësimin profesional mungon asistencë personale si dhe shërbimi i teknologjisë adaptuese. Por me përmirësimin e nevojshëm mendoj se është një projektligj i domosdoshëm që duhet mbështetur për ta jetësuar sa më parë. Ju faleminderit.

KRYESUESI BISLIM HOTI – Faleminderit. Deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Faleminderit. I nderuari kryesues, të nderuar ministra të pranishëm, kolegë deputetë. Shqyrtuar në tërësi propozim ligjin për rehabilitimin e personave dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është një meritë që duhet vlerësuar pozitivisht dhe këtë duhet ta mbështesin në arsyeshmërinë e madhe të aftësimin të personave të punësuar me aftësi të kufizuara. Andaj përkrah në parim këtë propozim ligj dhe në veçanti përgëzoj Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për angazhimin dhe zgjedhjet ligjore të kësaj çështje të aftësimin të punësimit të një kategorie shoqërisë sonë e cila pa tjetër duhet të integrohet në shoqërinë në tërësi.

Sugjerimi im i parë është. Në emërtimin e propozimligjit duke propozuar që propozim ligji të emërohet, propozim ligji për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me

aftësi të kufizuara sepse kjo përputhet në tërësi me përmbajtjen e dispozitave që sanksionojnë këtë materie. Kësaj kategorie të qytetarëve tanë duhet afruar mundësi dhe siguri ligjore që të kontribuojnë për veten e tyre në radhë të parë sepse deri më tani ata ishin të lënë pas dore, të anashkaluar të ashtuquajtur në një gjendje të rëndës sociale materiale dhe barë vetëm e familjes së tyre. Natyrisht kjo është pasojë e bazës ekonomike dhe jo e mungesës së vetëdijes së institucioneve tona. Megjithëkëtë ne duhet të angazhuar në tërësi potencialin tonë njerëzor dhe ligjor por edhe atë institucional që qytetarët tanë me aftësi të kufizuara të nxjerrim nga varfëria izolimi dhe infortiteti ndjenja e përbuzjes këtë do ta arrin vetëm duke i përcaktuar të drejtat kushtet dhe mënyrat e aftësimi të punësimit integritet në shoqëri pikërisht këtë që pretendon ta sanksionoj ky propozim ligj.

Vlerësoj se duhet nxitur dhe krijuar lehtësira dhe benificione stimuluese në veçanti te kompanitë private që të punësojnë disa persona me kategori të aftësive kufizuara si metodë më e mirë e realizimit të këtij qëllimi. Natyrisht është më se e domosdoshme që në proceset e mëtutjeshme plotësuese të merren këto veprime:

1. Të definohet dhe zgjidhet statusi i personit me aftësi të kufizuara,
2. Të ndalet diskriminimi i tyre i mëtutjeshëm,
3. Të rregullohen procedurat për rehabilitimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara,
4. Të krijohen kushtet për aftësimin e personave me aftësi të kufizuara në entet adekuate,
5. Të adaptohen kushtet e punës në kompanitë private për persona me aftësi të kufizuara,
6. Të ndërtohet një qendër absorbuese e personave me aftësi të kufizuara,
7. Të kemi një evidencë të saktë të këtyre personave me aftësi të kufizuar,
8. Të obligohet në një mënyrë punëdhënësit për punësimin e tyre duke ju dhënë lehtësime ajo duke i sanksionuar,
9. Të përcaktohet një kod buxhetor për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara,
10. Të bëhet përfshirja e tyre në procesin arsimor të stimulohet tregu i liri i vendeve të punës duke orientuar lehtësira dhe çështjen humanitare për punësim.

Ky Propozim ligj për të cilin po debatojmë sot është shkruar mirë me një gjuhë dhe kuptim juridik të qartë me dispozitat të shkurta dhe konkrete dhe si i tillë e përkrahi në tërësi duke kërkuar aplikimin sa më të shpejtë që është e mundur e tij. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Meqenëse nuk ka diskutues të tjerë shkojmë në votim në parim.

Në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Për 61;
Asnjë kundër.

Kalon Projektligji.

Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision funksional dhe raportues.

Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe

Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj, nga shqyrtimi i parë, të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandimet e nevojshme. Ju faleminderit.

Pika e nëntë e rendit të ditës

Në fillim është heqë pika e tetë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 22 dhjetor 2006. Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raport dhe rekomandimet si vijon.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Njëkohësisht Komisioni për Buxhet dhe Financa, në cilësinë e Komisionit funksional dhe raportues, i ka rekomanduar Kuvendit t'i miratojë në tërësi ndryshimet e propozuara sipas tekstit të Projektligjit.

Me që nuk ka amendamente lus deputetët që të deklarojnë për tekstin në tërësi të Projektligjit.

Votojmë tash:

Për..... 63;

Asnjë kundër.

Miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim. Ju faleminderit.

Dhe pika 10 Lus përfaqësuesin e Komisionit për Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ta marrë fjalën. Hydajet Hyseni urdhëroni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI - Faleminderit z. kryetar. Kolegë të nderuar deputetë. Komisioni për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka kërkuar që të procedohet kështu në procedurë të shpejtuar procedurat për ndryshimin e rregullave procedurës së Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij me qëllim të zhblokimit dhe azhurnimit të zgjedhjes së drejtuesve të këtij institucioni tejet të rëndësishëm. Proces ky siç e dini është i bllokuar dhe i ngatërruar pa nevojë dhe do të thosha pa fajin e Komisionit as të Kuvendit.

Siç është e informuar ky Kuvend dhe gjithë opinioni procesi i mëparshëm i zgjedhjes së drejtuesve të institucionit të Avokatit të Popullit është bllokuar për shkak të interpretimit problematik të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut dhe injorimit të faktit se kjo Rregullore i është bartur Kuvendit. Ndërkohë Zyra ligjore e UNMIK-ut ka iniciuar dhe Përfaqësuesi Special ka shpallur ndryshimet në Rregulloren për zgjedhjen e institucionit të Avokatit të Popullit. Me këtë Rregullore janë bërë disa ndryshime në procedurën e zgjedhjes së drejtuesve të këtij institucioni, është ndarë zgjedhja e avokatit të popullit nga zgjedhja e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Është pos disa saktësimeve terminologjike të cilat duan mbështetur është ndryshuar edhe e votimit të avokatit të popullit madje edhe zëvendësve.

Komisioni ka qenë i detyruar që t'i përshtatë rregullat e procedurës edhe t'i propozoj Kuvendit që t'i miratojë si të tillat të përshtatur me Rregulloren e UNMIK-ut.

Unë ftoj Kuvendin që t'i miratojë rregullat e propozuar të procedurës dhe dëshiroj që të theksoj vetëm se as rregullat që kemi propozuar nuk sigurojnë parandalimin e bllokimit eventual. Megjithatë për këtë le ta marrë përgjegjësinë autori i Rregullores, kështu siç janë rregullat mundësojnë që Kuvendi të kryejë pjesën e tij të detyrës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Lus shefat e grupit parlamentar të deklarohen për. Urdhëroni z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar. Ne e mbështesim propozimin e Komisionit dhe do të votojmë për. Faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Nga PDK-ja , urdhëro Ramë Buja.

DEPUTETI RAMË BUJA – Edhe Grupi Parlamentar i PDK-ës mbështet këtë dhe votojmë pro.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Aleanca.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. kryetar dhe ne do ta votojmë Rregulloren. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. ORA.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Rregullore, dhe do të votojmë pro.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Grupi 6+. Xhazair Murat.

DEPUTETI DŽEZAIR MURAT – Mi takode, predsedniçe podržavamo predlog g. Hysenija i glasaćemo za.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Grupi për Integrim, Z. Agani.

DEPUTETI FEHMI AGANI – S’ ngel tjetër vetëm me ju bashkua të gjithëve.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Gjithashtu edhe unë përkrah propozimin gjegjësisht rekomandimin e Komisionit por si anëtar i Komisionit më lejoni vetëm dy fjalë t’i them: Kemi kolizion të plotë juridik mes rregullave që parashohim për zgjedhjen dhe ato do ta bllokojnë zgjedhjen dhe e dyta se nuk është në pajtueshmëri mbi kriteret profesionale të Rregullores dhe as që parashihet këtu. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Prof. Hamiti urdhëroni.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Meqë po shoh që ekziston një disponim i të gjitha grupeve sa po marr vesh unë që të votohen në tanësi. Nëse shkojmë nen për nen unë nuk po flas tash nëse shkojmë në tanësi po e bëjë vërejtjen që e kam një nen që në vërtetë është kërkim sqarimi, rregulla 3 paneli rekrutues formulimi që është në të djathtë do me thanë i Komisionit kur është çështja e përbërjes së Komisionit me formën si e ka të pashquara me nuk dihet sa anëtar i ka ky Komision i panelit. Nëse mendohet që duhet të marrë pjesë i gjithë Komisioni plus shefat e grupeve parlamentare, atëherë duhet të thuhet anëtarët në të shquar, përndryshe nuk dihet sa do të jenë. Hydajeti i kupton edhe shqipen edhe çka po them besoj Hydajet. Problemi është thuhet: Përbëhet nga anëtarët e Komisionit a është nga anëtarët të gjithë apo nga disa.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Z. kryetar kjo pjesë e rregullave nuk është ndryshuar, paneli rekrutues është pjesë e punës së përzgjedhjes së kandidatëve në të cilën nuk marrin pjesë gjithë anëtarët e Komisionit, por marrin pjesë një numër i kufizuar i anëtarëve të Komisionit p.sh. është e thënë edhe shprehimisht që kryetari i Komisionit nuk merr pjesë në të. Do të thotë marrin pjesë vetëm një pjesë e anëtarëve të Komisionit me përfaqësimin që çdo grup duhet të ketë një përfaqësues.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni prof. Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Prandaj unë e shtroj pyetjen një pjesë, sa janë ata, nëse një pjesë, prandaj unë po e shtroj pyetjen sepse në variantin në të majtë thotë është e shquara anëtarët do të thotë të gjithë, varianti që është propozuar do të thotë marrin disa atëherë sa, kjo është pyetja ime.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. Hyseni kemi përgjigje.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ndoshta ndonjë prej kolegëve që kanë qenë edhe në procesin e përzgjedhjes do të mund të ishte më i saktë. Megjithatë është çështje e procedurës së brendshme të Komisionit. Komisioni e formon panelin rekrutues dhe e formon me anëtarë, ne s’kemi dashur pikërisht që të mos kuptohet kjo keq ,anëtarët jo të gjithë, por janë disa anëtarë të Komisionit që përbëjnë panelin rekrutues ku nuk bënë pjesë kryetari dhe nuk bënë pjesë çdo anëtarë. Nuk është precizuar as në fillim sa duhet, sepse e kemi parë c’ është e vërteta dhe një ngatërrim tjetër, ka qenë Komisioni rekrutues dhe Komisioni i intervistues. Megjithatë që kjo nuk ka funksionuar ne jemi përcaktuar që Komisioni rekrutues ta marrë përgjegjësinë edhe për procesin e intervistimit në funksion të thjeshtësimit të procedurës që të mos humbim kohë për arsyet që i dini. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Shkojmë në votim në tërësi. Votojmë tash:

Në sall aktualisht janë 64 deputetë.

Për.....	52;
Kundër.....	4.

Kalon rekomandimi.

Ju faleminderit, shihemi më 28.6.2007 në orën 10,00.